

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 35/2016

**PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA
TË LIDHURA ME TO¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i ligjit

1. Objekt i këtij ligji janë:

a) mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to për veprat e natyrës letrare, artistike dhe shkencore;

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

- Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura" e amenduar", Celex: 32006L0116; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 372, datë 27.12.2006.

- Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 prill 2004, "Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale", Celex: 32004L0048; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 157, datë 30.4.2004.

- Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, "Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit", Celex: 32001L0029, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 167, datë 22.6.2001.

- Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2001, "Mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre origjinale të artit", Celex: 32001L0084, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 272, datë 13.10.2001.

- Direktivën 96/9/ KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, "Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave", Celex: 31996L0009, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 77, datë 27.3.1996.

- Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike", Celex: 32009L0024, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 111, datë 5.5.2009.

- Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale", Celex: 32006L0115, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 376, datë 27.12.2006.

Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, "Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablllore", Celex: 31993L0083, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 248, datë 6.10.1993.

- Direktivën 2014/26/ BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi - territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm", Celex: 32014L0026, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 84, datë 20.3.2014.

b) mbrojtja e të drejtave të lidhura me të drejtat e autorit, në vazhdim të drejtat e lidhura, të tilla si: të drejtat e interpretuesve/ekzekutuesve në lidhje me interpretimet/ekzekutimet e tyre; prodhuesve të regjistrimeve fonografike të tyre; prodhuesve të fiksimeve/(regjistrimeve) të para të filmave të tyre; organizatave transmetuese për transmetimet e tyre; botuesve në lidhje me botimet e tyre; prodhuesve të bazës së të dhënave në lidhje me bazën e të dhënave të tyre;

c) mbrojtja e të drejtave të parashikuara në dispozitat e veçanta për programet kompjuterike dhe veprat audiovizuale të përcaktuara në këtë ligj;

ç) administrimi individual dhe kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to;

d) mbrojtja “*sui generis*” e të drejtave të krijuesve të bazës së të dhënave;

dh) mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në rastet e cenimit të këtyre të drejtave;

e) mbrojtja e çdo të drejte tjetër të parashikuar për veprat e së drejtës së autorit dhe ato të lidhura me të në këtë ligj.

2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Neni 2

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për personat fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari krijuese, tregtare, prodhuese ose çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) veprat:

i) që nuk janë shfaqur në publik dhe që kanë për autorë shtetas shqiptarë;

ii) që nuk janë shfaqur në publik dhe që kanë për autorë persona fizikë, që jetojnë ose janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë;

iii) që janë shfaqur për publikun në Republikën e Shqipërisë ose janë shfaqur për publikun në një vend tjetër dhe, brenda 30 ditëve, janë shfaqur në Republikën e Shqipërisë;

iv) e autorëve të huaj, të shfaqura për herë të parë në vendin e tyre ose në një vend të tretë dhe, brenda 30 ditëve, të jenë shfaqur edhe në Republikën e Shqipërisë;

v) arkitekturore, të ndërtuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) veprat/shfaqjet e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues:

i) që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ii) të fiksuara në regjistrimet e tingujve, të mbrojtura nga ky ligj;

iii) të interpretuara dhe/ose të ekzekutuara për herë të parë për publikun e Republikës së Shqipërisë apo të interpretuara dhe/ose të ekzekutuara, jo më vonë se 30 ditë, edhe në Republikën e Shqipërisë;

c) regjistrimet e fonogrameve/tingujve:

i) të realizuara nga prodhues, persona fizikë ose juridikë, që jetojnë ose janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë;

ii) kur fiksimi i parë, në një formë material, është prodhuar për herë të parë në Republikën e Shqipërisë;

iii) tashmë të disponueshme për publikun e Republikës së Shqipërisë ose që janë bërë të disponueshme më parë në një vend tjetër dhe në të njëjtën kohë, brenda 30 ditëve, bëhen të disponueshme edhe në Republikën e Shqipërisë;

ç) programet audiovizive:

i) të transmetuara nga ofruesit e shërbimit mediatik për transmetimet audiovizive, me seli në Republikën e Shqipërisë;

ii) të transmetuara nga stacionet e emetimit që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kuptimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to

1. Të drejtat e autorit i përkasin, nga natyra, personit fizik, i cili ka krijuar veprën.

2. Të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve i përkasin, nga natyra, personit fizik, i cili ka kryer interpretimin dhe/ose ekzekutimin e krijimit letrar ose artistik ose shprehive të folklorit.

3. Mbajtësi i të drejtave të tjera të lidhura me to mund të jetë çdo person fizik dhe juridik, përveçse kur përcaktohet ndryshe me ligj.

4. Të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to mund të kufizohen kundër vullnetit të mbajtësit të tyre vetëm në kushtet dhe në mënyrën e rregulluar me ligj.

Neni 4

Njohja, publikimi, publiku dhe përdorimi publik

1. Një vepër e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të do të konsiderohet se është “e njohur” nga publiku në qoftë se është vënë në dispozicion të publikut me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës.

2. Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) “Publik” konsiderohet një numër personash, më shumë se dy, që gjenden jashtë rrethit të personave të lidhur ngushtë me rrethin familjar ose kanë marrëdhënie të tjera personale me autorin.

b) “Përdorimi publik” konsiderohet përdorimi i një vepre, krijim i autorit, objekt i këtij ligji, që përcillet në publik ose që është në përdorim në një zonë të arritshme për pjesëtarët e publikut, si dhe që siguron aksesin nga publiku në këtë vepër në çdo kohë ose vend të përzgjedhur në mënyrë individuale nga ana e tyre.

c) “Publikim” është bërja e mundur për publikun, me pëlqimin e autorit ose të mbajtësit të të drejtave të lidhura, të kopjeve të një vepre ose objektit të të drejtave të lidhura, me kusht që mundësimi i këtyre kopjeve të jetë në atë masë që të përmbushë kërkesat e arsyeshme të publikut, në përputhje me natyrën e vepres ose me objektin e të drejtave të lidhura.

Neni 5

Marrëdhënia mes të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to

1. Mbrojtja e të drejtave të lidhura, të parashikuara në këtë ligj, nuk ndikon dhe nuk do të cenojë në asnjë mënyrë mbrojtjen e të drejtave të autorit. Asnjë dispozitë e këtij ligji, në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të lidhura, nuk mund të interpretohet në cenim të të drejtave të autorit të parashikuara nga ky ligj. Ushtimi i të drejtave të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve për përcjelljen në publik të shfaqjeve të regjistruara, sipas parashikimeve të këtij ligji, nuk do të cenojë ushtimin e së drejtës së autorit.

2. Dispozitat e këtij ligji, në lidhje me përkufizimin e të drejtave të veçanta pasurore të autorit, të drejtën e shpërblimit për riprodhimin e veprave për përdorim privat ose përdorime të tjera personale, të drejtën e shpërblimit për huadhënien publike, si dhe shuarjen e së drejtës së shpërndarjes, përjashtimet dhe kufizimet e së drejtës së autorit, fillimin e kohëzgjatjes për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe efekteve kur mbaron kjo periudhë, kalimet ligjore të së drejtës së autorit, si dhe lidhjen midis të drejtave të autorit dhe pronësisë, do të zbatohen me ndryshimet e nevojshme për të drejtat e lidhura me to, përveçse kur parashikohet ndryshe ose kur rrjedh nga natyra e tyre ligjore.

Neni 6

Trajtimi i barabartë

1. Personat fizikë dhe juridikë të huaj, veprat e të cilëve mbrohen në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, palë e të cilave është Republika e Shqipërisë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga ky ligj sikurse edhe shtetasit apo personat fizikë dhe juridikë të Republikës së Shqipërisë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

2. Frazat e përdorura në këtë ligj, për sa u përket kuptimeve gjinore, pavarësisht se si janë përdorur, në gjininë mashkullore ose femërore, do të konsiderohen të barabarta për të dyja gjinitë.

Neni 7

Zbatimi në kohë dhe hapësirë

1. Ky ligj gjen zbatim për të gjitha veprat, përfshirë ato të mbrojtura nga marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, të cilat, në momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes përkatëse, nuk kanë hyrë ende në “*domenin publik*” në vendin e tyre të origjinës pas përfundimit të afatit të mbrojtjes dhe të cilat nuk kanë hyrë ende në “*domenin publik*” në Republikën e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të një afati mbrojtjeje të parashikuar nga ky ligj.

2. Në kuptim të këtij ligji, me termin “domen publik” konsiderohet tipologjia ose regjimi i përdorimit të lirë nga publiku të veprave të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të cilave u ka mbaruar afati i mbrojtjes në bazë të këtij ligji ose që nuk kanë qenë ndonjëherë nën mbrojtjen e ligjit të së drejtës së autorit.

PJESA II

TË DREJTAT E AUTORIT

KREU I

OBJEKTI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË AUTORIT

Neni 8

Veprat

1. Objekt i së drejtës së autorit është çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, i cili mbart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tyre, objektivi, rëndësia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë si më poshtë:

a) krijimet e fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare dhe publicistike, leksionet, predikimet fetare, fjalimet, çdo krijim tjetër me gojë ose me shkrim dhe programet kompjuterike;

b) krijimet dramatike dhe dramatiko-muzikore;

c) kompozimet muzikore, me ose pa tekst;

ç) krijimet koreografike dhe pantomimat;

d) krijimet audiovizuale, në të cilat përfshihen krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera audiovizuale të krijuara në mënyra të ngjashme me ato kinematografike, veprat radiofonike;

dh) krijimet e artit pamor në fushën e pikturës, skulpturës dhe grafikës, artet dekorative monumentale, pavarësisht nga materiali/mediumi përbërës i tyre, dhe krijime të tjera të artit pamor;

e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore;

ë) krijimet fotografike dhe çdo krijim tjetër që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik;

f) veprat e arteve të aplikuara, duke përjashtuar ato vepra, si dizajne industriale që mbrohen nga ligji “Për pronësinë industriale”;

g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi;

gj) krijimet hartografike;

h) krijimet shkencore me shkrim ose me gojë, siç mund të jenë prezantimet, monografitë, deduksionet, disertacionet, studimet, leksionet universitare, librat shkollorë, projektet dhe dokumentacioni shkencor.

2. Çdo pjesë ose element tjetër i një vepre, përfshirë titullin e saj ose një personazh të shprehur aty, që në vetvete përfaqëson krijimin intelektual, mbrohet gjithashtu nga e drejta e autorit.

3. Titulli i krijimit, i cili nuk plotëson kushtet për të qenë objekt i së drejtës së autorit dhe tashmë është përdorur për një vepër të caktuar, nuk do të përdoret për të njëjtën lloj vepre, nëse ky titull krijon konfuzion për autorin e krijimit.

4. Objekt i së drejtës së autorit mund të jetë çdo vepër autori, përveç asaj që nuk mund të jetë e tillë për shkak të natyrës së saj dhe asaj vepre, për të cilën dispozitat e këtij ligji përcaktojnë që nuk mund të jetë objekt i së drejtës së autorit.

5. Objekt i së drejtës së autorit është një vepër si një e tërë, duke përfshirë një punë të papërfunduar, titullin e një vepre dhe pjesët e saj që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Veprat e prejardhura

1. Veprat e prejardhura janë krijime intelektuale, që realizohen duke u bazuar në një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, si përkthimet, përshtatjet, aranzhimet muzikore, ilustrimet, dokumentarët, riprodhimet artistike, faqet e internetit me të dhëna statike ose ndërvepruese, si dhe ndryshime të tjera të krijimeve/veprave letrare, shkencore ose artistike

originale që mund të transformohen, të rimodelohen ose të përshtaten, dhe të cilat mbrohen si krijime/vepra origjinale në mënyrë të pavarur nga të drejtat e autorit të krijimit origjinal.

2. Parashikimi më sipër nuk mund të interpretohet në dëm të të drejtave të autorit të veprës, e cila është përshtatur.

3. Autorët e veprave të prejardhura gëzojnë të drejtën e autorit mbi to vetëm me autorizim/kontratë me shkrim të autorit ose titullarit të të drejtave të veprës origjinale.

4. Të drejtat e autorit të veprave të prejardhura nuk cenojnë të drejtën e autorit të veprave origjinale që është përkthyer, përshtatur, përpunuar ose transformuar në mënyrë tjetër, të ndryshme nga ato origjinale.

5. Përkthimet e teksteve zyrtare në fushën e legjislacionit, të administratës dhe vendimet e gjyqësorit duhet të jenë të mbrojtura, përveç rasteve kur kanë për qëllim informimin zyrtar të publikut.

Neni 10

Përmbledhjet

1. Mbrohen nga e drejta e autorit, përmbledhjet e veprave, të kontributeve ose materialeve të tjera, të veprave shkencore ose artistike, të cilat, për arsye përzgjedhjeje ose të përshtatjes së përmbajtjes së tyre, përbëjnë krijime intelektuale të autorit.

Kjo mbrojtje nuk shtrihet për përmbajtjen e përmbledhjes dhe nuk cenon të drejtat ekzistuese në përmbajtjen e saj.

2. Përbëjnë përmbledhje, në kuptim të këtij neni, vepra të tilla, si: enciklopedi, antologji, fjalorë, përmbledhje të tjera të ngjashme ose përpilime të materialeve dhe të dhënave të ndryshme, gazeta, revista, recensione dhe periodikë të tjerë, pavarësisht nëse janë të mbrojtura ose jo veçmas nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, me kusht që ato, për shkak të përzgjedhjes ose përpunimit të përmbajtjes së tyre, të jenë rezultat i krijimtarisë intelektuale.

Neni 11

Baza e të dhënave

Mbrohet nga e drejta e autorit baza e të dhënave, e cila, në kuptim të këtij ligji, është një mbledhje e krijimeve të pavarura dhe e të dhënave ose materialeve të renditura, në mënyrë sistematike ose metodike dhe që janë të aksesueshme me anë të mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera dhe që bën krijim intelektual.

Baza e të dhënave nuk shtrihet për përmbajtjen e materialeve që përbëjnë bazën e të dhënave dhe nuk cenon të drejtat ekzistuese mbi to. Mbrojtja e një vepre bazë të dhënash nuk zbatohet për programet kompjuterike të përdorura në përgatitjen ose përdorimin e bazës së të dhënave, të cilat janë të arritshme nga mjetet elektronike.

Neni 12

Krijimet që nuk janë objekt mbrojtjeje nga e drejta e autorit

1. Nuk janë objekt i së drejtës së autorit dhe nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj:

a) idetë, teoritë, konceptet, zbulimet dhe shpikjet në një vepër krijuese, pavarësisht nga mënyra e marrjes, e të shpjeguarit ose e të shprehurit;

b) shpikjet, aktet ligjore, administrative dhe gjyqësore, si dhe krijime të tjera zyrtare dhe koleksionet e tyre, të paraqitura me qëllim që të informohet zyrtarisht publiku;

c) simbolet zyrtare të shtetit, të organizatave dhe autoriteteve publike, si për shembull: armët, vula, flamuri, emblemat, medaljoni, shenja dalluese, medalja;

ç) mjetet e pagesës;

d) lajmet dhe informacioni i shtypit, i cili ka karakter të thjeshtë informimi;

dh) të dhënat dhe faktet e thjeshta.

2. Krijimet letrare popullore dhe artistike popullore në formën e tyre origjinale nuk janë objekt i së drejtës së autorit, por komunikimi i tyre në publik është subjekt i pagesës së shpërblimit, kur komunikimi në publik është për veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit. Shpërblimi do të përdoret për nxitjen dhe stimulimin kulturor e artistik me natyrë jofitimprurëse në fushat përkatëse artistike dhe kulturore, në përputhje me rregullat e shpërndarjes së shpërblimit nga agjencitë e administrimit kolektiv për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

KREU II

AUTORËSIA

Neni 13

Autori

Autor është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.

Neni 14

E drejta e autorit në veprat me bashkautorësi

1. E drejta e autorit në një vepër, që është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta krijuese të dy ose më shumë autorëve, më tej bashkautorë, u përket atyre në mënyrë të përbashkët, pavarësisht nëse vepra përbën një të tërë të pandashme ose është bashkim i pjesëve të pavarura.

2. Marrëdhëniet midis bashkautorëve dhe shpërblimi i tyre përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve, sipas Kodit Civil.

Në mungesë të kësaj marrëveshje, administrimi i së drejtës së autorit mbi veprën e përbashkët dhe shpërblimi përkatës ndahet midis tyre, sipas Kodit Civil.

3. Pavarësisht se bashkautorët e ushtrojnë të drejtën e autorit së bashku për veprën në tërësi, secili prej tyre mund të përdorë pjesën e tij të veprës së përbashkët, nëse ajo është lehtësisht e identifikueshme, me përjashtim të dy rasteve:

a) kur me marrëveshje mes bashkautorëve është ndaluar shprehimisht përdorimi i pavarur i pjesëve të krijuara nga secili prej tyre;

b) kur përdorimi i pavarur i krijimeve të secilit prej bashkautorëve dëmton përdorimin në tërësi të veprës së përbashkët.

4. Personi, i cili ka dhënë materiale, asistencë teknike ose organizative në procesin e krijimit të veprës së përbashkët nuk do të konsiderohet si bashkautor.

Neni 15

E drejta e autorit për përmbledhjet

1. Personat fizikë apo juridikë, privatë a publikë, në bazë të nismës ose drejtimit të të cilëve është krijuar një përmbledhje, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, ose me emrin e të cilëve është botuar, janë mbajtës të të drejtave ekonomike të autorit dhe i gëzojnë këto të drejta sikur të ishin autorët e kësaj përmbledhjeje. Këto subjekte kanë të drejtë të vendosin emrin ose titullin e tyre dhe të kërkojnë përmendjen e tyre në çdo përdorim publik të këtyre përmbledhjeve.

2. Të gjithë autorët e veprave, kontributeve ose materialeve të tjera, që janë të përfshira në përmbledhje, do të konsiderohen të kenë të drejtë për një ndarje të barabartë të shpërblimit që do të merret nga përdorimi i saj, përveçse kur parashikohet ndryshe me kontratë ose me rregullat e parashtruara në këtë ligj.

3. Autorët e atyre veprave, kontributeve ose materialeve të tjera që janë të përfshira në përmbledhje, ruajnë të drejtat ekskluzive mbi veprat e tyre për t'i shfrytëzuar në mënyrë të pavarur nga përdorimi në tërësi i përmbledhjes, përveçse kur parashikohet ndryshe me kontratë midis autorëve dhe personit fizik ose juridik të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 16

Prezumime ligjore mbi autorësinë

1. Në mungesë të provave për të kundërtën, çdo individ ose grup individësh, emri i të cilit shfaqet mbi një vepër, cilado qoftë mënyra e shfaqjes, prezumohet autor i veprës.

2. Kur vepra botohet shfaqet/transmetohet në formë anonime ose nën një pseudonim, në një mënyrë që e bën të pamundur identifikimin e autorit, në mungesë të provave për të kundërtën, botuesi ose shfaqësi apo transmetuesi i një veprë të pabotuar konsiderohet si mbajtës i së drejtës së autorit dhe me këtë cilësi gëzon të drejtën të mbrojtë e të ushtrojë të drejtat e autorit. Zbatimi i rregullit të mësipërm pushon kur autori zbulon identitetin e tij dhe provon përpara organeve gjyqësore autorësinë e veprës së tij.

Neni 17

Mbrojtja automatike, pa asnjë formalitet, e së drejtës së autorit

Autorët gëzojnë të drejtën e autorit mbi veprat e tyre, sipas parashikimeve të këtij ligji, për faktin e vetëm të realizimit të krijimit. Për ekzistencën dhe zbatimin e së drejtës së autorit nuk kërkohet asnjë regjistrim i veprës ose formalitete të tjera.

Neni 18

Regjistrimi i veprave të së drejtës së autorit

1. Autorët mund të regjistrojnë vullnetarisht veprat e tyre në një regjistër të veçantë, i cili mbahet në formë elektronike ose shkresore ose të dyja bashkë në mënyrën e përcaktuar nga Drejtoria për të Drejtat e Autorit.

2. Regjistrimi vullnetar i veprave në regjistrin e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit ka efekt ligjor derisa me vendim gjyqësor të provohet e kundërta.

3. Procedurat e regjistrimit, organizimi, klasifikimi dhe tarifatat e regjistrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Marrëdhënia midis së drejtës së autorit dhe pronësisë mbi objektet fizike

E drejta e autorit ekziston në mënyrë të pavarur nga çdo e drejtë pronësie mbi objektin fizik, në të cilin është shprehur ose materializuar krijimi intelektual. Marrëdhënia midis së drejtës së autorit mbi veprën dhe pronësisë rregullohet në mënyrë specifike në kreun V të këtij ligji.

KREU III

PËRMBAJTJA E TË DREJTAVE TË AUTORIT

Dispozita të përgjithshme

Neni 20

Llojet e të drejtave

1. E drejta e autorit përfshin dhe mbron të drejtat vetjake jopasurore të autorit, duke siguruar respektin ndaj cilësive të tij intelektuale dhe personale në punë dhe të drejtat pasurore të autorit në lidhje me interesat e tij ekonomikë.

2. Autori ka të drejtën e shpërblimit për çdo përdorim të veprës së tij, përveçse nëse parashikohet ndryshe me këtë ligj ose me kontratë.

Seksioni 1

Të drejtat vetjake jopasurore

Neni 21

E drejta e bërjes publike të veprës

1. Autori ka të drejtë të vendosë për kohën dhe vendin, si dhe për mënyrën me të cilën dëshiron t'ia bëjë të njohur për herë të parë veprën publikut.

2. Përpara bërjes publike të veprës, çdo informacion për përmbajtjen e tij mund t'i jepet publikut vetëm me pëlqimin e autorit.

Neni 22

E drejta e njohjes dhe përmendjes së autorësisë

1. Autori ka të drejtën të njihet dhe të përmendet si autor i veprës. Kjo e drejtë ekziston në mënyrë të pavarur nga e drejta pasurore e autorit, edhe pas transferimit të të drejtave ose tagrave të saj.

2. Përdoruesit e një vepre, e cila mbrohet në kuptim të këtij ligji, janë të detyruar të shkruajnë dhe të përmendin emrin e autorit në çdo kopje ose përdorim të veprës, me përjashtim të rasteve kur autori deklaron në formë të shkruar se heq dorë nga e drejta për t'iu përmendur autorësia, në përputhje me natyrën e veprës dhe përdorimin e saj.

3. Autori ose trashëgimtarët e tij gëzon/jnë të drejtën vetjake jopasurore për të pretenduar bashkautorësinë e autorit në një vepër, si dhe për të kundërshtuar bashkautorësinë e vendosur në mënyrë arbitrare nga të tjerët për çfarëdolloj shkak.

4. Autori ka të drejtë të vendosë se në emrin e kujt do të paraqitet vepra e tij te publiku, si dhe të drejtën që të mbetet anonim ose me pseudonimin e zgjedhur prej tij.

Neni 23

E drejta e nderit, personalitetit dhe reputacionit

Pavarësisht nga të drejtat pasurore të autorit, edhe pas transferimit të të drejtave në fjalë, autori ka të drejtën të kundërshtojë çdo shtrembërim, ndryshim, tjetërsim ose veprime të tjera denigruese që nuk respektojnë tërësinë e veprës, duke cenuar nderin, personalitetin dhe reputacionin e tij, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 24

E drejta e tërheqjes së lejes për shfrytëzimin e veprës

1. Autori ose trashëgimtarët e tij, të cilët e fitojnë këtë të drejtë sipas legjislacionit civil dhe dispozitave të këtij ligji, ka/kanë të drejtë të tërheqë/in lejen/autorizimin për shfrytëzimin e veprës dhe të ndalojë/në përdorimin në vazhdimësi të saj që është bërë publike, duke u bazuar në arsye të mirëqena, mbrojtjen e reputacionit, nderit ose rrethanave të tjera. Në këtë rast, autori është i detyruar të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen titullarit të ligjshëm të autorizimit, si pasojë e ushtrimit të së drejtës së përmendur në këtë pikë.

2. E drejta e tërheqjes së lejes/autorizimit për shfrytëzimin e veprës hyn në fuqi nga dita kur autori/trashëgimtari depoziton garancinë monetare për kompensimin e dëmit, sipas parashikimit të këtij neni.

3. Përdoruesi që shfrytëzon të drejtat e autorit mbi veprën, brenda tre muajve nga dita e marrjes së njoftimit për tërheqjen e lejes/autorizimit, parashikuar në pikën 1, të këtij neni, i komunikon autorit/trashëgimtarit vlerën e shpenzimeve të kryera për përdorimin e veprës së tij deri në atë ditë. Nëse përdoruesi nuk ushtron këtë të drejtë, tërheqja e lejes për shfrytëzimin e veprës hyn në fuqi me përfundimin e afatit të përmendur në këtë pikë.

4. E drejta e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e një vepre që krijohet në bazë të një kontrate punësimi ose porosie, as në rastin e veprave audiovizuale ose programeve kompjuterike dhe bazës së të dhënave. Në rastin e këtyre veprave, autori mund të kërkojë vetëm që emri i tij të mos përmendet në kopjet e veprave ose në çdo përdorim të tij.

5. Brenda një periudhe prej 10 vjetësh, nëse, pas ushtrimit të së drejtës për tërheqjen e lejes/autorizimit për shfrytëzimin e veprës, autori lejon/autorizon përdorimin e së njëjtës veprë ose një veprë thelbësisht të ngjashme me të, ai është i detyruar t'i ofrojë paraprakisht mundësinë e përtëritjes së kontratës së përdorimit subjektivit që kishte të drejtën e përdorimit të veprës përpara ushtrimit të kësaj të drejte, në bazë të të njëjtave kriterë apo kriterëve thelbësisht të ngjashme, përkatësisht, siç është rënë dakord fillimisht në kontratën me shkrim.

6. Nëse autori nuk lë trashëgimtarë, trashëgimia për ushtrimin e të drejtave vetjake jopasurore, të përmendura në këtë seksion, do të përcaktohet sipas dispozitave të Kodit Civil.

7. Të drejtat vetjake jopasurore nuk përbëjnë objekt dorëheqjeje, nuk janë të transferueshme, të licencueshme, të tjetërsueshme dhe nuk parashkruhen.

Seksioni 2

Të drejtat ekskluzive pasurore të autorëve

Neni 25

Të drejtat ekskluzive pasurore

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, autori/trashëgimtarët gëzojnë të drejta ekskluzive pasurore për të gëzuar, autorizuar apo ndaluar përdorimin e veprave ose kopjeve të veprave të tyre. Të drejtat ekskluzive pasurore parashikojnë në mënyrë specifike:

- a) të drejtën e riprodhimit të veprës;
- b) të drejtën e shpërndarjes së veprës;
- c) të drejtën e komunikimit në publik të veprës;
- ç) të drejtën për të bërë vepra të prejardhura.

2. Çdo mënyrë e shfrytëzimit të origjinalit të një vepre ose të kopjeve të saj, pa lejen e autorit/trashëgimtarit/ose personit të autorizuar prej tij, do të konsiderohet e paligjshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 26

E drejta e riprodhimit

E drejta e riprodhimit është e drejta ekskluzive pasurore e autorit për të autorizuar ose ndaluar bërjen e një ose më shumë kopjeve të një vepre apo objekti të të drejtave të lidhura, qoftë pjesërisht ose plotësisht, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, në çfarëdolloj forme dhe mjete, përfshirë regjistrimin audio ose video, si dhe për ruajtjen e përkohshme apo të përhershme të veprës apo objektit të të drejtave të lidhura në një mjedis elektronik.

Neni 27

E drejta e shpërndarjes

1. E drejta e shpërndarjes është e drejta ekskluzive pasurore e autorit për të autorizuar ose ndaluar vënien, në mënyrë të ligjshme, në dispozicion të publikut, origjinalet ose kopjet e veprave apo të drejtat e tjera të lidhura me të, nëpërmjet shitjes apo tjetërsimeve të tjera dhe që i ofrohen publikut me këtë qëllim, si dhe importimin, eksportimin, shpërndarjen e kopjeve të veprave të prodhuara me pëlqimin e tij.

2. Në kuptim të këtij ligji:

a) me “import” kuptohet vendosja në qarkullimin e lirë ose hyrjet në tregun vendas, për qëllime tregtare, të veprave origjinale ose kopjeve të tyre të ligjshme, të fiksuara në çdo formë;

b) me “eksport” kuptohet vendosja në tregun e lirë ose daljet nga tregu vendas, për qëllime tregtare, të veprave origjinale ose kopjeve të tyre të ligjshme, të fiksuara në çdo formë;

c) me “shpërndarje” kuptohet shitja ose çdo mënyrë tjetër e përcjelljes, për një shërbim të caktuar, me ose pa pagesë, e veprave origjinale ose kopjeve e tyre, si dhe ofrimi i tyre për publikun.

3. Me transferimin e parë të pronësisë së veprës origjinale ose të kopjeve të ligjshme të tij nga autori ose me autorizimin e tij tek të tretët, autorit i shuhet e drejta ekskluzive e shpërndarjes së asaj vepre në Republikën e Shqipërisë.

4. Shuarja e së drejtës ekskluzive të shpërndarjes nuk përbën shkak për shuarjen e së drejtës së qiradhënies, eksportit, importit, ashtu si edhe të së drejtës së përfitimit nga huadhënia publike e një vepre të autorizuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Në rastet e përmbledhjeve, shuarja e së drejtës së shpërndarjes i referohet vetëm shitjes së mëtejshme.

Neni 28

E drejta e qiradhënies

1. E drejta e qiradhënies është e drejta ekskluzive pasurore për të gëzuar ose autorizuar dhënien me qira për një periudhë të kufizuar kohore ose për të ndaluar dhënien me qira të veprës së:

a) autorit, në lidhje me origjinalin dhe kopjet e veprës së tij;

b) interpretuesit, në lidhje me fiksimin e performancës së tij;

c) prodhuesit të fonogramit, në lidhje me fonogramet e tij;

ç) prodhuesit të fiksimit të parë të një filmi, në lidhje me origjinalin dhe kopjet e filmit të tij.

2. Autori, i cili ka hequr dorë nga e drejta e tij e dhënies me qira në favor të një prodhuesi të fonogrameve ose një producenti filmash, ruan të drejtën për të marrë një shpërblim të drejtë për qiranë e veprës së tij, për të cilën ka të drejtën e autorit. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e shpërblimit të drejtë. Shpërblimi për qiranë do të paguhet nga personi që ka marrë me qira veprën e autorit.

3. E drejta e qirasë së një vepre autori, sipas këtij ligji, nuk do të zbatohet për veprat ekzistuese arkitekturore dhe të artit të aplikuar.

4. Të drejtat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të transferohen, të kalohen ose të jenë objekt kontraktual mes palëve.

Neni 29

Komunikimi në publik i një vepre të mbrojtur nga e drejta e autorit

Autori ka të drejtë ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar komunikimin e veprës së tij në publik, e drejtë që përfshin në veçanti:

a) të drejtën e shfaqjeve publike si:

i) e drejta e recitimit/shfaqjes në publik të veprave të fushës letrare ose shkencore që lexohen ose recitohen/shfaqen në mënyrë të drejtpërdrejtë;

ii) e drejta e shfaqjes muzikore në publik të veprave muzikore të interpretuara në mënyrë të drejtpërdrejtë;

b) të drejtën e shfaqjes skenike në publik, që do të thotë prezantim i drejtpërdrejtë i veprave dramatike, dramatiko-muzikore, si dhe veprave koreografike apo në pantomime në publik;

c) të drejtën e përcjelljes në publik të një veprë, që është e drejta për të përcjellë një recitim, shfaqje muzikore ose një shfaqje skenike të një veprë tek publiku që nuk është i pranishëm në vendin ku interpretohet vepra dhe tek i cili përcillet me anë të altoparlantit, ekranit apo mjeteve të tjera teknike;

ç) të drejtën e përcjelljes në publik të veprave të palëvizshme/të fiksuara, që do të thotë paraqitja e veprave të vendosura në fonogram ose videogram, me anë të fonogramit ose videogramit;

d) të drejtën e paraqitjes publike, që do të thotë ekspozimi publik i veprave të artit pamor, të arkitekturës, të arteve të aplikuara, i një punimi fotografik; krijimi kinematografik ose çdo punim tjetër audiovizual, një punimi hartografik ose një prezantimi me natyrë shkencore apo teknike me anë të mjeteve teknike;

dh) të drejtën e transmetimit për publikun të një veprë, që përfshin përcjelljen e veprës me anë të çdo mënyrë riprodhimi të sinjaleve, tingujve ose pamjeve dhe/ose tingujve dhe pamjeve njëherësh, me ose pa tel, për marrjen e tyre nga publiku në mënyrë që:

i) transmetimi i sinjaleve, mbartëse të programit/veprës që i ofrohet publikut, të mundësohet nëpërmjet pajisjeve për çkodim të sinjaleve nga një ofrues i shërbimit mediatik audioviziv ose nga një palë e tretë e autorizuar prej saj;

ii) futja e sinjaleve, mbartëse të programit/veprës, që synohet të merren nga publiku, të mundësohet nga zinxhiri i pandërprerë i përcjelljes që, nën përgjegjësinë e shoqërisë transmetuese, përcillet në satelit dhe zbrit drejt tokës dhe që më tej njihet si “transmetim nëpërmjet satelitit”;

e) të drejtën e ritransmetimit, e cila nënkupton të drejtën ekskluzive për përcjelljen në publik në mënyrë të patjetërsuar, të pandërprerë, të njëkohshme të një transmetimi të një veprë të së drejtës së autorit:

i) kur bëhet nga një ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA) te një tjetër ofrues shërbimi mediatik audioviziv;

ii) kur bëhet nga sistemi me kabëll ose mikrovalor për marrjen nga publiku të transmetimit që vjen nga një tjetër ofrues shërbimi mediatik audioviziv (ritransmetim kabllor);

ë) të drejtën e përcjelljes në publik të transmetimit, e cila nënkupton të drejtën ekskluzive për përcjelljen në publik të një transmetimi të një veprë të së drejtës së autorit me anë të një altoparlantit, ekranit ose me mjete të tjera të ngjashme teknike;

f) të drejtën e vënies së veprave në dispozicion të publikut, që do të thotë e drejta ekskluzive për të përcjellë në publik një veprë, me ose pa tel, në mënyrë të tillë që të jetë e arritshme për pjesëtarët e publikut në vendin dhe në kohën e zgjedhur prej tyre.

Neni 30

E drejta për të bërë vepra të prejdardhura

E drejta për të bërë vepra të prejdardhura nënkupton të drejtën ekskluzive të autorit apo titullarit të veprës për të autorizuar çdo përshtatje, për të përkthyer, botuar në një përmbledhje, për të bërë aranzhime muzikore, si dhe çdo transformim tjetër që mund t'i bëhet veprës së tij ekzistuese.

Seksioni 3

Të drejta të tjera pasurore të autorëve

Neni 31

E drejta e shpërblimit për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal

1. Autori, veprat e të cilit, për shkak të natyrës, mund të riprodhohen pa autorizim, në kushtet e nenit 72, të këtij ligji, nëpërmjet fotokopjes, regjistrim zëri, videos/figurës, tekstit ose nëpërmjet çdo forme tjetër për përdorim personal privat apo tjetër, ka të drejtën e shpërblimit të arsyeshëm nga shitja e materialeve teknike, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e tekstit, zërit apo figurës, si dhe materiale, të cilat bëjnë të mundur mbajtjen/fiksimin e veprave nëpërmjet zërit, figurës, tekstit. Lista e pajisjeve, si dhe tarifat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përveç së drejtës në pikën 1, të këtij neni, autorët kanë të drejtën e shpërblimit të arsyeshëm nga një person fizik ose juridik, i cili ofron shërbimet e fotokopjimit me pagesë.

3. Çdo teknikë tjetër riprodhimi do të njësohet me fotokopjen dhe çdo lloj pajisjeje, e cila ofron të njëjtin efekt, do të njësohet me pajisjet e regjistrimit vizual dhe zanor.

4. Shpërblimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, do të paguhet nga prodhuesit e pajisjeve të regjistrimit vizual dhe zanor, prodhuesit e pajisjeve të fotokopjeve, prodhuesit e kasetës boshe, që mundëson kopje të njëjtë me origjinalin, videot ose mjetet e fiksimit të tekstit dhe importuesit e këtyre pajisjeve, përveçse kur importohen sasi të vogla të destinuara për përdorim privat dhe jotregtar, duke qenë pjesë e bagazheve personale. Nëse pajisjet dhe objektet e përmendura nuk janë prodhuar në Republikën e Shqipërisë, shpërblimi paguhet nga importuesi.

5. Detyrimi për të paguar shpërblimin e arsyeshëm, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, do të rrjedhë:

a) nga shitja e parë ose importi në Republikën e Shqipërisë të pajisjeve/materialeve të reja për regjistrimin vizual dhe zanor;

b) nga shitja e parë ose importi në Republikën e Shqipërisë të kasetave dhe videokasetave boshe ose çdo mjeti të fiksimit të tekstit;

c) nga shitja e parë ose importi në Republikën e Shqipërisë të pajisjeve/materialeve të reja të fotokopjimit.

6. Shpërblimi i përmendur në pikën 2, të këtij neni, paguhet në vlerën e llogaritur në varësi të informacionit për numrin e fotokopjeve të bëra.

7. Autorët nuk mund të heqin dorë nga të drejtat për shpërblim, të referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

8. Një shpërblim i arsyeshëm, i referuar në këtë nen, do të jetë ai shpërblim i dhënë me kontratë/marrëveshje, duke marrë parasysh mundësinë e dëmit të shkaktuar autorit të veprës, në rastet kur vepra është riprodhuar pa autorizimin e tij për përdorim privat ose përdorime personale të tjera, aplikimin e masave teknologjike mbrojtëse, si dhe të rrethanave të tjera, që mund të konsiderohen të drejta në formë dhe përmbajtje për një shpërblim të arsyeshëm.

Neni 32

E drejta e huadhënies publike

1. Në zbatim të këtij ligji, “huadhënie publike” është vënia në dispozicion për përdorim e një vepre për një periudhë të kufizuar kohe dhe jo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta pasurore apo tregtare, përmes institucioneve që lejojnë aksesin e publikut dhe që, për këtë qëllim, kryejnë këtë aktivitet si shërbim publik.

2. Autorët kanë të drejtën ekskluzive të autorizimit apo ndalimit të huadhënies publike të veprave, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj, në të cilat autorët gëzojnë vetëm të drejtën për marrjen e shpërblimit të drejtë për përdorimin publik të veprës së tyre.

3. Autorët e veprave audiovizuale, veprave të trupëzuara në fonograme dhe programe kompjuterike kanë të drejtë ekskluzive për lejimin ose ndalimin e huadhënies publike të veprave të tyre. Huadhënia e këtyre veprave do të vendoset pas 6 muajve pas shpërndarjes së parë të veprës.

4. Pikat e mësipërme nuk zbatohen për përdorimin e origjinalit ose ekzemplarëve të veprave në Bibliotekën Kombëtare, institucionet arsimore/akademike, si dhe në bibliotekat publike me hyrje të lirë/pa pagesë, strukturat arkitekturore, të origjinalit ose ekzemplarëve të veprave të arteve të aplikuara, të origjinalit ose ekzemplarëve të veprave për qëllimin e përcjelljes në publik.

5. Autorët e veprave letrare dhe veprave muzikore në formën e fletës së pentagramit kanë të drejtën të marrin shpërblim të drejtë për dhënien e veprës së tyre publikut për huapërdorje.

6. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e përmendur në pikën 2 të këtij neni.

7. Me përjashtim të përcaktimit në pikën 1, të këtij neni, autorët e bazave të të dhënave do të kenë të drejtën ekskluzive të huazimit publik të origjinaleve ose të kopjeve të bazave të tyre të të dhënave.

8. Procedura dhe mënyra e shpërblimit të drejtë për huadhënien publike, në kuptim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrive.

Neni 33

E drejta e rishitjes

1. Në vijim të transferimit të parë të pronësisë së një vepre origjinale arti, mbajtësi i së drejtës së autorit, autori personalisht ose, pas vdekjes së tij, trashëgimtarët, ka/kanë të drejtën e patjetërsueshme, e cila nuk mund të hiqet as edhe paraprakisht, për marrjen e shpërblimit, bazuar mbi çmimin e përfutur të shitjes për çdo akt rishitjeje të veprës.

2. Kjo e drejtë gjen zbatim për të gjitha aspektet e rishitjes që përfshijnë: shitësin, blerësin, agjentët e artit dhe në përgjithësi çdo person që merret me tregtimin e veprave të artit, si dhe kur këto veprimtari kryhen në mjediset ku shiten veprat e artit, si galeritë e artit, ankandet etj.

3. Përjashtimisht, parashikimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohet kur shitësi është një galeri arti që ka fituar të drejtën e pronësisë mbi veprën drejtpërdrejt nga autori, prej jo më shumë se tre vjetëve para se të rishitej, dhe çmimi i rishitjes nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të 10 000 eurove.

4. E drejta e rishitjes, sipas parashikimit të këtij neni, gjen zbatim, me ndryshimet e nevojshme, edhe në rastin e rishitjes së veprave origjinale të artit që kanë hyrë në domen publik.

Neni 34

Veprat origjinale të artit pamor dhe shpërblimi i drejtë i autorit

1. Në kuptim të këtij ligji, “vepër e artit pamor” është çdo vepër e arteve pamore, si: fotot, kolazhet, pikurat, vizatimet, gravurat, stampimet, litografitë dhe skulpturat, vepra të tilla të arteve të aplikuara, si tapiceritë, qeramikat dhe punimet e qelqit e krijimet fotografike, me kusht që të jenë bërë nga vetë autori ose të jenë kopje që konsiderohen si vepra origjinale arti.

2. Kopjet e veprave të artit konsiderohen si vepra origjinale nëse janë bërë në numër të kufizuar nga vetë autori ose nën autoritetin e tij, si dhe ato që janë të numërtuara, të nënshkruara apo të autorizuara në një mënyrë tjetër nga autori.

3. Një shitës, i cili rishet veprat e përmendura në pikat e mësipërme me një çmim që kalon vlerën ekuivalente në lekë të 500 eurove, duhet të paguajë në favor të autorit një shumë, si më poshtë, të konvertueshme në monedhën në lekë:

a) 5 për qind e shumës së çmimit të shitjes deri në një masë të barasvlershme me nga 500 euro deri në 3 000 euro;

b) 4 për qind e shumës së çmimit të shitjes deri në një masë të barasvlershme me nga 3 000,01 euro deri në 50 000 euro;

c) 3 për qind e vlerës së çmimit të shitjes, deri në një masë të barasvlershme me nga 50 000,01 euro deri në 200 000 euro;

ç) 1 për qind e vlerës së çmimit të shitjes, deri në një masë të barasvlershme me nga 200 000,01 euro deri në 350 000 euro;

d) 0,5 për qind e vlerës së çmimit të shitjes, deri në një masë të barasvlershme me nga 350 000,01 euro deri në 500 000 euro;

dh) 0,25 për qind e vlerës së çmimit të shitjes që tejkalon 500 000 euro.

4. Shuma totale, e cila është bazuar në kushtet e pikës 3, të këtij neni, që i përket autorit për çdo rishitje, nuk duhet të tejkalojë shumën ekuivalente në lekë të 12 500 eurove. Për llogaritjen e kësaj shume do të merret si bazë çmimi neto i shitjes.

5. Çmimet e shitjes, të përmendura në pikën 3, të këtij neni, janë neto, pa përfshirë TVSH-në apo detyrime të tjera fiskale. Asnjë shpërblim nuk paguhet kur çmimi i shitjes neto është më i ulët sesa shuma e barasvlershme me 500 euro.

6. Shuma në lekë përlllogaritjet në bazë të kursit zyrtar të shkëmbimit, të nxjerrë nga Banka Qendrore e Shqipërisë, i vlefshëm ditën e parë të tremujorit kalendarik në të cilin kryhet shitja.

7. Në rast se në transaksionin e transferimit të pronësisë janë përfshirë më shumë sesa një tregtar i krijimeve të artit, ata kanë detyrime të përbashkëta dhe individuale për pagesën e shpërblimit. Në këtë rast, përveçse kur tregtarët e krijimeve të artit bien dakord ndryshe, shitësi është i detyruar të paguajë shpërblimin. Në rast se asnjë nga tregtarët e krijimeve të artit, të përfshirë në shitblerje, nuk merr pjesë në transferim si shitës, shpërblimi paguhet nga blerësi, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

8. Për një periudhë 3-vjeçare pas rishitjes, autori ose përfaqësuesit e tij ka/kanë të drejtë t'i kërkojë/në personave të përmendur në nenin 33, pika 2, të këtij ligji, të ofrojnë çdo informacion që mund të jetë i nevojshëm për mbledhjen e shpërblimit që i përket atij nga rishitja.

9. Përcaktimet e pikave 1 deri në 8, të këtij neni, gjejnë zbatim për:

a) autorin ose trashëgimtarin ligjor që është shtetas ose ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë ose në çdo shtet anëtar të Bashkimit Europian;

b) shtetasit e vendeve jashtë Bashkimit Europian, me kusht që legjislacioni në vendin ku autori ose trashëgimtari i tij ligjor është shtetas të parashikojë të drejtën për marrjen e shpërblimit edhe për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

10. Parashikimet e përcaktuara në seksionin e këtij ligji për kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit do të zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtës së rishitjes.

Neni 35

Heqja dorë, transferimi dhe ekzekutimi i së drejtës së rishitjes

1. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij për rishitje.
2. E drejta e rishitjes nuk do të transferohet me kontratë/marrëveshje ligjore gjatë jetës së autorit. Pas vdekjes së autorit, e drejta e rishitjes i kalon trashëgimtarëve të tij, të cilët përfitojnë vlerën e shpërblimit.
3. E drejta e rishitjes nuk mund të jetë objekt i ekzekutimit të detyrimeve.

Neni 36

E drejta e autorit për akses

1. Autori ka të drejtë t'i kërkojë pronarit/titullarit të të drejtave apo poseduesit të veprës origjinale ose kopjes së saj që t'i lejojë mundësinë e qasjes ose aksesit, me qëllim të bërjes së kopjeve mbi veprën ose vepra të prejardhura, sipas nenit 30, të këtij ligji, si dhe pa cenuar interesin legjitim të mbajtësit të të drejtave ose poseduesit të veprës.
2. Pronarit/poseduesit të veprave nuk mund t'i kërkohej vepra nga autori në asnjë rast dhe për asnjë qëllim të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nuk e detyron pronarin apo poseduesin e drejtpërdrejtë për t'i shpërndarë autorit origjinalin ose kopjen e veprës.

Neni 37

E drejta për të ndaluar ekspozimin publik të veprës

1. Autori i një vepre të pazbuluar të artit pamor, artit të aplikuar dhe një vepre të pazbuluar fotografike, në tjetërsimin e origjinalit ose ekzemplarit të veprës së tij rezervon të drejtën të ndalojë pronarin për ta ekspozuar punën për publikun.
2. Autori ndalon ekspozimin publik, të cilit i referohet në pikën 1, të këtij neni, në formë të shkruar.
3. Çdo përdorim/shfrytëzim publik i veprave të arteve të bukura, që paraqet një portret të një individi, lejohet vetëm me pëlqimin e personit/individit të paraqitur ose trashëgimtarëve të tij të ligjshëm, sipas legjislacionit civil në fuqi.
4. Autori nuk ka të drejtën e referuar në pikën 1, të këtij neni, nëse vepra i përket muzeut, galerisë ose ndonjë institucioni tjetër publik të ngjashëm.

Neni 38

E drejta e autorit mbi veprat fotografike

1. Pamjet e personave ose të paraqitjeve, elementeve apo ngjarjeve të natyrës ose jetës, të marra nëpërmjet proceseve fotografike, duke përfshirë riprodhimet e veprave të artit figurativ dhe pozave të veprave audiovizuale, do të konsiderohen fotografi në kuptim të këtij ligji.
2. Nuk do të konsiderohen objekt i këtij neni fotografitë e shkrimeve, dokumenteve, letrave të biznesit, objekteve materiale, vizatimeve teknike dhe produkteve të ngjashme.
3. Transferimi i pronësisë së negativit ose çdo trupëzimi të ngjashëm të një vepre fotografike, mbi bazën e së cilës mund të bëhen kopje, përveç rasteve kur parashikohet

ndryshe me anë të një kontrate me shkrim, sjell si rrjedhojë kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, përveç së drejtës së rishitjes.

4. Individit i portretizuar në një vepër fotografike të porositur prej tij kryen çdo veprim që mbulohet nga të drejtat pasurore edhe pa autorizimin e autorit të fotografisë, përveçse kur në kontratën me shkrim parashikohet ndryshe.

Neni 39

E drejta e autorit mbi veprat e arteve të aplikuara dhe veprat e arkitekturës

1. Mbrojtja nga e drejta e autorit e dhënë nga ky ligj për veprat e arteve të aplikuara shtrihet në formën e jashtme të objekteve të përfshira, të shprehura nga tipare, të tilla si: vijat, konturet, format, teksturat etj. Mbrojtja mbulon objektet dy dhe tredimensionale.

2. Mbrojtja e së drejtës së autorit, e parashikuar nga ky ligj, për veprat e arkitekturës shtrihet te ndërtesat dhe ndërtimet e ngjashme arkitekturore, si edhe te projektet e tyre.

3. E drejta e përshtatjes së veprës së arteve të aplikuara ose veprës së arkitekturës nuk përfshin ato lloj ndryshimesh që nuk sjellin si rezultat ndryshimin e formës së jashtme të veprës.

4. E drejta e qiradhënies nuk gjen zbatim për veprat e arkitekturës në forma tredimensionale, si dhe për veprat e arteve të aplikuara.

KREU IV

KOHËZGJATJA E MBROJTJES SË TË DREJTËS SË AUTORIT

Neni 40

Kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtave morale vetjake jopasurore

Të drejtat vetjake jopasurore të autorëve mbrohen pa asnjë kufi kohor. Pas vdekjes së autorit, mbrojtja e këtyre të drejtave merret përsipër nga trashëgimtarët ligjorë dhe, në mungesë të tyre, bëhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil.

Neni 41

Afatet e mbrojtjes së të drejtave pasurore

1. Të drejtat pasurore, të parashikuara nga ky ligj, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky nen, mbrohen gjatë gjithë jetës së autorit dhe deri në 70 vjet pas vdekjes së tij, pavarësisht nga data kur vepra është bërë publike në mënyrë të ligjshme. Pas vdekjes së autorit, të drejtat pasurore do të transferohen nëpërmjet trashëgimisë, sipas legjislacionit civil.

2. Afatet e përcaktuara në këtë seksion fillojnë nga data 1 janar e vitit pasardhës të vdekjes së autorit ose, sipas rastit, të shfaqjes së parë të ligjshme në publik të veprës.

3. Të drejtat pasurore mbi një vepër me bashkautorësi mbrohen deri në vdekjen e bashkautorit të fundit dhe deri në 70 vjet pas vdekjes së tij.

4. Të drejtat pasurore mbi një vepër muzikore me tekst mbrohen deri 70 në vjet pas vdekjes së autorit të fundit të mbetur gjallë, autorit të tekstit ose kompozitorit të veprës muzikore, nëse ata janë ose jo persona të caktuar si bashkautorë dhe në rast se kontributi i të

dyve ishte posaçërisht i krijuar për përdorimin e së njëjtës vepër muzikore. Nëse muzika ose teksti, përkatësisht, nuk është krijuar posaçërisht për të njëjtën vepër muzikore me tekst, do të zbatohen rregullat e përgjithshme për kohëzgjatjen e së drejtës së autorit.

5. Të drejtat pasurore të një veprë audiovizuale mbrohen deri në 70 vjet pas vdekjes së autorit të fundit të mbetur gjallë, nëse këta persona janë ose nuk janë përcaktuar si bashkautorë, sipas nenit 97 të këtij ligji, të krijuar posaçërisht për përdorimin e veprës audiovizuale.

6. Të drejtat pasurore të veprave anonime ose nën pseudonim mbrohen deri në 70 vjet. Afati llogaritet nga 1 janari i vitit pasardhës nga vënia e veprës në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme. Kur kjo vepër nuk është vënë në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut brenda 70 viteve nga krijimi i saj, mbrojtja e së drejtës së autorit pushon.

Kur pseudonimi i vendosur nga autori nuk lë dyshime për identitetin e tij, gjen zbatim përcaktimi i pikës 1, të këtij neni. Ky përcaktim gjen zbatim edhe kur autori i një veprë anonime ose nën pseudonim zbulon identitetin e tij ose kur identiteti i tij bëhet i qartë gjatë asaj periudhe kohe.

7. Të drejtat pasurore të përmbledhjeve mbrohen deri në 70 vjet nga vënia e veprës në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut. Sidoqoftë, kur autorët e veprave, kontributeve apo materialeve të tjera në një përmbledhje mund të identifikohen në raport me këto vepra, kontribute apo materiale të tjera, gjejnë zbatim, përkatësisht, përcaktimet e pikës 1 ose 3 të këtij neni.

8. Kur vepra është publikuar me vëllime, pjesë, kapituj, numra ose episode, afati i mbrojtjes fillon nga koha kur vepra është vënë në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut, dhe në këtë rast gjejnë zbatim kriteret e mbrojtjes, të parashikuara në pikën 1 deri në pikën 6, të këtij neni, për secilin prej zërave individualisht.

9. Nëse afati i mbrojtjes së të drejtave pasurore të veprës në vendin e tij të origjinës është më i gjatë sesa afati i mbrojtjes së parashikuar nga ky ligj, gjejnë zbatim dispozitat e këtij ligji. Nëse ky afat është më i shkurtër, gjen zbatim afati i parashikuar në vendin e origjinës.

10. Me mbarimin e afatit të mbrojtjes së të drejtave pasurore, vepra konsiderohet vepër në domenin publik dhe mund të ketë përdorim të lirë për publikun, duke iu nënshtruar respektimit të të drejtave morale të autorëve, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 42

Të drejtat në veprat që përfshihen në domenin publik

1. Përfiton një mbrojtje të njëjtë lidhur me të drejtat pasurore, sikurse autori i veprës, çdo person, i cili, pas përfundimit të mbrojtjes së të drejtave pasurore të autorit:

a) publikon për herë të parë në mënyrë të ligjshme ose e vendos po në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut një vepër të pabotuar më parë;

b) publikon një botim kritik dhe shkencor të një veprë që është bërë pjesë e domenit publik.

2. Afati i mbrojtjes së të drejtave pasurore, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, është 25 vjet nga koha kur vepra u botua për herë të parë apo u vendos në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut.

3. Afati i mbrojtjes së të drejtave pasurore, të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, është 30 vjet nga koha e publikimit të parë të ligjshëm.

KREU V

MARRËDHËNIA MIDIS SË DREJTËS SË AUTORIT

DHE PRONËSISË

Neni 43

Dispozita të përgjithshme për tjetërsimin e së drejtës së pronësisë mbi veprën

1. Të drejtat e autorit janë të pavarura nga e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi objektin, në të cilin vepra është mishëruar/fiksuar.

2. Nëse autori ose mbajtësi i së drejtës së autorit transferon të drejtën e pronësisë së materialit, në të cilën është mishëruar/fiksuar vepra, ai nuk do të konsiderohet se ka kaluar të drejtat e tij pasurore mbi veprën ose ka dhënë autorizimin për shfrytëzimin e veprës, përveçse kur parashikohet ndryshe në një kontratë/marrëveshje ose nga ky ligj.

3. Autori ose mbajtësi i së drejtës së autorit, i cili i ka kaluar të drejtat e tij pasurore ose ka dhënë autorizimin për shfrytëzimin e një vepre, nuk do të konsiderohet se ka transferuar të drejtën e pronësisë së materialit, në të cilën vepra është mishëruar/fiksuar, përveçse kur parashikohet ndryshe në një kontratë/marrëveshje ose nga ky ligj.

Neni 44

Shkatërrimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit

1. Pronari i një vepre origjinale të mbrojtur nga ky ligj, që di ose ka të dhëna të arsyeshme për të ditur se autori ose secili nga bashkautorët ka një interes të veçantë për të ruajtur një vepër origjinale të tillë nga shkatërrimi, është i detyruar, përpara shkatërrimit të saj, t'i lajmërojë ata për shkatërrimin dhe duhet t'i ofrojë blerjen e origjinalit me një çmim të barasvlershëm me vlerën e tij reale. Kur kthimi i origjinalit në zotërimin e autorit nuk është i mundur, pronari mund t'i lejojë autorit të bëjë një kopje të veprës në mënyrën përkatëse. Nëse autori nuk dëshiron të blejë origjinalin, pronari është i lirë ta shkatërrojë atë, por ai, me kërkesën e autorit, mund t'i lejojë atij fotografimin përpara shkatërrimit.

2. Pronari i objekteve që përmbajnë kopje të një vepre të mbrojtur me të drejtë autori nuk do të ketë detyrime, lidhur me pikën 1, të këtij neni, vetëm në rastin kur ai di ose duhet të dijë se as origjinali dhe as kopja e asaj vepre nuk ekzistojnë.

3. Pronari i objektit, mbi të cilin është fiksuar një vepër me të drejtë autori pa autorizimin e tij, mund ta shkatërrojë objektin pa detyrime, referuar pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk zbatohen për veprat e arkitekturës. Pronari i një vepre arkitekture detyrohet vetëm të njoftojë autorin për shkatërrimin dhe i lejon atij, me kërkesën e tij, të fotografojë veprën dhe t'i dorëzojë një kopje të dizajnit të veprës.

5. Lidhur me ndryshimet e një vepre arkitekture duhet të mbahen parasysh interesat e pronarëve të saj. Autori i një vepre arkitekture nuk mund të kundërshtojë ndaj ndryshimeve të veprës së tij të arkitekturës, të cilat nevojiten për shkaqe të rëndësishme, siç është siguria apo arsye teknike. Aty ku vepra e arkitekturës ka nevojë për rikonstrukcion, autori i saj nuk mund të kundërshtojë përdorimin e materialeve të tjera, nëse materialet e përdorura në ndërtimin e saj provojnë se kanë mangësi ose nëse materiale të tilla nuk mund të disponohen ose mund të merren, por vetëm me vështirësi apo shpenzime. Në një rast të tillë, autori, me emrin e të cilit

është dizajnuar vepra, ka të drejtën të kërkojë që pronari i ndërtesës, përveç emrit të autorit, të bëjë një shënim lidhur me ndryshimet e veprës dhe kohën kur janë bërë.

6. Nëse pronari vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ai do të jetë përgjegjës për shkeljen e të drejtave vetjake jopasurore të autorit.

KREU VI

KALIMI I TË DREJTAVE PASURORE TË AUTORIT

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 45

Kalimi i të drejtave pasurore të autorit

1. Autori ose titullari i të drejtave të autorit mund të kalojë me kontratë, sipas këtij ligji dhe dispozitave të legjislacionit civil, vetëm të drejtat pasurore kundrejt personave të tjerë.

2. E drejta e autorit është e trashëgueshme. Të gjitha të drejtat që i përkasin autorit do t'u kalojnë trashëgimtarëve të tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

3. Rregullimet e përgjithshme për trashëgiminë zbatohen për të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me trashëgiminë e së drejtës së autorit, të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj.

4. Kalimi i të drejtave pasurore të autorit kufizohet për disa të drejta, për një territor dhe për një periudhë kohore, të përcaktuara shprehimisht në marrëveshje apo kontratë.

5. Të drejtat vetjake jopasurore të autorit nuk do të jenë objekt i kalimit të personat e tjerë. Ato ekzistojnë pavarësisht të drejtave pasurore të autorit dhe ruhen nga autori edhe pas kalimit të të drejtave pasurore të personat e tjerë.

Neni 46

Forma e kalimit të të drejtave ekonomike

1. Të drejtat pasurore të autorit ose titullari i të drejtave të autorit mund të kalojnë me kontratë në formën ekskluzive ose joekskluzive. Si rezultat i këtij kalimi, pala së cilës i kalohen këto të drejta është mbajtësi i ri i së drejtës së autorit, në përputhje me kushtet e kontratës.

2. Në rastin e kalimit të së drejtës në formën ekskluzive, autori/pronari i veprës origjinale nuk e ushtron më të drejtën e përdorimit të veprës gjatë periudhës kohore dhe për territorin për të cilin është rënë dakord, si dhe nuk ka të drejtë t'ia kalojë të njëjtin tagër një pale të tretë. Në këtë rast, në bazë të kontratës ekskluzive, mbajtësi i së drejtës ekskluzive mund të shfrytëzojë një vepër autori duke përjashtuar çdo person tjetër, përfshirë autorin, nga një përdorim i tillë, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj. Brenda këtyre kufijve, ai gjithashtu gëzon të drejtën të autorizojë ose të ndalojë të tretët për përdorimin e veprës dhe vetëm nëse këto të drejta parashikohen shprehimisht në kontratë. Forma ekskluzive e kalimit të të drejtave duhet të përcaktohet shprehimisht në kontratën mes palëve. Kontrata është e vlefshme kur bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit civil në fuqi.

3. Në rastin e kalimit të së drejtës në formën joekskluzive, autori/pronari i veprës mund ta përdorë vetë veprën dhe mund gjithashtu ta kalojë të drejtën në formën joekskluzive kundrejt personave të tjerë. Në këtë rast, mbajtësi i së drejtës për shfrytëzimin e veprës në formën

joekskluzive, në përputhje me objektin dhe përmbajtjen në kontratë, gëzon të drejtën ta përdorë veprën në mënyrë të njëjtë si palët e treta, të cilat kanë marrë autorizim për përdorimin e saj.

4. Mbajtësi i së drejtës për shfrytëzimin e veprës në formën joekskluzive nuk mund t'ua kalojë këtë të drejtë personave të tjerë, pa pëlqimin/autorizimin me shkrim të autorit/pronarit të veprës.

5. Kalimi i një të drejte pasurore nga autori/pronari i së drejtës së autorit nuk do të ketë efekt për të drejtat e tjera të tij, përveçse nëse parashikohet në kontratë.

6. Pëlqimi/autorizimi i përmendur në pikën 4, të këtij neni, nuk do të kërkohej kur mbajtësi i së drejtës është një person juridik, në kuadër të transferimit të të gjithë biznesit ose të një pjese të tij, sipas ligjit.

7. Kur e drejta për shfrytëzimin e veprës në formën joekskluzive kalohet pa autorizimin e autorit, personi që fiton të drejtën e shfrytëzimit do të ketë përgjegjësi solidare me personin që transferon të drejtën e autorit.

8. Dhënia e mëvonshme e së drejtës për shfrytëzimin e veprës, përfshirë atë të formës ekskluzive, nuk paragjykon të drejtën e mëparshme për shfrytëzimin e dhënë, në formën ekskluzive ose jo, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata për dhënien e së drejtës më parë.

Neni 47

Kalimi i së drejtës së riprodhimit

Kalimi i së drejtës së riprodhimit të veprës nuk nënkupton edhe kalimin e së drejtës së shpërndarjes, me përjashtim të rastit kur në kontratë është përcaktuar shprehimisht ndryshe.

Neni 48

Kontrata e së drejtës së autorit

1. Me anë të një kontrate ose në rastet e parashikuara me ligj, autori mund t'i kalojë një personi tjetër të drejtën për shfrytëzimin e veprës së tij letrare, shkencore, artistike ose mund t'i besojë atij ushtrimin e së drejtës së autorit, duke i dhënë autorizimin për shfrytëzim/përdorim ose ndonjë tagër tjetër ligjor. Nga ana tjetër, mbajtësi i të drejtave është i detyruar të përdorë këtë të drejtë sipas kushteve të vendosura në kontratë dhe të paguajë shumën e shpërblimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë.

2. Kontrata e së drejtës së autorit, përveç përdorimit të veprave në gazeta dhe botime të tjera periodike, është e vlefshme vetëm në formë të shkruar dhe parashikon: përshkrimin e veprës, të drejtat dhe detyrimet e mbajtësit që i fiton këto të drejta; formën ekskluzive/joekskluzive; masën/mënyrën e përdorimit të veprës që mbulohet nga ajo; afatin e vlefshmërisë; territorin në të cilin zbatohet; vlerën e shpërblimit ose bazën për përcaktimin e kësaj vlere për përdorimin e veprës; kushtet dhe afatet e pagesës së shpërblimit.

3. Nëse në kontratën e së drejtës së autorit nuk përcaktohet territori për të cilin zbatohet, ajo gjen zbatim vetëm për përdorimet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Nëse kontrata e së drejtës së autorit nuk parashikon afatin e saj të vlefshmërisë, konsiderohet se është lidhur për një afat trevjeçar që nga data e lidhjes së saj, nëse ka të bëjë me përdorimin e veprës në formën e saj origjinale, si dhe, për pesë vjet, në rast se ka të bëjë me përdorimin e veprës në një formë të përshtatur apo të ndryshuar në mënyrë tjetër ose të përkthyer.

5. Nëse në kontratë nuk specifikohen qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme natyra dhe niveli i përdorimit të veprës, për të cilën është dhënë autorizimi, ajo interpretohet vetëm për të mbuluar këtë lloj natyre dhe nivel përdorimi të veprës, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, lidhur me dispozitat për interpretimin e kontratës.

6. Mungesa e këtyre parashikimeve i jep të drejtë palës së interesuar të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 49

Përcaktimi i shpërblimit për kalimin e të drejtave pasurore

1. Shpërblimi për kalimin e të drejtave pasurore përcaktohet në kontratën ndërmjet palëve dhe llogaritet në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat që rrjedhin nga shfrytëzimi i veprës ose nga mënyra të tjera, duke mbajtur parasysh:

- a) tipin dhe qëllimin e veprës, për të cilën gëzon të drejta autori;
- b) suksesin e saj financiar;
- c) llojin dhe volumin e veprës;
- ç) kohëzgjatjen e përdorimit;

d) ekzistencën e marrëveshjes mes shoqatave të autorëve dhe shoqatave të përdoruesve, ku përcaktohet shuma e një shpërblimi të drejtë, si dhe elemente të tjera që merren për bazë në vendosjen e një shpërblimi të drejtë.

2. Nëse shuma e shpërblimit nuk është vendosur në kontratë, autori ose titullari i të drejtave të autorit gëzon të drejtën t'u kërkojë organeve kompetente të përcaktojnë shpërblimin, sipas dispozitave të këtij ligji. Në këtë rast, shpërblimi përcaktohet në analogji me rastet e mëparshme, duke pasur parasysh vlerën më të madhe të shpërblimit për të njëjtën kategori veprash, qëllimin dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të veprës, si dhe çdo rrethanë tjetër, sipas rastit, për përcaktimin e një shpërblimi të drejtë.

3. Nëse në kontratën mes palëve ekziston një shpërpjesëtim i dukshëm midis shpërblimit të autorit të veprës dhe të ardhurave të palës tjetër, mbi të cilën janë transferuar të drejtat pasurore mbi veprën, autori gëzon të drejtën t'u kërkojë organeve kompetente për rishikimin e kontratës ose ndryshimin e kontratës për rritjen e shumës, në masën e një shpërblimi të drejtë për autorin.

4. Autori nuk mund të heqë dorë paraprakisht nga ushtrimi i së drejtës së tij, parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

Neni 50

Kontrata për veprat e botuara në shtypin periodik

1. Nëse në kontratën e lidhur ndërmjet palëve nuk parashikohet ndryshe, autori/pronari i të drejtave të një vepre të botuar në shtypin periodik gëzon të drejtën e përdorimit të saj në çdo formë, me kusht që përdorimi të mos cenojë të drejtën e shpërndarjes së veprës së botuar në shtypin periodik.

2. Nëse në kontratën e lidhur ndërmjet palëve nuk parashikohet ndryshe, autori/pronari i të drejtave mund ta disponojë lirisht veprën në qoftë se ajo nuk është botuar brenda një muaji nga dita e pranimit të saj, në rastin e shtypit të përditshëm, dhe brenda gjashtë muajve, në rastin e botimeve të tjera.

Neni 51

Kufijtë e vlefshmërisë së dispozitave kontraktuale

1. Kontrata e së drejtës së autorit mund të ketë si objekt një veprë të pakrijuar ende, me kusht që të përcaktojë tipin e veprës dhe mënyrën e përdorimit të veprës së ardhshme.

2. Kontrata, që ka si objekt dhënien e së drejtës së përdorimit të një numri të pacaktuar ose për qëllim të pacaktuar të një vepre që autori do të krijojë në të ardhmen, është e pavlefshme.

3. Kontrata, që ka si objekt dhënien e së drejtës së përdorimit në çdo mënyrë përdorimi të veprës që është ende e panjohur gjatë kohës së lidhjes së saj, është e pavlefshme.

Nuk konsiderohet si mënyrë ende e panjohur përdorimi në kohën e lidhjes së kontratës:

a) një mënyrë përdorimi, e njohur më parë, e cila mund të përdoret për të rritur efikasitetin dhe cilësinë;

b) një mënyrë e re përdorimi, e cila zëvendëson një mënyrë të përdorimit të veprës që njihej në kohën e lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh natyrën dhe nivelin e përdorimit.

Neni 52

Kontrata në lidhje me veprat që krijohen në të ardhmen

1. Subjekti, të cilit i është kaluar e drejta ose i autorizuari është i detyruar të njoftojë me shkrim mbajtësin e së drejtës/autorizuesin për pranimin e krijimit, që është objekt kontrate, për kalimin/autorizimin e së drejtës mbi një veprë të ardhshme brenda afatit të parashikuar në kontratë dhe në mungesë të parashikimit të këtij afati, ky i fundit konsiderohet të jetë dy muaj nga lidhja e kontratës. Kur subjekti, të cilit i ka kaluar e drejta/i autorizuari, nuk kryen njoftimin brenda këtij afati, krijimi konsiderohet i pranuar.

2. Subjekti, të cilit i është kaluar e drejta, ose i autorizuari mund t'ia kthejë veprën autorit/mbajtësit të së drejtës së autorit/autorizuesit për korrigjimet që duhet t'i bëhen, mbështetur në motive të arsyeshme të paraqitura me shkrim dhe brenda një afati të caktuar. Nëse autori/autorizuesi refuzon kryerjen e korrigjimeve pa asnjë motiv të arsyeshëm ose nuk i bën korrigjimet brenda afatit të caktuar, personi, të cilit i është kaluar e drejta/i autorizuari, mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën pa kryer pagesën e shpërblimit.

3. Nëse autori e autorizon përdorimin e veprës, ai është i detyruar të bëjë ndryshime që nuk e cenojnë thelbin e tij, por që janë të domosdoshme për përdorimin e parashikuar shprehimisht në kontratë. Në rast se ai refuzon ose nuk është në gjendje ta përmbushë këtë detyrim, personi, të cilit i është kaluar e drejta, ose i autorizuari mund t'i kryejë ndryshimet pa pëlqimin e tij.

Neni 53

Zgjidhja e kontratës

1. Autori mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e së drejtës së autorit për kalimin e të drejtave pasurore, nëse:

a) përfituesi/mbajtësi i të drejtave nuk e shfrytëzon objektin e kontratës brenda afatit dhe kushteve, për të cilat është rënë dakord në kontratën me shkrim;

b) përfituesi/mbajtësi i të drejtave e shfrytëzon veprën në një mënyrë qartësisht që vjen në kundërshtim me lejen dhe në mënyrë të ndryshme nga kushtet e parashikuara në kontratën me shkrim, duke cenuar interesat legjitimë të autorit.

2. Në rastin e pikës 1, të këtij neni, përfituesi/mbajtësi i të drejtave përgjigjet për dëmin e shkaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Autori nuk do të ketë të drejtë të kërkojë zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës nëse përfituesi/mbajtësi i së drejtës për shfrytëzimin e veprës provon se rrethanat që shkaktojnë mosushtrimin e së drejtës mbi veprën janë veprimet e vetë autorit, të një pale të tretë ose një force madhore. Në rastin kur shkaktar është autori vetë, ai përgjigjet për dëmin e shkakuar kundrejt përfituesit/mbajtësit të të drejtave.

4. Autori nuk mund të heqë dorë paraprakisht nga e drejta e tij e zgjidhjes së kontratës, e përmendur në pikën 1, të këtij neni. Kjo dorëheqje mund të përjashtohet me kontratë vetëm për një periudhë dyvjeçare pas lidhjes së kontratës ose dorëzimit të veprës, në rast se kjo ndodh në një datë më të vonë sesa ajo e lidhjes së kontratës. Në vend të zgjidhjes së kontratës, autori mund të ndërpresë ekskluzivitetin e shfrytëzimit të të drejtave, duke ulur, në të njëjtën kohë, edhe tarifën që duhet t'i paguhet atij për përdorimin. Në rastin e veprave të botuara në shtypin e përditshëm, periudha kohore e sipërpërmendur është 3 muaj, ndërsa për botimet e tjera periodike 1 vit.

5. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij e autorit.

Neni 54

Ekzekutimi

1. E drejta e autorit nuk mund të jetë objekt i ekzekutimit të detyrimeve. Vetëm përfitimet ekonomike, të përftuara nga përdorimi i një vepre të së drejtës së autorit, mund të jenë objekt i ekzekutimit të detyrimeve, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

2. Nëse autori ka shkëlur një detyrim kontraktual, duke mos përfunduar veprën ose duke mos botuar dorëshkrimin, ai nuk është i detyruar ta përmbushë atë, por do të jetë përgjegjës për dëmin që rrjedh prej saj.

Seksioni 2

Kontratat e veçanta të së drejtës së autorit

Neni 55

Kontratat e botimit

1. Me kontratën e botimit autori merr përsipër t'i japë botuesit të drejtën e riprodhimit të veprës së tij nëpërmjet shtypshkrimit ose proceseve të tjera të ngjashme, si dhe të drejtën e shpërndarjes së kopjeve të veprës, ndërsa botuesi merr përsipër të publikojë veprën dhe t'i paguajë autorit shpërblimin, për të cilin është rënë dakord, si dhe të kujdeset për shpërndarjen e suksesshme të kopjeve të veprës dhe t'i sigurojë autorit informacionin për shpërndarjen e veprës së tij. Kontrata e botimit duhet të parashikojë detyrimisht kohëzgjatjen e së drejtës së botimit.

2. Presumohet që botuesi ka të drejtën ekskluzive për të botuar veprën, sipas pikës 1, të këtij neni, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga kontrata e botimit.

3. Presumimi, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohet për të drejtën e botimit të artikujve në shtypin e përditshëm ose periodikëve të botimeve.

4. Kontrata e botimit, që ka si objekt botimin e artikujve, ilustrimeve ose kontributeve të tjera të autorit në shtyp ose në botimet e përditshme dhe periodike, nuk ka nevojë të bëhet në formë të shkruar.

5. Botuesit i lejohe të lidhë një kontratë botimi për të njëjtën veprë me një palë të tretë vetëm me autorizimin e shprehur të autorit.

Neni 56

E drejta e përkthimit, përshtatjes dhe të drejta të tjera

Me kontratën, sipas nenit 55, të këtij ligji, autori mund t'i japë botuesit të drejtën e përkthimit të veprës së tij në disa gjuhë të huaja dhe të drejtën e botimit të kësaj veprë të përkthyer, si dhe të drejta të tjera ekonomike. Autori i veprës gjithashtu mund t'i japë botuesit të drejtën për të përshtatur veprën. Kontrata me botuesin për të drejtën për të autorizuar persona të tjerë për të përshtatur veprën ose për përdorimin e saj në ndonjë mënyrë tjetër duhet të jetë objekt i një dispozite të shprehur kontraktore.

Neni 57

Verifikimi i saktësisë së informacionit

1. Autori ka të drejtën në çdo kohë të kërkojë nga botuesi përmbajtjen dhe kontrollin e arkivave dhe dokumentacionit të biznesit të botuesit për të verifikuar saktësinë e informacionit që i është paraqitur prej tij.

2. Autori mund të kërkojë informacion lidhur me numrin e kopjeve të bëra për veprën e tij nga një person i tretë që e ka riprodhuar veprën për botuesin, i cili detyrohet të sjellë informacion të plotë dhe të vërtetë, në kuptim të pikës 5, të nenit 55, të këtij ligji.

Neni 58

Lidhja e kontratave nëpërmjet një përfaqësuesi

Autori mund të lidhë kontrata botimi edhe me anë të një përfaqësuesi, por vetëm për ato vepra që janë caktuar shprehimisht me marrëveshje mes tyre.

Neni 59

Përcaktimi i shumës së shpërblimit

1. Nëse shpërblimi përcaktohet si një përqindje e çmimit të shitjes për çdo veprë të ekzemplarëve të shitur, në kontratën e botimit duhet të specifikohet një numër minimal i kopjeve të botimit të parë dhe një shpërblim minimal, të cilin botuesi duhet t'ia paguajë autorit pavarësisht nga numri i kopjeve të shitura.

2. Nëse shpërblimi përcaktohet si një shumë totale, në kontratën e botimit duhet të specifikohet numri total i kopjeve, për të cilat është rënë dakord për t'u printuar. Nëse palët nuk kanë rënë dakord për këtë numër dhe vetëm nëse rezulton ndryshe nga praktikat e ndershme të biznesit dhe rrethanat e rastit, botuesi mund të botojë jo më shumë se 500 kopje të veprës.

Neni 60

Kushte të tjera të kontratës së botimit

1. Kontrata e botimit duhet të përmbajë gjithashtu:

a) afatin, brenda të cilit autori duhet t'i dorëzojë botuesit dorëshkrimin e tij të saktë ose materiale të tjera origjinale të punës. Nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat do të jetë një vit nga data e lidhjes së kontratës;

b) afatin, brenda të cilit botuesi duhet të publikojë dhe të shpërndajë kopjet e veprës për çdo botim. Nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat do të jetë një vit nga data e dorëzimit të dorëshkrimit të saktë dhe materialeve të tjera origjinale të punës;

c) numrin e autorizuar të kopjeve që do të publikojë botuesi. Nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, botuesi ka të drejtën të publikojë vetëm një botim;

ç) afatin, brenda të cilit botuesi, pas shterjes së botimit të parë, është i detyruar të nisë nxjerrjen në treg të ekzemplarëve të botimit të ardhshëm, nëse kjo është përcaktuar në kontratë. Nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat do të jetë 1 vit nga dita kur autori ka kërkuar një gjë të tillë;

d) një dispozitë, lidhur me pronësinë e dorëshkrimit dhe materialeve të tjera origjinale. Dorëshkrimi ose materialet e tjera origjinale mbeten në pronësi të autorit, përveç rasteve kur ai, në bazë të një kontrate, ia kalon pronësinë botuesit;

dh) pamjen dhe dizajnin e kopjeve të veprës;

e) formën ekskluzive ose joekskluzive të të drejtave pasurore, si dhe territorin ku do të operojë kontrata e botimit;

ë) procedurat e kontrollit të tirazhit të veprës.

2. Mungesa e ndonjë kushti të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i jep palës së interesuar të drejtën të tërhiqet nga kontrata, si dhe të kërkojë shpërblim për dëmin e shkaktuar.

3. Kontrata e botimit depozitohet dhe fillon efektet pas regjistrimit dhe certifikimit në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat që i janë kaluar botuesit përfundojnë pas mbarimit të afatit, për të cilin është rënë dakord në kontratë mes palëve.

4. Konsiderohet shpërndarje e plotë e kopjeve të botimit nëse kopjet e pashitura arrijnë deri në 5 për qind të të gjithë tirazhit të botimit dhe, në çdo rast, jo më shumë se 100 kopje.

Neni 61

Ndryshimi i veprës nga autori

Botuesi është i detyruar të lejojë autorin të bëjë ndryshime në çdo botim të ri, me kusht që këto ndryshime të mos rrisin ndjeshëm shpenzimet e botimit dhe të mos ndryshojnë, në mënyrë të dukshme, karakterin e veprës, me përjashtim të rastit kur në kontratë është rënë dakord, shprehimisht, ndryshe.

Neni 62

Shkatërrimi i dorëshkrimit dhe i botimit të përgatitur

1. Nëse një dorëshkrim ose një material tjetër origjinal i veprës shkatërrohet pas dorëzimit të tij të botuesit, për shkak të një force madhore, autori ka të drejtën e shpërblimit, e cila do të paguhej për autorin vetëm nëse vepra do të ishte botuar.

2. Nëse një botim i përgatitur i veprës shkatërrohet plotësisht nga një forcë madhore para se të shpërndahej, botuesit i jepet e drejta të përgatisë një botim të ri dhe autori ka të drejtë për shpërblim vetëm për një nga këto botime. Kontrata konsiderohet e zgjidhur dhe palët

zhvishen nga detyrimet e ndërsjella, kur një gjë e tillë kërkohet nga pala, në dëm të së cilës ka vepruar forca madhore. Në këtë rast pala e dëmtuar dorëzon kontratën në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit, e cila, nga ana e saj, njofton palën tjetër brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kontratës.

3. Nëse pas botimit dhe para shpërndarjes së veprës, për arsye të forcës madhore, numri i kopjeve të botuara dëmtohet pjesërisht, kontrata është e vlefshme për pjesën e mbetur të kopjeve ose plotësisht e vlefshme, nëse botuesi zëvendëson numrin e kopjeve të dëmtuara me shpenzimet e veta, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

Neni 63

Kalimi i së drejtës së botimit pas botimit të parë të veprës

1. Botuesi, që ka fituar të drejtën për të botuar veprën, gëzon të drejtën e përparësisë në kalimin e së drejtës së botimit të veprës në formën elektronike ose formë tjetër, kundrejt një shpërblimi të njëjtë me atë të konkurrentit që ka ofruar shpërblimin më të lartë për autorin ose titullarin e të drejtave të autorit të veprës.

2. Një botues, që ka për qëllim të përdorë të drejtën sipas pikës 1, të këtij neni, duhet t'i paraqesë me shkrim ofertën e tij autorit ose titullarit të së drejtës së autorit të veprës, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ftesës së shkruar të autorit, me të cilën ky i fundit paraqet vullnetin e tij për botimin e veprës në formë elektronike ose në një formë tjetër.

3. E drejta, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet ushtruar brenda një periudhe trevjeçare, duke filluar nga data e përfundimit të kontratës së botimit.

Neni 64

Zgjidhja e njëanshme e kontratës së botimit

1. Autorit i lind e drejta të kërkojë zgjidhjen e kontratës së botimit nëse botuesi nuk e boton veprën brenda kohës së përcaktuar në kontratë ose nuk procedon me botimin e një edicioni të ri brenda kohës së përcaktuar ose afatit të përcaktuar me ligj.

2. Nëse kontrata zgjidhet për shkak të botuesit, autori do të gëzojë çdo shpërblim të marrë, të kërkojë çdo shpërblim për dëmin e shkaktuar ose, sipas rastit, mund të kërkojë pagesën për të gjithë shumën e përcaktuar në kontratë.

3. Një botues mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës së botimit dhe të ankimojë për dëmtimet, nëse autori nuk i dorëzon dorëshkrimin ose materiale të tjera origjinale të veprës brenda afatit të përcaktuar në kontratë ose në ligj.

Neni 65

Shkatërrimi i kopjeve të veprës

1. Një botues, që ka si synim të shesë kopjet e pashitura të veprës për riciklim ose t'i shkatërrojë apo t'i tërheqë nga qarkullimi, është i detyruar t'i ofrojë autorit mundësinë e blerjes me çmimin që do të ishte marrë nëse kopjet do të ishin shitur për riciklim. Në të kundërt, ai do të mbajë përgjegjësi për shkeljen e së drejtës vetjake jopasurore të autorit.

2. Nëse autori nuk e pranon ofertën e botuesit, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertës nga botuesi, ose pranon të blejë vetëm një pjesë të kopjeve të pashitura, botuesi mund t'i shesë kopjet e mbetura për riciklim apo t'i shkatërrojë ato.

Neni 66

Kontrata për shfaqjet teatrale dhe/ose ato muzikore

1. Me kontratën e shfaqjes teatrale dhe/ose muzikore autori ose titullari i së drejtës së autorit i kalon një personi fizik apo juridik të drejtën për të shfaqur ose ekzekutuar në publik një vepër letrare, dramatike, muzikore, dramatiko-muzikore, koreografike ose të një pantomime, kundrejt shpërblimit, si dhe me detyrimin për të respektuar kushtet kontraktore mes palëve.

2. Kontrata e shfaqjes teatrale dhe/ose muzikore, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e vlefshme dhe i fillon efektet pas regjistrimit dhe certifikimit në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit dhe përfundon pas mbarimit të afatit kontraktual.

3. Kontrata për shfaqjet teatrale dhe/ose muzikore bëhet me shkrim, për një kohë dhe numër të caktuar shfaqjesh në publik.

4. Në kontratë duhet të përcaktohen periudha kohore kur do të realizohet shfaqja, numri i shfaqjeve, forma ekskluzive ose joekskluzive e kalimit të të drejtave, kushtet e mbikëqyrjes së arkëtimit të të ardhurave dhe mënyra e shpërblimit të autorit ose e titullarit të të drejtave të autorit.

5. Personi fizik apo juridik, i cili është organizatori për shfaqjen teatrale dhe/ose muzikore, nuk ka të drejtën t'ia kalojë të drejtat e përfituara një pale të tretë, pa miratimin me shkrim të autorit ose të titullarit të të drejtave të autorit.

6. Personi fizik apo juridik, organizator i shfaqjes, duhet t'i lejojë autorit aksesin në shfaqjen e veprës, të sigurojë kushte teknike të përshtatshme që respektojnë të drejtat vetjake jopasurore të autorit, t'i sigurojnë autorit ose përfaqësuesit të tij një listë të veprave të shfaqura, t'i paguajë autorit shumën e shpërblimit, sipas periudhës kohore për të cilën është rënë dakord në kontratë, dhe të informojë autorin për përfitimin që rrjedh nga shfaqja e veprës së tij, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratë.

7. Kontrata, sipas këtij neni, zgjidhet në mënyrë të njëanshme nëse pala kontraktore nuk shfaq në publik veprën në periudhën për të cilën është rënë dakord dhe nuk e përdor veprën në mënyrën e sipas kushteve të saktësuara në kontratën me autorin e veprës dhe ky i fundit ka të drejtë të gëzojë çdo shpërblim të marrë, të kërkojë çdo shpërblim për dëmin e shkaktuar ose, sipas rastit, mund të kërkojë pagesën për të gjithë shumën e përcaktuar në kontratë.

Neni 67

Kontrata e porosisë

1. Në një kontratë porosie, përveçse kur parashikohet ndryshe, të drejtat pasurore i përkasin autorit të veprës. Autori merr përsipër të krijojë një vepër të caktuar me të drejta autori dhe të dorëzojë një kopje të kësaj vepre tek porositësi i veprës, ndërsa ky i fundit merr përsipër t'i paguajë autorit një shpërblim sipas kontratës.

2. Në kontratën e porosisë për krijimin e një vepre me të drejta autori duhet të specifikohen, gjithashtu, karakteristikat, elementet, afati kohor për dorëzimin e veprës dhe afati kohor për pranimin e veprës.

3. Porositësi i veprës ka të drejtë të zgjidhë kontratën në qoftë se vepra nuk i plotëson kushtet e caktuara në kontratë. Nëse kontrata zgjidhet sipas kësaj pike, çdo shumë e mbledhur nga autori do të jetë e kthyeshme. Nëse puna përgatitore është bërë me qëllim të krijimit të një vepre, sipas kontratës së porosisë, autori ka të drejtë në shlyerjen e çdo shpenzimi të bërë.

Neni 68

Kontrata e qirasë

1. Në kontratën e qirasë së një vepre të së drejtës së autorit, autori merr përsipër të lejojë përdorimin për një periudhë të caktuar kohore të paktën të një kopjeje të veprës së tij, qoftë origjinali ose riprodhimi i saj në rastet e programeve kompjuterike ose në veprat fonografike dhe audiovizuale. Nga ana tjetër, qiramarrësi merr përsipër të paguajë shpërblimin për autorin për aq kohë sa ai përdor kopjen e veprës së tij.

2. Kontrata për qiranë e një vepre do të rregullohet nga dispozitat e këtij ligji për të drejtën e qiradhënies dhe dispozitave të legjislacionit civil mbi kontratat e qirasë.

3. Autori ruan të drejtën e autorit në veprën me qira, me përjashtim të së drejtës së shpërndarjes, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratën mes palëve.

Neni 69

Veprat e krijuara në bazë të kontratës së punës

1. Kur veprat krijohen nga një punëmarrës në kushtet e kontratës së punës, gjatë ekzekutimit të detyrave e të udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi i tij, do të konsiderohet se të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera për këtë vepër kanë kaluar ekskluzivisht për punëdhënësin, për një periudhë kohore prej 3 vjetësh nga data kur vepra i është dorëzuar punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë.

2. Përdorimi i veprës, sipas pikës 1, të këtij neni, nga punëdhënësi brenda fushës së aktivitetit të tij, fushë e cila është parashikuar në kushtet e kontratës së punës, nuk kërkon autorizimin e autorit punëmarrës. Për rastet e tjera, për përdorimin e veprës jashtë fushës së aktivitetit kërkohet pëlqimi me shkrim i autorit punëmarrës, i cili gëzon të drejtën e një shpërblimi të drejtë.

3. Punëdhënësi nuk mund të autorizojë te palët e treta, për qëllime fitimi, kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, nëse ky kalim i të drejtave nuk është përcaktuar shprehimisht në kontratën me autorin punëmarrës.

4. Në rastin kur punëdhënësi, sipas kontratës së punës me autorin punëmarrës, kalon të drejtën e autorit apo autorizon të tretët për përdorimin/shfrytëzimin e veprës për qëllime fitimi, autori gëzon të drejtën të përfitojë një shpërblim në përpjesëtim të drejtë me fitimin e realizuar nga autorizimi/kalimi i të drejtave tek të tretët.

5. Me mbarimin e afatit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, të drejtat pasurore mbi veprën i kthehen punëmarrësit, megjithatë punëdhënësi mund të pretendojë një kontratë të re për kalimin e të drejtave pasurore ekskluzive mbi veprën e autorit punëmarrës, kundrejt një shpërblimi të drejtë.

6. Pavarësisht nga parashikimet e këtij neni, autori punëmarrës i një vepre të krijuar në bazë të një kontrate individuale të punës do të ruajë të drejtën ekskluzive për ta përdorur veprën si pjesë e tërë e krijimit të tij.

KREU VII

KUFIZIMET NË USHTRIMIN E SË DREJTËS SË AUTORIT

Neni 70

Dispozitë e përgjithshme

Kufizimi i së drejtës së autorit është i lejueshëm për përdorimin e një vepre pa autorizimin e autorit ose pa autorizimin e autorit dhe pa pagesë shpërblimi, vetëm në rastet që janë të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, me kushtin që shkalla e këtij shfrytëzimi të veprave të së drejtës së autorit të jetë e kufizuar për qëllimin e caktuar dhe të mos bjerë në kundërshtim me shfrytëzimin normal të veprës, si dhe të mos cenohet interesi legjitim i autorit ose i titullarit të së drejtës së autorit.

Neni 71

Lejimi i riprodhimit të përkohshëm

1. Veprimet e përkohshme të riprodhimit janë të përjashtuara nga e drejta ekskluzive e riprodhimit, sipas parashikimit të nenit 26, të këtij ligji, dhe lejohen me kusht që ato të përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë të përkohshme ose rastësore;
- b) të jenë pjesë përbërëse dhe thelbësore të një procesi teknologjik;
- c) të kenë si qëllim të vetëm transmetimin në një rrjet midis palëve të treta nëpërmjet një ndërmjetësuesi ose përdorimin e ligjshëm të një vepre;
- ç) të mos kenë asnjë qëllim të pavarur përfitimi ekonomik.

2. Parashikimet e këtij neni nuk do të zbatohen në rastin e nenit 86, të këtij ligji, për përdorimin e bazës së të dhënave.

Neni 72

Riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak

1. Në përputhje me nenin 31, të këtij ligji, një person fizik mund të riprodhojë një vepër me të drejta autori, pa autorizimin e autorit të një vepre ose titullarit të së drejtës së autorit për këtë vepër dhe pa shpërblim, në qoftë se bëhet në jo më shumë se një kopje, në formën e fotokopjes ose me anë të çdo mjeti të ngjashëm nga përdorimi i teknikave fotografike ose të çdo mjeti tjetër që ka efekte të ngjashme me të dhe me çdo mjet tjetër për përdorim privat dhe përdorimi tjetër vetjak, për aq sa kopja nuk është e aksesueshme dhe nuk ka për synim publikun, si dhe nuk ka qëllime tregtare direkte ose indirekte.

2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose me kontratë, pika 1, e këtij neni, nuk gjen zbatim për:

- a) riprodhimin e një libri të tërë, përveç rastit kur kopjet e tij të shitura janë ezauruar për të paktën dy vjet;
- b) botimet grafike të veprave muzikore (partitura);
- c) baza të dhënash elektronike;
- ç) veprat kartografike;
- d) ndërtesa të strukturave arkitekturore;

dh) programet kompjuterike.

Neni 73

Riprodhimi reprografik

1. Riprodhimi reprografik, që do të thotë riprodhimi identik i një vepre në të njëjtin format, të zmadhuar ose të zvogëluar, me anë të fotokopjimit ose me ndihmën e teknologjive të tjera të ngjashme, do të lejohet në rastin e:

a) një vepre të botuar ligjërish, nëse riprodhimi në një kopje është bërë nga një bibliotekë ose shërbim arkivi dhe nëse qëllimi është zëvendësimi i kopjeve që kanë humbur, janë shkatërruar ose janë bërë të papërdorshme ose bërja e kopjeve për t'iu vendosur në dispozicion bibliotekave apo shërbimeve të ngjashme arkivore, me qëllim zëvendësimin e krijimeve që kanë humbur në përmbledhjet e tyre, që janë shkatërruar ose janë bërë të papërdorshme, atëherë kur është e pamundur të sigurohen kopje të krijimit nëpërmjet kanaleve të zakonshme tregtare;

b) artikujve dhe krijimeve të tjera të përmbledhura ose fragmenteve të shkurtra të krijimeve letrare dhe pjesëve të veçuara të librave në një shkallë të kufizuar, të cilët janë botuar në mënyrë të ligjshme, me kusht që ky riprodhim në një kopje të bëhet nga biblioteka ose arkivi jo për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ekonomik, por për të përmbushur nevojat e individëve/personave, të cilët do ta përdorin kopjen e siguar në këtë mënyrë për qëllime studimore private apo kërkime pa qëllime fitimi.

2. Bëjnë përjashtim nga ky parashikim programet kompjuterike.

Neni 74

Regjistrimet e përkohshme

Lejohen regjistrimet e përkohshme të veprave të bëra nga ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv nëpërmjet aparaturave të tyre dhe për transmetimet e veta, duke marrë përsipër detyrimin që këto regjistrime të fshihen ose të shkatërrohen brenda maksimumi 3 muajve ose të depozitohen në arkivin shtetëror kur kanë rëndësi të veçantë dokumentuese dhe të trajtohen sipas dispozitave ligjore në fuqi për arkivat.

Neni 75

Kufizime në përfitimin e institucioneve të veçanta

Arkivat publikë, bibliotekat kombëtare, institucionet arsimore dhe shkencore, institucionet edukuese parashkollore dhe institucionet sociale (bamirëse), që nuk kanë qëllime direkte ose indirekte për përfitim ekonomik, mund të riprodhojnë veprën nga kopja e tyre për përdorim të brendshëm, me anë të çdo mjeti, në jo më shumë se një kopje.

Neni 76

Përmbledhjet me qëllim mësimor ose kërkimor - shkencor

1. Lejohen të riprodhohen në letër ose në çdo mënyrë tjetër të ngjashme dhe të përcillen në publik pjesë të veçanta të veprave të publikuara ligjërish ose pjesë integrale të shkurtra të veprave nga fusha e shkencës, letërsisë dhe muzikës, si edhe veprat individuale të arteve

pamore, arkitekturës, arteve të aplikuara, objekt i nenit 8, të këtij ligji, veprave fotografike ose hartografike dhe prezantimet e natyrës shkencore e teknike, në formën e një përmbledhjeje, e cila përmban vepra, kontribute ose materiale të tjera të autorëve të ndryshëm dhe që, për nga përmbajtja dhe sistemimi, janë ekskluzivisht të lidhura me mësimdhënien ose kërkimin shkencor, për sa kohë është e mundur të tregohet burimi, duke përfshirë edhe emrin e autorit, me përjashtim të rastit kur autori shprehimisht e ndalon atë. Riprodhimi dhe përcjellja në publik e pjesëve të veçanta të veprave me të drejtë autori nuk do të konsiderohen si shkelje, sipas nenit 23, të këtij ligji, përveç rastit kur shpërndarja e pjesëve të veçanta do të cenonte nderin ose reputacionin e autorit.

2. Autorët e veprave, kontributeve apo materialeve të tjera të përfshira në përmbledhje, referuar pikës 1, të këtij neni, kanë të drejtë për shpërblim të drejtë për riprodhimin dhe përcjelljen në publik të veprave të tyre.

Neni 77

Përdorimi i veprave të destinuara për personat me aftësi të kufizuara

1. Përdorimi i veprave me të drejtë autori do të lejohet për personat fizikë dhe juridikë, të miratuar nga institucioni shtetëror përkatës, që përfaqëson interesat e personave me aftësi të kufizuara, kur ata veprojnë pa qëllime përfitimi ekonomik, pa autorizimin e autorit të një vepre apo titullarit të së drejtës së autorit për këtë vepër dhe pa shpërblim, por duke treguar, kur është e mundur, burimin, duke përfshirë edhe emrin e autorit, për të përdorur një vepër të botuar në mënyrë të ligjshme ose të përcjelljes për publikun, sipas mënyrave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, me kushtin që vetëm personat me aftësi të kufizuara do të kenë mundësinë për të përdorur dhe aksesuar këto vepra, në masën që dikton paaftësia specifike, me përjashtim të veprave të krijuara posaçërisht për këtë qëllim.

2. Për qëllimin e kufizimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, do të lejohet të riprodhohet, të botohet, të përshtatet dhe të përcillet për publikun, duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të publikut të një vepre me anë të rrjeteve kompjuterike (internetit), me anë të një versioni audio ose në formë elektronike dhe me anë të një versioni në formën e të lexuarit dhe të shkruarit në relieve të veprës (*Braille*).

3. Përdorimi i veprave me të drejtë autori do të lejohet për nevojat e personave me dëmtime mendore dhe të leximit për të riprodhuar, botuar, përshtatur dhe për të përcjellë për publikun, duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të publikut të një vepre me anë të rrjeteve kompjuterike (internetit), veprat e përshtatura posaçërisht për këta persona. Përshtatja e veprave për këta persona do të thotë një transformim gjuhësor i veprave në një mënyrë të tillë që t'i bëjë të kuptueshme për personat me dëmtime të tilla.

Neni 78

Përdorimi i veprave për procedura gjyqësore, administrative dhe procedura të tjera zyrtare

Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve.

Neni 79

Përdorimi i veprave për qëllime mësimore

1. Një vepër mund të prezantohet ose të shfaqet në publik, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, në formën direkte të mësimdhënies ose në aktivitetet shkollore, për aq sa është e justifikuar për këto qëllime arsimimi kur:

a) vepra nuk përdoret për përfitime ekonomike apo tregtare nga institucioni edukues, organizatorët dhe persona të tretë;

b) interpretuesit nuk marrin shpërblim për shfaqjen e tyre;

c) biletat janë falas.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, është e detyrueshme të tregohet burimi dhe autorësia e veprës, në rastet kur kjo është e mundur.

Neni 80

Përdorimi i veprave për qëllimin e informimit të publikut

1. Për aq sa është e nevojshme për të informuar publikun për ngjarjet aktuale nga shtypi, radioja apo televizioni, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, lejohet të riprodhohen, të shpërndahen dhe t'i përcillen publikut:

a) vepra që janë pjesë e ngjarjes aktuale për t'u parë dhe dëgjuar, me kusht që veprat të përdoren në masën e justifikuar nga qëllimi dhe mënyra e raportimit të ngjarjes aktuale;

b) artikujt e gazetave dhe fotografitë për tema aktuale politike, ekonomike apo fetare, nëpërmjet mënyrave të tjera të përcjelljes në publik, duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të publikut nëpërmjet rrjeteve kompjuterike, me kusht që autori të mos e ketë ndaluar shprehimisht një përdorim të tillë dhe që vepra të përdoret në masën e justifikuar nga qëllimi dhe mënyra e raportimit;

c) fjalimet publike politike, fetare, të publikuara në botime ditore ose në periodikë të ndryshëm ose të transmetuara për publikun në radio apo televizion, duke përfshirë fjalimet gjatë procedurës gjyqësore në masën e justifikuar për qëllimin që do të arrihet, të bëra nga institucionet shtetërore, fetare ose në ceremonitë shtetërore dhe fetare, si edhe fragmente të prezantimeve publike.

2. Në të gjitha përcaktimet e parashikuara nga pika 1, e këtij neni, është e detyrueshme të tregohet burimi dhe autorësia e veprës, në rastet kur kjo është e mundur.

Neni 81

Riprodhimi pjesor i veprës

1. Lejohet të bëhen shkurtime, citime të fragmenteve ose të pjesëve të një vepre të së drejtës së autorit, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, e cila është botuar ose është vënë në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme, për të riprodhuar, botuar, përcjellë në publik, për qëllime të kërkimit shkencor, mësimdhënies, studimeve kritike, ilustrimit, argumentimit, referimit ose rishikimit, me kusht që një përdorim i tillë të jetë në përputhje me praktikën e drejtë dhe në masën e kërkuar për qëllimin konkret që kërkohet të arrihet.

2. Në të gjitha përcaktimet e parashikuara nga pika 1, e këtij neni, është e detyrueshme të tregohen burimi, autorësia e veprës, si dhe botuesi e përkthyesi, kur kemi të bëjmë me një përkthim, në rastet kur kjo është e mundur.

Neni 82

Riprodhimi i veprave të vendosura në mënyrë të përhershme në vende publike

1. Lejohet riprodhimi i veprave, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, të cilat janë në mënyrë të përhershme të vendosura në rrugë, sheshpushime, parqe ose sheshe të tjera që janë të aksesueshme nga publiku, si dhe shpërndarja, përcjellja ndaj publikut e këtyre riprodhimeve.

2. Veprat e referuara në pikën 1, të këtij neni, nuk mund të riprodhohen në formë tredimensionale.

3. Për sa i përket riprodhimit të strukturave arkitekturore, pika 1, e këtij neni, zbatohet vetëm në lidhje me pamjen e jashtme të strukturës arkitekturore.

4. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, do të tregohen burimi dhe autorësia e këtyre kopjeve, në rastet kur kjo është e mundur.

Neni 83

Posterat dhe katalogët

1. Lejohet për organizuesit e ekspozitave publike, panairove ose të ankandeve, pa autorizimin e autorit apo titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për qëllime promovimi dhe në masën e nevojshme për një qëllim të tillë, të shfaqin dhe të riprodhojnë postera dhe katalogë për ekspozita dhe ankande për veprat e arteve pamore, të arkitekturës, të arteve të aplikuara, sipas nenit 8, të këtij ligji, dhe veprave fotografike, të cilat janë shfaqur në një ekspozitë publike ose ankand ose janë të destinuara për një shfaqje të tillë, me kushtin që kjo të mos jetë bërë për përfitime direkte ose indirekte ekonomike.

2. Në përcaktimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, do të tregohen burimi dhe autorësia, përveçse në rastet kur kjo është e pamundur.

Neni 84

Transformimet e veprave, paroditë dhe karikaturat

Lejohet të transformohet/të ndryshohet vepra, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim nëse:

a) është një transformim privat ose një transformim/ndryshim tjetër i brendshëm, i cili nuk është ideuar/i menduar dhe nuk ka për qëllim vënien në dispozicion të publikut;

b) vepra është transformuar/ndryshuar në një parodi ose karikaturë, në masën e nevojshme për qëllimin e caktuar, duke treguar autorin dhe veprën që është transformuar;

c) transformimi/ndryshimi është bërë për qëllime të përdorimit të lejuar nga autori;

ç) transformimi/ndryshimi është një rishikim i shkurtër i veprave për qëllime didaktike, duke përmendur autorin.

Neni 85

Përdorimi i veprave për qëllimin e prezantimit dhe të testimit të pajisjeve

1. Për qëllime testimi për funksionimin e produkteve të tyre në kohën e prodhimit ose shitjes, kompanitë dhe dyqanet e tregtimit, të angazhuara në prodhimin ose shitjen e

fonogrameve, regjistrimeve audiovizuale ose pajisjeve për riprodhimin ose përcjelljen në publik të tyre dhe gjithashtu pajisjen për marrjen e transmetimeve në radio dhe televizion, mund të riprodhojnë dhe të prezantojnë pjesë të shkëputura nga veprat, me kusht që këto veprime të kryhen vetëm në masën e kërkuar për testimin e këtyre pajisjeve.

2. Riprodhimet dhe prezantimet për testimet e bëra, në bazë të përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, do të fshihen pa vonesë.

Neni 86

Përdorimi i bazës së të dhënave

1. Një përdorues i ligjshëm i një baze të dhënash apo i një kopjeje të saj lejohet të veprojë me të gjitha llojet e përdorimit, nëse kjo është e nevojshme për aksesin në përmbajtjen e bazave të të dhënave dhe përdorimin e saj normal.

2. Nëse një përdorues është i autorizuar vetëm për një pjesë të bazës së të dhënave, ai lejohet të riprodhojë dhe të ndryshojë vetëm atë pjesë.

3. Çdo dispozitë kontraktuale në kundërshtim me dispozitat e këtij neni është e pavlefshme.

Neni 87

Detyrimet e mbajtësit të së drejtës

1. Aty ku përdorimi i një veprë me të drejtë autori pa autorizimin e autorit lejohet, sipas neneve 72-78, të këtij ligji, dhe kur përdorimi i veprës ose aksesin në të kufizohen nga aplikimi i masave teknologjike, të referuara në nenin 154, të këtij ligji, autorët ose personat e tjerë, të cilët kanë aplikuar masa të tilla apo që janë të autorizuar ose që kanë mundësinë t'i heqin ato, detyrohen, duke siguruar masa speciale ose për të lidhur kontrata, t'u mundësojnë përdoruesve apo shoqatave të tyre aksesin në vepra të tilla dhe përdorimin e tyre në përputhje me kufizimet e referuara në nenet 72-78, të këtij ligji. Kjo pikë nuk aplikohet për programet kompjuterike.

2. Në qoftë se autorët apo personat e tjerë, të cilët, përkatësisht, kanë aplikuar masa mbrojtëse teknologjike për të parandaluar aksesin në veprën e së drejtës së autorit ose në përdorimin e saj, ose të cilët janë të autorizuar dhe kanë mundësi për heqjen e tyre, nuk arrijnë ta përmbushin, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, personi që pretendon të jetë i autorizuar në përputhje me ndonjë nga parashikimet e neneve 72-78, të këtij ligji, për të përdorur një vepër pa autorizimin e autorit ose pa autorizimin e autorit dhe pa shpërblim, mund të ndërmarë një veprim ligjor kundër autorit apo personit tjetër, respektivisht, i cili ka aplikuar masa teknologjike ose i cili është i autorizuar dhe ka mundësinë për t'i hequr ato, duke pretenduar shkeljen në aksesin e veprës së të drejtës së autorit dhe të përdorimit të saj në përputhje me kufizimin e përmendur në ndonjë prej neneve 72-78 të këtij ligji. Paditësi duhet të provojë, me anë të veprimit të tij ligjor, që është në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 70 të këtij ligji.

3. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 2, të këtij neni, personi, i cili pretendon të jetë i autorizuar në përputhje me ndonjë nga parashikimet e neneve 72-78, të këtij ligji, për të përdorur një vepër të autorit pa autorizimin e autorit ose pa autorizimi e autorit dhe pa pagesë shpërblimi, ose autori apo personi tjetër, përkatësisht, i cili ka aplikuar masa mbrojtëse teknologjike për të parandaluar aksesin në veprën e së drejtës së autorit ose në përdorimin e saj, ose i cili është i autorizuar apo ka mundësinë për t'i hequr ato, mund të kërkojë procedurë negociimi, sipas këtij ligji, në lidhje me aksesin në veprën e së drejtës së autorit ose në

përdorimin e saj, në përputhje me kufizimin e përmendur në ndonjë prej neneve 72-78 të këtij ligji. Ndërmjetësimi do të realizohet në përputhje me dispozitat e nenit 160 të këtij ligji.

4. Masat teknologjike, të aplikuara vullnetarisht nga mbajtësit e të drejtave, sipas këtij ligji, duke përfshirë edhe ato të aplikuara në zbatimin e marrëveshjeve vullnetare dhe masave teknologjike, të aplikuara në zbatimin e masave të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, gëzojnë mbrojtje ligjore, sipas nenit 154 të këtij ligji.

5. Përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, nuk zbatohen për veprat e vëna në dispozicion të publikut në kushtet kontraktuale, për të cilat është rënë dakord, në një mënyrë të tillë që anëtarët e publikut mund t'i përdorin ato nga një vend dhe në një kohë të caktuar në mënyrë individuale prej tyre.

6. Mbajtësi i së drejtës ose personi tjetër, respektivisht, i cili ka aplikuar masat teknologjike ose që është i autorizuar apo ka mundësinë për t'i hequr ato, duhet, me qëllimin për të siguruar zbatimin efektiv të pikës 1, të këtij neni, të tregojë në mënyrë të qartë dhe të dallueshme për aplikimin e masave teknologjike për çdo kopje të veprës së të drejtës së autorit që është prodhuar ose importuar për qëllime tregtare, duke përfshirë informacionin mbi masën teknologjike dhe efektet e saj, si dhe emrin e saj/tij dhe adresën e kontaktit.

KREU VIII

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR PROGRAMET KOMPJUTERIKE DHE VEPRAT AUDIOVIZUALE

Seksioni 1

Dispozita të veçanta për programet kompjuterike

Neni 88

Objekti i mbrojtjes

1. Sipas këtij ligji, një program kompjuterik do të mbrohet si vepër e fjalës nëse është krijim origjinal individual dhe intelektual i vetë autorit. Termi “program kompjuterik” përbën krijimin në çdo formë të një programi kompjuterik, programet e aplikimit dhe sistemet operative të shprehura në çdo formë gjuhe, duke përfshirë materialet përgatitore të projektimit dhe manualët. Idetë dhe parimet që përbëjnë bazën e cilitdo element të një programi

kompjuterik, duke përfshirë edhe ato, të cilat përbëjnë bazën e ndërfaqes, nuk do të mbrohen nga e drejta e autorit.

2. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji, nëse një program kompjuterik është i përfshirë në një diplomë ose model përdorimi, ai përfiton mbrojtje nga dispozitat ligjore për mbrojtjen e pronësisë industriale.

Neni 89

Programi kompjuterik i krijuar në kushtet e punësimit

Në qoftë se një program kompjuterik është krijuar nga një punëmarrës në ekzekutimin e detyrave të tij ose pas udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi i tij, punëdhënësi, ekskluzivisht, ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat ekonomike për programin e krijuar, përveçse nëse parashikohet ndryshe në kontratë.

Neni 90

E drejta e autorit të programit kompjuterik

1. Autori i programit kompjuterik, sipas dispozitave të kreut III, seksioni 2, të këtij ligji, gëzon të drejtën ekskluzive të ndalojë ose të autorizojë:

a) riprodhimin e përhershëm ose të përkohshëm të një programi kompjuterik me çdo mjet dhe në çdo formë, pjesërisht ose tërësisht; kjo përfshin ngarkimin, ekspozimin, funksionimin, transmetimin ose ruajtjen e një programi kompjuterik, i cili kërkon riprodhimin e tij;

b) përkthimin, përshtatjen, rregullimin dhe çdo ndryshim tjetër të një programi kompjuterik dhe riprodhimin e rezultateve të tij, pa cenuar të drejtat e personit, i cili ndryshon programin;

c) çdo formë të shpërndarjes në publik të origjinalit ose kopjeve të një programi kompjuterik, duke përfshirë dhënien me qira të origjinalit apo kopjeve të tij.

2. Dispozitat e neneve 24, 31 dhe 72, të këtij ligji, nuk do të zbatohen për programet kompjuterike. Programet kompjuterike nuk do të jenë subjekt i huadhënies publike, përveçse nëse është parashikuar në kontratë.

3. Dispozitat e nenit 27, të këtij ligji, për shuarjen e së drejtës së shpërndarjes, do të zbatohen me ndryshimet e nevojshme për programet kompjuterike.

Neni 91

Përfshirjet

1. Në mungesë të dispozitave specifike kontraktuale për veprimet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 90, të këtij ligji, përfshirë edhe korrigjimet e gabimeve, nuk do të kërkohej autorizim nga mbajtësi i së drejtës, kur përdorimi i programit kompjuterik është i nevojshëm për blerësin e ligjshëm, në përputhje me qëllimin.

2. Bërja e një kopjeje rezervë nga një person që zotëron të drejtën e përdorimit të programit kompjuterik nuk mund të pengohet nga një kontratë për aq sa është e nevojshme për atë përdorim.

3. Personi që ka të drejtën për të përdorur një kopje të një programi kompjuterik gëzon të drejtën për të vëzhguar, studiuar ose testuar funksionimin e programit, për të përcaktuar idetë dhe parimet që përbëjnë bazën e cilitdo elementi të programit, pa autorizimin e autorit, nëse

ai e bën këtë gjatë kryerjes së ndonjë prej veprimeve të vendosjes, ekspozimit, funksionimit, transmetimit ose deponimit të programit.

4. Çdo parashikim kontraktor, në kundërshtim me pikat 2 dhe 3, të këtij neni, do të jetë i pavlefshëm.

Neni 92

Zbërthimi i kodit

1. Nëse riprodhimi i kodit dhe përkthimi i formës së tij, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 90, të këtij ligji, janë të domosdoshëm për të marrë informacion të nevojshëm për të arritur ndërveprimin e një programi të krijuar në mënyrë të pavarur me programe të tjera, autorizimi i mbajtësit të së drejtës nuk do të jetë i nevojshëm, me kusht që:

a) këto veprime të kryhen me autorizim për përdorim ose nga një person tjetër, i cili ka të drejtë të përdorë një kopje të programit ose në emër të tij, nga një person i autorizuar për të kryer këtë veprim;

b) informacioni i nevojshëm për të arritur ndërveprimin nuk ka qenë më parë në dispozicion të personave të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) këto veprime kufizohen vetëm për ato pjesë të programit origjinal, të cilat janë të nevojshme për arritjen e ndërveprimit.

2. Informacioni i marrë nëpërmjet aplikimit të parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, nuk mund:

a) të përdoret për qëllime të tjera, përveçse për të arritur ndërveprimin e programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur;

b) t’u transferohet personave të tjerë, përveçse kur është e nevojshme për arritjen e ndërveprimit të programit të krijuar në mënyrë të pavarur;

c) të përdoret për prodhimin, zhvillimin ose marketingun e një programi tjetër kryesisht të ngjashëm në thelbin e tij ose për çdo veprim tjetër që cenon të drejtën e autorit.

3. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të interpretohen në atë mënyrë që zbatimi i tyre të cenojë interesat e ligjshëm të mbajtësve të të drejtave mbi veprën ose të cenojë shfrytëzimin normal të programit kompjuterik.

4. Çdo parashikim kontraktor, në kundërshtim me parashikimet e këtij neni, është i pavlefshëm.

Neni 93

Masat e veçanta të mbrojtjes

Shkelje të të drejtave në një program kompjuterik përbën, në veçanti:

a) çdo veprim i shpërndarjes së një kopjeje të një programi kompjuterik, duke e ditur ose duke pasur arsye për të besuar se ajo është një kopje e paligjshme;

b) zotërimi për qëllime tregtare të një kopjeje të një programi kompjuterik, duke e ditur ose duke pasur arsye për të besuar se është një ekzemplar i paligjshëm;

c) çdo veprim i shpërndarjes ose posedimi për qëllime tregtare i çdo mjeti, qëllimi i vetëm i të cilit është që të largojë ose të anashkalojë në mënyrë të paautorizuar pajisjet teknike, të cilat shërbejnë si mbrojtje e një programi kompjuterik.

Neni 94

Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore

Dispozitat e këtij ligji, lidhur me mbrojtjen e programeve kompjuterike dhe të të drejtave të tjera të autorit, të të drejtave të lidhura me to, nuk cenojnë dispozitat e tjera ligjore, siç janë ato që rregullojnë mbrojtjen e shpikjeve nga patentat, markat tregtare, mbrojtjen e dizajneve dhe topografive të produkteve gjysmëpërçuese, modelet e përdorimit, qasjes së kushtëzuar, qasjes në shërbimet e transmetimeve kabllore, mbrojtjen e thesareve kombëtare, kërkesat për depozitat ligjore, ligjet për praktikën kufizuese dhe konkurrencën e pandershme, të sigurisë, konfidencialitetit, mbrojtjen e të dhënave e privatësisë dhe qasjes në dokumentet publike.

Seksioni 2

Dispozita të veçanta për veprat audiovizuale ose kinematografike

Neni 95

Veprat audiovizuale

Veprat audiovizuale, sipas këtij ligji, janë filmat kinematografikë, televizivë, filmat e animuar, reklamat ose filmat e tjerë, videot e shkurtra muzikore, dokumentarët, emisione dhe grafika televizive, si dhe veprat e tjera audiovizuale, të shprehura nga sekuenca të pamjeve lëvizëse të ndërlidhura, me ose pa zë, pavarësisht nga natyra e mjetit në të cilën ato janë të fiksuara.

Neni 96

E drejta e përshtatjes audiovizuale

1. E drejta e përshtatjes audiovizuale është e drejta ekskluzive e autorit të një vepre ekzistuese të së drejtës së autorit për ta transformuar atë në një vepër audiovizuale.

2. Kalimi i së drejtës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të bëhet vetëm në bazë të një kontrate me shkrim, e dallueshme nga kontrata e botimit për një vepër, mes autorit të së drejtës së autorit dhe prodhuesit të veprës audiovizuale.

3. Prodhuesi i një vepre audiovizuale është personi fizik ose juridik, i cili merr përgjegjësinë për prodhimin e veprës, si dhe siguron burimet e nevojshme teknike e financiare për realizimin e saj, sipas kushteve të kontratës.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë, në kontratën e përshtatjes audiovizuale, të lidhur mes autorit të një vepre ekzistuese të mëparshme dhe prodhuesit (producentit) të filmit, do të konsiderohet se këtij të fundit i kalon ekskluzivisht dhe pa kufizime e drejta e transformimit dhe përfshirjes së veprës burimore/ekzistuese në një vepër audiovizuale, të drejtat ekonomike në këtë vepër audiovizuale, në përkthimet e saj, transformimet audiovizuale dhe të fotografive të bëra në lidhje me prodhimin e veprës audiovizuale.

5. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 3, të këtij neni, autori i veprës së përshtatur do të mbajë:

a) të drejtën ekskluzive të përshtatjeve të reja audiovizuale të veprës së përshtatur, të cilën ai mund të ushtrojë pas kalimit të njëzet vjetëve nga lidhja e kontratës së përmendur në pikën 1 të këtij neni;

b) të drejtën ekskluzive të ndryshimit të mëtejshëm të veprës audiovizuale në ndonjë formë tjetër artistike;

c) të drejtën për një shpërblim të drejtë nga prodhuesi i filmit për çdo dhënie me qira të një videogrami që përmban veprën audiovizuale.

6. Autori i një vepre të përshtatur nuk mund të heqë dorë nga e drejta e përmendur në pikën 5 të këtij neni.

Neni 97

Bashkautorësia në veprën audiovizuale

1. Personat në vijim njihen si bashkautorë të një vepre audiovizuale:

- a) regjisori kryesor, i cili do të konsiderohet si autori i veprës ose si një ndër autorët e saj;
- b) autori i skenarit (skenaristi);
- c) autori i dialogëve;
- ç) kompozitori i veprës muzikore (me ose pa tekst), e krijuar posaçërisht për veprën audiovizuale;
- d) autori i përshtatjes së veprës;
- dh) drejtori i fotografisë.

2. Në qoftë se një vizatim ose krijim i animuar përbën një element thelbësor të veprës audiovizuale, krijuesi kryesor i vizatimit ose i animimit do të konsiderohet si një bashkautor i kësaj vepre.

Neni 98

Autorët e kontributeve në veprën audiovizuale

Një krijues i animimit (animator) ose i vizatimit dhe një kompozitor i muzikës së filmit, të cilët nuk konsiderohen bashkautorët e veprës audiovizuale ose kinematografike, sipas kuptimit të nenit 97, të këtij ligji, një skenograf/e, kostumograf/e, një artist *make up*-i dhe një redaktor, të gjithë do të kenë të drejta të autorëve në lidhje me kontributet e tyre individuale në vepër (autorët e kontributeve).

Neni 99

Kontrata e prodhimit/prodhimit audiovizual

1. Një kontratë për prodhues audiovizual rregullon marrëdhëniet ndërmjet producentit të filmit, bashkautorëve të një vepre audiovizuale dhe autorëve të kontributeve, si edhe marrëdhëniet ndërmjet autorëve të një vepre audiovizuale.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe me kontratë, do të konsiderohet se bashkautorët dhe autorët, nëpërmjet kontratës së prodhimit të filmit, i kanë kaluar prodhuesit (producentit) të filmit, ekskluzivisht dhe pa kufizime, të gjitha të drejtat e tyre ekonomike mbi veprën audiovizuale, përkthimin e saj, transformimet audiovizuale dhe fotografitë e bëra në lidhje me këtë vepër.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratën për prodhimin (prodhuesin) audiovizual ndërmjet producentit të filmit dhe autorëve të kontributeve, do të konsiderohet se

prodhuesi (producenti) i filmit fiton të gjitha të drejtat ekonomike të autorëve të tillë për të përdorur kontributet e tyre në masën e nevojshme për të përmbushur qëllimin e kontratës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni:

a) bashkautorët ruajnë të drejtën ekskluzive për transformimin e mëtejshëm të veprës audiovizuale në një formë tjetër artistike;

b) autorët e kontributeve ruajnë të drejtën për të përdorur në mënyrë individuale kontributet e tyre në veprën audiovizuale, me kusht që ky përdorim të mos cenojë të drejtat e prodhuesve (producentëve) të filmit;

c) bashkautorët ruajnë të drejtën e një shpërblimi të drejtë nga prodhuesi (producenti) i filmit për çdo dhënie me qira të videogrameve të veprës audiovizuale.

5. Bashkautorët dhe autorët e kontributeve të një vepre audiovizuale nuk mund të heqin dorë nga të drejtat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

Neni 100

Të ardhurat nga shfrytëzimi i veprave audiovizuale

1. Bashkautorët e veprës audiovizuale gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës audiovizuale të autorit, e cila llogaritet në mënyrë proporcionale me të ardhurat e përgjithshme, që rrjedhin prej saj, me përjashtim të rastit kur është rënë dakord ndryshe.

2. Prodhuesi (producenti) i filmit duhet të paktën një herë në vit të dërgojë te bashkautorët e veprës audiovizuale një raport për të ardhurat, në mënyrë të veçantë për secilën formë të autorizuar të shfrytëzimit të veprës. Autorët e marrin shpërblimin nga prodhuesi apo nga përdoruesit ose nga agjencia e administrimit kolektiv, në bazë të marrëveshjeve të bëra ndërmjet tyre.

Neni 101

Përfundimi i veprës audiovizuale

1. Vepra audiovizuale konsiderohet e përfunduar kur, sipas marrëveshjes ndërmjet regjisorit kryesor dhe prodhuesit (producentit) të filmit, kopja e parë standarde e veprës, që është objekt i kontratës, është e realizuar.

2. Kopja origjinale, ku është materializuar versioni përfundimtar i veprës, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk duhet të shkatërrohet.

3. Çdo ndryshim në kopjen e veprës audiovizuale, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, do të jetë i lejueshëm vetëm pasi të jetë arritur marrëveshja paraprake ndërmjet prodhuesit (producentit) të filmit dhe regjisorit kryesor.

4. Kur ndonjë nga bashkautorët refuzon përfundimin e kontributit të tij në veprën audiovizuale ose nëse ai nuk është në gjendje ta bëjë këtë, për shkak të forcës madhore, ai nuk mund të kundërshtojë përdorimin e kontributit të tij të bërë deri atëherë për qëllim të përfundimit të kësaj vepre. Autori në fjalë do të ketë të drejtat përkatëse të së drejtës së autorit lidhur me kontributin që ai ka bërë tashmë.

Neni 102

Zgjidhja e kontratës

1. Nëse prodhuesi nuk e përfundon veprën audiovizuale brenda pesë viteve nga dita e lidhjes së kontratës së prodhimit (produksionit) të filmit ose në qoftë se ai nuk e shpërndan

veprën e përfunduar audiovizuale brenda një viti nga koha e realizimit të saj, bashkautorëve u lind e drejta të kërkojnë zgjidhjen e kontratës, përveçse nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratë.

2. Në rastin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, bashkautorët dhe autorët e kontributeve ruajnë të drejtën e shpërblimit për dëmin e shkaktuar, përkatësisht, mbi secilën pjesë përbërëse të veprës audiovizuale.

PJESA III

TË DREJTAT E LIDHURA

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 103

Pavarësia e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura

1. Mbrojtja që sigurohet nga ky ligj për të drejtat e lidhura nuk cenon në asnjë mënyrë mbrojtjen e të drejtave të autorit mbi veprat e tyre. Për rrjedhojë, asnjë dispozitë e kësaj pjese nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të kufizojë ushtrimin e së drejtës së autorit.

2. Të drejtat pasurore, të parashikuara në këtë pjesë, mund t'u kalohen të tjerëve, pjesërisht ose tërësisht, sipas dispozitave të këtij ligji për kalimin e të drejtave pasurore të autorit, të cilat zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për këto të drejta.

3. Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe e kategorive të ndryshme të të drejtave të lidhura janë të pavarura nga njëra-tjetra në kuptimin që, kur i njëjti individ, person fizik ose juridik, është mbajtësi i më shumë sesa një kategorie të të drejtave, përveç rasteve kur ky ligj e parashikon ndryshe, i gëzon dhe mund t'i ushtrojë ato të drejta në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

4. Çdo marrëveshje për kalimin e të drejtave pasurore në formën ekskluzive depozitohet, regjistrohet dhe certifikohet në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit.

Neni 104

Mbrojtja pa formalitete e të drejtave të lidhura dhe prezumimi i mbrojtjes

1. Për përfitim dhe ushtrimin e të drejtave të lidhura nuk kërkohet asnjë formalitet. Në mungesë të provës për të kundërtën, individ, personi fizik ose juridik, emri i të cilit shfaqet në fiksimin e një interpretimi/ekzekutimi, fonogrami, fiksimin/regjistrimin e parë të një filmi, fiksimin/regjistrimin e një transmetimi ose në një bazë të dhënash, konsiderohet përkatësisht si interpretuesi/ekzekutuesi, prodhuesi i fonogramit, prodhuesi i fiksimit/regjistrimit të parë të filmit, transmetuesi ose bërësi/autori i bazës së të dhënave.

2. Me qëllim përmendjen e të drejtave të tyre dhe shpërndarjen e kopjeve të autorizuara të regjistrimeve fonografike ose të ndonjë pajisjeje tjetër të ngjashme për riprodhimin e tingujve apo të zërave, ku është regjistruar një vepër e autorizuar, prodhuesit e fonogrameve dhe

interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit duhet, detyrimisht, të vendosin një shënim mbi çdo kopje të fonogramit ose në çdo mbështjellëse të fonogramit që përmban elementet në vijim:

- a) shkronjën e madhe P të rrethuar (P);
- b) emrin e mbajtësit të të drejtave të lidhura ekskluzive;
- c) vitin e publikimit të parë të fonogramit;
- ç) autorizimin nga titullari i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të;
- d) titullin e veprës;
- dh) pullën artistike të Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, të pakonsumuar;
- e) emrin e artistit interpretues dhe/ose ekzekutues, si dhe emrin artistik në rastet e identifikimit të grupeve orkestrale ose korale.

3. Për ushtrimin e së drejtës së shpërndarjes, sipas kësaj pjese, është e detyrueshme që një kopje e mbajtësit fonografik ose e mjetit tjetër të ngjashëm me të për riprodhimin e tingujve ose të zërave depozitohet në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit.

Neni 105

Afati i mbrojtjes së të drejtave të lidhura

1. Dispozitat për kohëzgjatjen e të drejtave vetjake jopasurore të autorëve gjejnë zbatim me ndryshimet e nevojshme, për të drejtat vetjake jopasurore të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve.

2. Afati i mbrojtjes së të drejtave pasurore të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve është 50 vjet pas datës së interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre. Megjithatë:

a) nëse fiksimi i një interpretimi dhe/ose ekzekutimi, duke përjashtuar rastin kur ky fiksion është në fonogram, publikohet ose transmetohet në mënyrë të ligjshme ose i përcillet publikut apo i vihet në dispozicion publikut në mënyrë ndërvepruese brenda kësaj periudhe, afati është 50 vjet nga data që shënon herën e parë të këtij publikimi, transmetimi, përcjelljeje në publik ose vendosjeje në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, cilado nga këto të jetë bërë më parë;

b) nëse fiksimi i një interpretimi dhe/ose ekzekutimi në fonogram, në mënyrë të ligjshme, është publikuar, i është përcjellë publikut, është transmetuar ose i është vënë në dispozicion publikut në mënyrë ndërvepruese brenda kësaj periudhe, afati i mbrojtjes është 70 vjet nga data e publikimit të parë të ligjshëm ose përcjelljes së parë në publik, transmetimit të parë ose vënies në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, cilado qoftë data më e hershme.

3. Afati i mbrojtjes së të drejtave të prodhuesve të fonogrameve përfundon 50 vjet pasi është bërë fiksimi i fonogramit. Nëse brenda kësaj periudhe fonogrami është publikuar në mënyrë të ligjshme, të drejtat në fjalë përfundojnë 70 vjet nga data e publikimit të parë të ligjshëm. Nëse brenda këtij afati nuk është bërë asnjë publikim i ligjshëm dhe nëse fonogrami është përcjellë në publik në mënyrë të ligjshme brenda kësaj periudhe, të drejtat në fjalë përfundojnë 70 vjet pas datës së përcjelljes së parë në publik në mënyrë të ligjshme.

4. Afati i mbrojtjes së të drejtave të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave dhe të fonogrameve përfundon 50 vjet pas bërjes së fiksimit të parë. Nëse gjatë kësaj periudhe filmi është publikuar ose transmetuar në mënyrë të ligjshme, është përcjellë në publik apo është vendosur ligjërisht në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, të drejtat përfundojnë nga data që shënon herën e parë të këtij publikimi, transmetimi, përcjelljeje në publik ose vendosjeje në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, cilado nga këto të jetë bërë më parë.

5. Afati i mbrojtjes së të drejtave të ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv përfundon 50 vjet pas përcjelljes së parë të transmetimit, nëse ky transmetim është kryer me ose pa tel, duke përfshirë transmetimin kabllor ose satelitor.

6. Afati i mbrojtjes së të drejtave të botuesve është 50 vjet nga data e botimit të parë të ligjshëm të veprës.

7. Afati i mbrojtjes, i parashikuar në pikat 2 deri në 5, të këtij neni, llogaritet nga 1 janari i vitit pasardhës të vitit në të cilin ka ndodhur ngjarja që merret si bazë për llogaritjen e tij.

8. Pika 8, e nenit 41, të këtij ligji, gjen zbatim, me ndryshimet e nevojshme, për afatet e mbrojtjes së të drejtave të lidhura.

Neni 106

Kufizimet e të drejtave të lidhura

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, dispozitat e parashikuara në kreun VII, të këtij ligji, për kufizimet që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit, gjejnë zbatim, me ndryshimet e nevojshme, për të drejtat e lidhura.

KREU II

TË DREJTAT E INTERPRETUESVE DHE/OSE EKZEKUTUESVE

Neni 107

Artistët interpretues dhe/ose ekzekutues

“Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit”, sipas këtij ligji, janë aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët, dirigjentët e orkestrave ose të korit dhe personat e tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, që drejtojnë një orkestër ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.

Neni 108

Të drejtat jopasurore të interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit

1. Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit kanë këto të drejta vetjake jopasurore:

- a) të drejtën për të kërkuar njohjen e autorësisë së shfaqjes;
- b) të drejtën për të kërkuar që emri ose pseudonimi të përmendet në shfaqjet në publik ose në transmetimin apo fiksimin e veprës në ndonjë regjistrim fonografik, film, në një mbajtës tjetër veprash audiovizuale ose në çdo prodhim tjetër të ngjashëm me to;
- c) të drejtën për të kërkuar respektimin e cilësisë së interpretimit/paraqitjes së tij dhe për të kundërshtuar çdo shtrembërim, falsifikim ose modifikim tjetër të konsiderueshëm të shfaqjes së tij ose çdo shkelje të të drejtave të tij që mund të cenonte nderin apo reputacionin e tij.

2. Të drejtat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk përbëjnë objekt të dorëheqjes nga interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit. Pas vdekjes së interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit, të drejtat e parashikuara në këtë nen kalohen me trashëgimi, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë për një periudhë të pakufizuar kohe.

Të drejtat ekskluzive pasurore të interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit

1. Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit kanë të drejta ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar:

- a) regjistrimin e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- b) riprodhimin e fonogramit ose videogramit me përmbajtjen e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- c) shpërndarjen e fonogramit ose videogramit me përmbajtjen e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- ç) qiradhënien e fonogramit ose videogramit me përmbajtjen e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- d) huadhënien e fonogramit ose videogramit me përmbajtjen e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- dh) importimin, për qëllime tregtare në tregun e brendshëm, të fonogramit ose videogramit me përmbajtjen e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- e) transmetimin e interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve dhe përcjelljen e tyre në publik, sipas parashikimeve të nenit 29, shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “ë”, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur interpretimi dhe/ose ekzekutimi është fiksuar ose transmetuar më parë. Nëse regjistrimi/fiksimi është bërë në një fonogram ose videogram, interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi ka të drejtën e përfitimit të një shpërblimi të përbashkët, të drejtë, për transmetimin dhe përcjelljet e tjera në publik të interpretimit dhe/ose ekzekutimit të tij. Shpërblimi i përbashkët, i drejtë, i përmendur në këtë pikë, të këtij neni, përbëhet prej shpërblimit të marrë nga përdoruesi i fonogrameve dhe që i përket interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit dhe prodhuesit të fonogrameve;
- ë) ritransmetimin kabllor të interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre;
- f) vënien në dispozicion në mënyrë ndërvepruese të fiksimeve të interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre.

2. “Fiksimi” (ose regjistrimi), sipas këtij ligji, është trupëzimi i tingujve, pamjeve ose i të dyjave së bashku apo paraqitja e tyre, ku prej tyre mund të përftohet një krijim, i cili të perceptohet, të riprodhohet ose të përcillet nëpërmjet një pajisjeje.

3. Në rastin e interpretimit dhe/ose ekzekutimit në të njëjtën shfaqje në mënyrë kolektive, autorizimi për veprimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të jepet nga përfaqësuesi i interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve që marrin pjesë në këtë shfaqje. Përfaqësuesi i interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve e fiton të drejtën e përfaqësimit me pëlqimin me shkrim, respektivisht, të shumicës së anëtarëve të grupit muzikor, të korit, të trupës së kërcimit ose asaj teatrale, nëpërmjet anëtarëve të një orkestre ose ansambleve të tjera të ngjashme. Parashikimet e kësaj pike nuk zbatohen për solistët, dirigjentët dhe regjisorët e shfaqjeve teatrale.

4. Dispozitat mbi të drejtën e shpërndarjes dhe të drejtën e qiradhënies së autorëve gjejnë zbatim me ndryshimet e nevojshme, edhe për të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve. Për ushtrimin e së drejtës së ritransmetimit kabllor të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve gjen zbatim neni 27 i këtij ligji.

5. Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit kanë të drejtën e një shpërblimi të drejtë për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, sipas nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

6. Me përjashtim kur përcaktohet ndryshe në kontratën e prodhimit (produksionit audiovizual), interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit, që marrin pjesë në prodhimin e një veprë audiovizuale ose në regjistrimin e fonogrameve të ndryshme, prezumohen se ia kalojnë

prodhuesit të filmit, ekskluzivisht dhe pa kufizime, të gjitha të drejtat ekonomike të shfaqjes së tyre.

7. Për çdo të drejtë ekonomike, e cila është kaluar sipas pikës 6, të këtij neni, interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit do të gëzojnë të drejtën për përfitimin e shpërblimit të drejtë nga prodhuesi (producenti) i filmit.

8. Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit nuk mund të heqin dorë nga e drejta e parashikuar në pikën 6 të këtij neni.

Neni 110

Përdorimi i shfaqjes për përfundimin e veprës audiovizuale

Në rastin kur ndonjë interpretues dhe/ose ekzekutues refuzon të përfundojë kontributin e tij në një vepër audiovizuale ose është në pamundësi për ta bërë këtë, për shkak të forcës madhore, ai nuk mund të kundërshtojë përdorimin e kontributit të tij, që ka bërë tashmë, për qëllimin e përfundimit të kësaj vepre audiovizuale. Interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi në fjalë do të ketë të drejtat respektive për kontributin që ka bërë.

Neni 111

Interpretimi dhe/ose ekzekutimi i dhënë në kushtet e një kontrate punësimi

Në rastin e një interpretimi dhe/ose ekzekutimi të dhënë nga interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi, në kushtet e një kontrate individuale punësimi, të drejtat ekonomike të parashikuara në nenin 109, pika 1, të këtij ligji, mund t'i kalojnë punëdhënësit me kushtin që çdo kalim të përmendet shprehimisht në kontratën individuale të punës. Dispozitat e këtij ligji mbi veprat e krijuara në marrëdhënie punësimi gjejnë zbatim, me ndryshimet e nevojshme, edhe për të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve.

KREU III

TË DREJTAT E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE

Neni 112

Kuptimi i fonogramit dhe i prodhuesit të tij

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Fonogram” është fiksimi i tingullit të një interpretimi dhe/ose ekzekutimi apo tingujve të tjerë ose paraqitja e tingujve në një formë tjetër, përveç asaj të fiksimit të përfshirë në një vepër audiovizuale.

b) “Prodhuesi i fonogramit” është personi fizik ose juridik, i cili ndërmerr nismën dhe mban përgjegjësinë për fiksimin e parë të tingujve në një interpretim dhe/ose ekzekutim apo tingujve të tjerë ose paraqitja e tingujve në një formë tjetër.

Neni 113

Të drejtat ekskluzive të prodhuesit të fonogrameve

1. Dispozitat e nenit 27, të këtij ligji, gjejnë zbatim, me ndryshimet e nevojshme, edhe për këtë të drejtë të prodhuesve të fonogrameve. Për ushtrimin e së drejtës së ritransmetimit kabllor të prodhuesve të fonogrameve gjen zbatim shkronja “e”, e nenit 29, të këtij ligji.

2. Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejta ekskluzive për autorizimin dhe ndalimin e veprimeve në vijim:

- a) riprodhimin e fonogrameve të tyre;
- b) shpërndarjen e fonogrameve të tyre;
- c) qiradhënien dhe huadhënien publike të fonogrameve të tyre;
- ç) ritransmetimin kabllor të fonogrameve të tyre;
- d) vënien në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese të fonogrameve të tyre.

3. Prodhuesit e fonogramit kanë të drejtën e një shpërblimi të drejtë për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, sipas nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

Neni 114

E drejta për shpërblimin e përbashkët për transmetimin dhe përcjelljen në publik të fonogrameve

1. Në rastin e transmetimit ose për çdo përcjellje tjetër në publik të fonogrameve të publikuara, për qëllime tregtare, në përputhje me parashikimin e bërë në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 109, të këtij ligji, përdoruesi duhet t’i paguajë prodhuesit të fonogrameve një shpërblim të përbashkët, të drejtë për çdo përcjellje në publik të fonogrameve.

2. Prodhuesi i fonogramit do të paguajë gjysmën e shpërblimit të përmendur në pikën e mësipërme për interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit nga përdorimi i interpretimeve dhe/ose ekzekutimeve të tyre, që janë të fiksuara në fonograme, përveçse nëse një shpërndarje e ndryshme përcaktohet me kontratë ndërmjet prodhuesve të fonogrameve dhe interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve.

3. Për qëllime të këtij neni, fonogramet, që vihen në dispozicion të publikut, me tel apo pa tel, nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht, do të konsiderohen të publikuara për qëllime tregtare.

Neni 115

Dispozita të veçanta mbi të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve e të prodhuesve të fonogramit, të cilëve u ka mbaruar afati i mbrojtjes

1. Nëse 70 vjet pas fiksimit të parë të fonogramit, pavarësisht nëse është publikuar ose jo në mënyrë të ligjshme, si dhe 70 vjet pasi është transmetuar, përcjellë në publik ose është vendosur në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese dhe të ligjshme, prodhuesi i fonogramit nuk ofron për shitje kopje të fonogramit në masë të mjaftueshme ose nuk e vë në dispozicion të publikut në mënyrë interaktive, interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën, nëpërmjet së cilës ia ka kaluar të drejtat për fiksimin e interpretimit dhe/ose ekzekutimit prodhuesit të fonogramit.

2. Para përfundimit të kontratës së përmendur në pikën 1, të këtij neni, interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi do të njoftojë prodhuesin e fonogramit se ai do të ofrojë kopje të fonogramit për shitje në sasi të kënaqshme për nevojat e arsyeshme të publikut dhe do ta bëjë atë të disponueshme për publikun brenda një periudhe prej një viti, duke llogaritur nga dita e marrjes së njoftimit me shkrim të interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit.

3. Interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi nuk mund të heqë dorë nga e drejta për të zgjidhur kontratën e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

4. Nëse një fonogram përmban fiksimin e interpretimit të shumë interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve, ata mund ta zgjidhin kontratën mbi dhënien e së drejtës për shfrytëzimin e interpretimit dhe/ose ekzekutimit së tyre, të fiksuar në një fonogram, në përputhje me përcaktimin e nenit 109, pika 3, të këtij ligji.

5. Nëse interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi ka zgjidhur kontratën mbi dhënien e së drejtës për shfrytëzimin e interpretimit dhe/ose ekzekutimit së tyre, të fiksuar në një fonogram, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, të drejtat e prodhuesit të fonogramit në këtë fonogram do të shuhen pas 70 viteve nga data e publikimit të parë të ligjshëm të fonogramit ose nga data e përcjelljes në publik në mënyrë të ligjshme.

6. Nëse, në bazë të kontratës mes një interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi dhe prodhuesit të fonogramit, interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi ka fituar të drejtën për të pretenduar një shpërblim joperiodik, atëherë interpretuesi/ekzekutuesi ka të drejtën e një shpërblimi plotësues nga prodhuesi i fonogramit për çdo vit, deri 50 vjet nga data e publikimit të parë të ligjshëm ose nga data e përcjelljes në publik në mënyrë të ligjshme, nëse prodhuesi nuk e ka publikuar fonogramin sipas kontratës.

7. Interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi nuk mund të heqë dorë nga e drejta për të përfituar shpërblimin plotësues vjetor.

8. Shuma e vendosur nga prodhuesi i fonogramit për pagesën e shpërblimit plotësues vjetor, të parashikuar në pikën 6, të këtij neni, llogaritet në masën 20 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës, që janë përftuar nga prodhuesi si rezultat i riprodhimit, shpërndarjes dhe vënies në dispozicion të publikut të fonogramit në fjalë të vitit të 70-të nga data e publikimit të ligjshëm ose, në mungesë të këtij publikimi, vitin e 70-të nga transmetimi për herë të parë në mënyrë të ligjshme, përcjellja në publik në mënyrë të ligjshme ose vënia në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese në mënyrë të ligjshme.

9. Prodhuesit e fonogramit i garantojnë interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit, përkatësisht për interpretimet dhe/ose ekzekutimet e tyre, të drejtën e përfitimit të shpërblimit plotësues vjetor me gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shpërblimit të drejtë, sipas pikës 6 të këtij neni.

10. E drejta për të përfituar shpërblimin plotësues vjetor, parashikuar në pikën 6, të këtij neni, administrohet nga agjencia e administrimit kolektiv.

11. Në rastin kur interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi gëzon të drejtën e shpërblimit periodik, për këtë pagesë nuk zbatohet paradhënia dhe nuk mbahen zbritjet e përcaktuara në kontratë, duke filluar nga viti i 70-të i publikimit të ligjshëm ose, në mungesë të këtij publikimi, nga viti i 70-të i transmetimit për herë të parë në mënyrë të ligjshme, përcjelljes në publik në mënyrë të ligjshme ose vënies në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese e të ligjshme.

KREU IV

TË DREJTAT E PRODHUESVE TË FIKSIMEVE TË PARA TË FILMAVE

Neni 116

Të drejtat e prodhuesve të fiksimeve të para të filmave

1. Prodhuesi i fiksimeve të para të filmave është personi fizik ose personi juridik që, në emër të vet dhe më vete ose në llogari të dikujt tjetër, organizon dhe menaxhon prodhimin e një veprë audiovizuale, si dhe ka përgjegjësinë për përfundimin e saj.

2. Prodhuesit e fiksimeve të para të filmave kanë të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar veprimet vijuese në raport me origjinalin ose kopjet e filmave të tyre:

- a) riprodhimin e filmave të tyre;
- b) shpërndarjen e filmave të tyre;
- c) qiradhënien dhe huadhënien publike të kopjeve të filmave të tyre;
- ç) vënien në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese të filmave të tyre;
- d) paraqitjen publike të filmave të tyre.

3. Neni 27 gjen zbatim, me ndryshimet e nevojshme, për të drejtën e prodhuesve për shpërndarjen e fiksimeve të para të filmave.

4. Në zbatim të këtij kreu:

a) “Film ose videogram” është:

i) fiksimi i parë i asaj çka cilësohet si vepër audiovizuale;

ii) çdo sekuencë pamjesh në lëvizje, e shoqëruar ose jo me tingull që, në mungesë të origjinalitetit, nuk cilësohet si një vepër audiovizuale;

b) “Fiksime i parë i filmit” është forma përfundimtare e filmit që mund të shërbejë për përdorim nga publiku.

5. Prodhuesit e filmit kanë të drejtën e një shpërblimi të drejtë për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, sipas nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

6. Të drejtat e lidhura të prodhuesit të fiksimit të parë të filmit dhe e drejta e autorit, mbajtës i së cilës është prodhuesi i fiksimit të parë të filmit, zbatohen paralelisht dhe në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, si në rastin kur fiksimi i parë i filmit cilësohet si vepër audiovizuale, ashtu edhe për mbajtësin e së drejtës së autorit për veprën audiovizuale.

KREU V

TË DREJTAT E OFRUESVE TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIOVIZIV (OSHMA)

Neni 117

Të drejtat e ofruesve të shërbimit mediatic

1. Ofruesit e shërbimit mediatic gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar veprimet vijuese, që kanë të bëjnë me:

a) fiksimin e transmetimeve të tyre, nëse këto transmetime janë të transmetueshme me tel ose pa tel, duke përfshirë transmetimin kabllor ose me satelit;

b) riprodhimin e fiksimeve të këtyre transmetimeve;

c) shpërndarjen e fiksimeve të transmetimeve të tyre;

ç) ritransmetimin e transmetimeve të tyre me tel apo pa tel;

d) përcjelljen në publik të transmetimeve të tyre në vendet ku kërkohet një tarifë;

dh) vënien në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese të fiksimeve të transmetimit të tyre.

2. Neni 27, i këtij ligji, gjen zbatim, me ndryshimet e nevojshme, për të drejtën e shpërndarjes së fiksimit të transmetimeve të ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv.

3. Një operator i rrjetit numerik, i cili thjesht ritransmeton me sistem kabllor transmetimin e ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv, nuk do të konsiderohet ofrues shërbimi mediatic audioviziv, sipas dispozitave të këtij kreu.

4. Të drejtat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, nuk mund të kalohen në formë ekskluzive ose joekskluzive, pa respektuar të drejtën e autorëve krijues, interpretues dhe/ose ekzekutues, dhe prodhuesit të filmit.

KREU VI

TË DREJTAT E BOTUESVE

Neni 118

E drejta për shpërblim

Botuesit kanë të drejtën e tyre për shpërblim të arsyeshëm për çdo riprodhim të botimeve të tyre me shkrim për përdorim personal privat ose përdorim tjetër personal, në mënyrë të barabartë me të drejtën e autorit për shpërblim, sipas parashikimit në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

PJESA IV

MBROJTJA *SUI GENERIS* E TË DREJTAVE TË KRIJUESVE TË BAZAVE TË TË DHËNAVE

Neni 119

Objekti i mbrojtjes

1. Një bazë të dhënash do të thotë një koleksion i veprave të pavarura, i të dhënave ose materialeve të tjera në çfarëdo formë, të rregulluara në mënyrë sistematike ose metodike dhe të aksesueshme në mënyrë individuale me mjete elektronike ose nëpërmjet mjeteve të tjera, ku sigurimi, verifikimi ose paraqitja e përmbajtjeve të tyre kërkon një investim cilësor dhe/ose sasior të konsiderueshëm.

2. Një prodhues i bazës së të dhënave është një person fizik ose juridik, i cili merr iniciativën dhe rrezikun e investimeve të referuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Mbrojtja e bazës së të dhënave ose përmbajtja e saj zbatohet pavarësisht nga mbrojtja e tyre nga e drejta e autorit ose nga të drejta të tjera. Përfshirja e një materiali në një bazë të dhënash dhe përdorimi i tij bëhen pa cenimin ndaj të drejtave ekzistuese në lidhje me atë material.

Neni 120

Fusha e mbrojtjes

1. Mbrojtja e bazës së të dhënave, sipas kësaj pjese, zbatohet:

- a) ndaj tërë përmbajtjes së bazës së të dhënave;
- b) për çdo pjesë cilësore ose sasimore të konsiderueshme të përmbajtjes së saj;

c) për pjesët cilësore dhe/ose sasiore jothelbësore të një baze të dhënash, kur këto pjesë janë përdorur në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, gjë që bie ndesh me shfrytëzimin normal të asaj baze të dhënash ose në mënyrë të paarsyeshme cenohen të drejtat legjitime të prodhuesit të bazës së të dhënave.

2. Mbrojtja, sipas këtij neni, nuk zbatohet për programet kompjuterike të përdorura në bërjen ose funksionimin e bazave të të dhënave elektronike.

Neni 121

Të drejtat e autorit të bazës së të dhënave

1. Prodhuesi i një baze të dhënash gëzon të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar nxjerrjen dhe/ose ripërdorimin e tërë ose të një pjese të konsiderueshme të bazës së të dhënave, të vlerësuara në mënyrë cilësore ose sasiore.

2. Për qëllimin e kësaj pjese, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Nxjerrje” është transferimi i përkohshëm ose i përhershëm i të gjithë përmbajtjes së bazës së të dhënave ose një pjese të saj në një mjedis tjetër me çdo mjet ose në çdo formë.

b) “Ripërdorim” është çdo formë e vendosjes në dispozicion të publikut të të gjithë përmbajtjes së bazës së të dhënave ose të një pjese të konsiderueshme të saj, nëpërmjet riprodhimit dhe shpërndarjes së kopjeve, përmes dhënies me qira, të drejtës për vënien në dispozicion të publikut të përmbajtjes së bazës së të dhënave dhe nëpërmjet çdo forme tjetër të përcjelljes në publik të bazës së të dhënave. Shitja e parë e kopjes së bazës së të dhënave, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga mbajtësi i së drejtës ose me pëlqimin e tij, shuan të drejtën e kontrollit të rishitjes së kësaj kopjeje.

3. Huazimi publik nuk është një veprim nxjerrjeje ose ripërdorimi.

Neni 122

Veprimet e përsëritura e sistematike që lidhen me pjesët jothelbësore të bazave të të dhënave

Nxjerrja e përsëritur dhe sistematike dhe/ose ripërdorimi i pjesëve jothelbësore të përmbajtjes së bazës së të dhënave konsiderohen veprime që bien në kundërshtim me shfrytëzimin normal të bazës së të dhënave ose që cenojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat legjitime të prodhuesit të bazës së të dhënave dhe si të tilla nuk lejohen.

Neni 123

Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit të ligjshëm të bazave të të dhënave

1. Prodhuesi i bazës së të dhënave, që vendoset në çfarëdolloj mënyre në dispozicion të publikut, nuk mund ta ndalojë përdoruesin e ligjshëm të bazës së të dhënave që të nxjerrë dhe/ose të ripërdorë pjesë jothelbësore të përmbajtjes së saj, të vlerësuara në mënyrë cilësore dhe/ose sasiore, për çfarëdolloj qëllimi. Nëse përdoruesi i ligjshëm është i autorizuar të nxjerrë dhe/ose të ripërdorë vetëm pjesë të caktuara të bazës së të dhënave, kjo pikë gjen zbatim vetëm për ato pjesë.

2. Përdoruesi i ligjshëm i bazës së të dhënave, që i është vënë në dispozicion publikut në çfarëdolloj mënyre, nuk mund të kryejë veprime që bien në kundërshtim me shfrytëzimin normal të bazës së të dhënave apo cenojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat e ligjshëm të prodhuesit të bazës së të dhënave.

3. Përdoruesi i ligjshëm i bazës së të dhënave, që i është vënë në dispozicion publikut në çfarëdolloj mënyre, nuk mund ta cenojë mbajtësin e së drejtës së autorit apo të drejtave të lidhura në raport, sa u takon veprave ose objekteve të mbrojtura që përfshihen në bazën e të dhënave.

4. Çdo dispozitë kontraktuale, që bie në kundërshtim me këtë nen, është e pavlefshme.

Neni 124

Përgjashtime nga të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave

Përdoruesit e ligjshëm të bazës së të dhënave, që i vihet në dispozicion publikut në çfarëdolloj mënyre, mund të nxjerrin ose të ripërdorin pa autorizimin e prodhuesit të saj pjesë thelbësore të përmbajtjes së kësaj baze të dhënash:

a) në rastin e nxjerrjes së përmbajtjes së bazës joelektronike të të dhënave për qëllime vetjake, në përputhje me parashikimet e nenit 72 të këtij ligji;

b) në rastin e nxjerrjes për qëllime ilustrimi, për mësimdhënie ose kërkime shkencore, me kusht që të përmendet burimi dhe të bëhet në atë masë që e justifikon qëllimi jotregtar që duhet të arrihet, në përputhje me parashikimet e nenit 71 të këtij ligji;

c) në rastin e nxjerrjes dhe/ose ripërdorimit për qëllime të sigurisë publike ose të një procedure administrative ose gjyqësore.

Neni 125

Afati i mbrojtjes së të drejtave të prodhuesve të bazave të të dhënave

1. Të drejtat e një prodhuesi të bazës së të dhënave mbrohen që nga data e përfundimit të bërjes së bazës së të dhënave deri në përfundimin e vitit të 15-të, që llogaritet nga 1 janari i vitit pasardhës nga data e përfundimit.

2. Në rastin e bazës së të dhënave, që i vihet në dispozicion publikut në çfarëdolloj mënyre përpara përfundimit të periudhës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni, afati i mbrojtjes së të drejtës së prodhuesit të bazës së të dhënave përfundon pas 15 vjetëve, që llogariten nga 1 janari i vitit pasardhës nga data kur baza e të dhënave i është vënë për herë të parë në dispozicion publikut.

3. Çdo ndryshim thelbësor, i vlerësuar në mënyrë cilësore ose sasiore, i përmbajtjes së bazës së të dhënave, përfshirë çdo ndryshim thelbësor që rrjedh nga mbledhja e shtesave, fshirjeve ose ndryshimeve të njëpasnjëshme, që do të sillnin si rezultat një bazë të dhënash që konsiderohet si një investim thelbësor i ri, i vlerësuar në mënyrë cilësore dhe sasiore, e kualifikon bazën e të dhënave që rezulton nga ky investim për afatin e vet të mbrojtjes.

Neni 126

Përfituesit e mbrojtjes së të drejtave të prodhuesve të bazave të të dhënave

1. E drejta e parashikuar në nenin 121, të këtij ligji, gjen zbatim për bazat e të dhënave, prodhuesit ose mbajtësit e të drejtave të të cilave janë shtetas të Republikës së Shqipërisë ose kanë vendqëndrimin/rezidencën në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. E drejta e parashikuar nga neni 121, i këtij ligji, gjen zbatim edhe për subjektet tregtare, të krijuara në përputhje me legjislacionin për krijimin dhe organizimin e shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë, dhe që kanë zyrën qendrore apo vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, Kur subjekti tregtar apo shoqëria ka vetëm zyrën të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të ushtrojë veprimtari të vazhdueshme në këtë territor.

3. Marrëveshjet që e shtrijnë të drejtën e parashikuar në nenin 121, të këtij ligji, te bazat e të dhënave të krijuara në vendet e treta dhe që nuk janë objekt i dispozitave të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mbrohen në bazë të një traktati ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është palë.

4. Afati i çdo mbrojtjeje, që përfshin bazat e të dhënave, të krijuara në vendet e treta, nuk e tejkalon atë që parashikohet në nenin 115 të këtij ligji.

PJESA V

ADMINISTRIMI I TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE I TË DREJTAVE TË LIDHURA

Dispozita të përgjithshme

Neni 127

Administrimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to

1. Të drejtat e autorit mund të administrohen veçmas në mënyrë individuale për çdo veprë të autorit ose, sipas parashikimit të këtij ligji, mund të administrohen bashkërisht në mënyrë kolektive, nëpërmjet agjencive të administrimit kolektiv, për një numër veprash të disa autorëve në të njëjtën kohë.

2. Parashikimet e kësaj pjese për të drejtat e autorit zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për të drejtat e lidhura.

Neni 128

Veprimtaritë e administrimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura

1. Administrimi i të drejtave të autorit dhe i të drejtave të lidhura përfshin detyrat e mëposhtme:

a) dhënien e autorizimit për përdorim të objektit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura, objekt i mbrojtjes, kur ky autorizim është i parashikuar me ligj;

b) mbledhjen e shpërblimeve për përdorim të objektit të mbrojtjes;

c) shpërndarjen e shpërblimeve të mbledhura të mbajtësit të së drejtës;

ç) kontrollin e përdorimit të objektit të mbrojtjes;

d) nisjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të mbrojtjes në rastet e shkeljes së të drejtave të administruara.

2. Administrimi i të drejtave mund të përfshijë të gjitha ose disa nga veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 129

Administrimi individual i të drejtave

1. Administrimi i të drejtave që lidhen me përdorimin e një materiali të posaçëm, objekt i mbrojtjes, kryhet nga vetë mbajtësi i së drejtës ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, sipas kontratës së lidhur midis mbajtësit dhe përdoruesit.

2. Detyrat e një përfaqësuesi të autorizuar mund të kryhen nga një përfaqësues ligjor, si edhe nga agjencitë e administrimit kolektiv.

Neni 130

Administrimi kolektiv i të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit mund të përfshijë:

a) të drejtën e shfaqjeve publike, të drejtën e përcjelljes në publik, të drejtën e përcjelljes në publik të një vepre të fiksuara, të drejtën e transmetimit, të drejtën e ritransmetimit, të drejtën e përcjelljes në publik të transmetimit dhe të drejtën për të vënë në dispozicion të publikut veprat joskenike, muzikore dhe letrare;

b) të drejtën e riprodhimit (regjistrimi audio) të veprave muzikore;

c) të drejtën e shpërndarjes, përfshirë të drejtën për qira dhe të drejtën e shpërblimit, sipas parashikimeve të këtij ligji;

ç) të drejtën e shpërblimit për huadhënie publike;

d) të drejtën e rishitjes, kur veprat origjinale të artit janë duke u rishitur;

dh) të drejtën për shpërblim për riprodhimin e veprës për qëllime private ose përdorimi personal;

e) të drejtën për shpërblim, referuar nenit 76 të këtij ligji;

ë) të drejtën për shpërblim për përcjelljen te publiku për literaturën folklorike dhe veprat artistike;

f) të drejtën e ritransmetimit të veprave audiovizuale.

2. Administrimi kolektiv i të drejtave të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve mund të përfshijë:

a) të drejtën për përcjelljen në publik të veprave të fiksuara dhe transmetimet e fonogrameve e të videogrameve;

b) të drejtën e paraqitjes publike të një shfaqjeje të fiksuara;

c) të drejtën e transmetimit dhe ritransmetimit të një shfaqjeje të fiksuara;

ç) të drejtën e vënies në dispozicion të publikut të një shfaqjeje të fiksuara;

d) të drejtën e qirasë së shfaqjes së fiksuara dhe të drejtën për shpërblim, referuar pikës 2, të nenit 28, të këtij ligji;

dh) të drejtën për shpërblim për huazim publik të shfaqjes së fiksuara;

e) të drejtën për shpërblim të riprodhimit të shfaqjes së fiksuara për qëllime private dhe përdorim personal;

ë) të drejtën për shpërblim suplementar vjetor, të referuar në nenin 115 të këtij ligji.

3. Administrimi kolektiv i të drejtave të prodhuesve të fonogramit mund të përfshijë:

a) të drejtën për të vënë fonogramin në dispozicion të publikut;

b) të drejtën për shpërblim për transmetimin dhe përcjelljen në publik të fonogramit;

c) të drejtën e qirasë së fonogramit;

ç) të drejtën për huazim publik të fonogramit;

d) të drejtën e shpërblimit për riprodhim të fonogramit për qëllime private ose përdorim personal.

4. Administrimi kolektiv i të drejtave të prodhuesve (producentëve) të filmave mund të përfshijë:

- a) të drejtën për shpërblim për huazim publik të videogrameve;
- b) të drejtën për shpërblim për riprodhimin e një videogrami për qëllime private ose përdorim personal.

5. Administrimi kolektiv i të drejtave të botuesve mund të përfshijë të drejtën për shpërblim për riprodhimin e botimeve të tyre, të shkruara për qëllime private ose përdorim personal.

Neni 131

Administrimi kolektiv i detyrueshëm

1. Në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji, të drejtat në vijim ushtrohen nëpërmjet administrimit kolektiv në mënyrë të detyrueshme, të drejta si:

a) e drejta e transmetimit dhe ritransmetimit për autorët dhe interpretuesit, referuar përcaktimit në pikat 1, shkronja “a”, dhe 2, shkronja “c”, të nenit 130, të këtij ligji;

b) e drejta e ritransmetimit, e përmendur në shkronjën “f”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji;

c) e drejta për shpërblim për transmetim për prodhuesit e fonogrameve, referuar përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 130, të këtij ligji;

ç) e drejta e qiradhënies për autorët dhe për veprat/regjistrimet muzikore, për interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve, referuar në pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “d”, dhe 3, shkronja “c”, të nenit 130, të këtij ligji;

d) e drejta e shpërblimit për huadhënien publike për autorët, interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve, referuar në pikat 1, shkronja “ç”, 2, shkronja “dh”, 3, shkronja “ç”, dhe 4, shkronja “a”, të nenit 130, të këtij ligji;

dh) e drejta për shpërblim për riprodhimin e kopjeve private dhe përdorimit tjetër personal për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit (producentët) e filmave dhe botuesve, referuar në pikat 1, shkronja “dh”, 2, shkronja “e”, 3, shkronja “d”, 4, shkronja “b”, dhe 5, të nenit 130, të këtij ligji;

e) e drejta për një shpërblim, e përmendur në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 130, të këtij ligji;

ë) e drejta e rishitjes së origjinaleve të veprave të artit, referuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

2. Dispozitat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk do të zbatohen për ritransmetim kabllor, kur ajo ka të bëjë me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, në lidhje me transmetimet e veta, pavarësisht nëse të drejtat në fjalë janë të vetat ose i janë transferuar asaj nga mbajtësit e tjerë të së drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

Neni 132

Kontrata me autorin

1. Agjencia e administrimit kolektiv do të administrojë të drejtat e autorëve vetëm në bazë të një kontrate të lidhur me autorin. Kontrata do të përfshijë, në veçanti, autorizimin e autorit për administrimin e të drejtave të tij, llojin e veprave dhe të drejtave për t’u administruar dhe kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të kalojë tre vite, e rinovueshme. Drejtoria për të Drejtat e Autorit do të mbikëqyrë dhe do të kontrollojë këtë veprimtari, si organi garant i zbatimit të këtij ligji.

2. Një agjenci e administrimit kolektiv duhet të informojë paraprakisht mbajtësit e të drejtave të përcaktuara në këtë ligj për të drejtat e tyre që ato administrojnë në zbatim të nenit

137, shkronja “a”, të këtij ligji. Agjencia duhet të informojë edhe ata mbajtës të të drejtave që e kanë autorizuar tashmë atë për administrimin e të drejtave të tyre, që gëzojnë në bazë të këtij ligji, brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Agjencitë e administrimit kolektiv, në bazë të kontratës me autorin, me kërkesë, mund të autorizojnë përdorimin e veprave të përdoruesit.

4. Në periudhën kohore kur administrimi i të drejtave është transferuar në agjencinë e administrimit kolektiv, qoftë me ligj ose me kontratë, autori nuk mund të administrojë në mënyrë individuale këto të drejta.

Neni 133

Agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave mund të kryhet nga agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave, (në vijim AAK), si subjekt juridik, i krijuar nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, e cila ka marrë licencimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit (në vijim DDA).

2. Licencimi, referuar në pikën 1, të këtij neni, do t'i akordohet subjektit, i cili gëzon këto karakteristika:

a) regjistrohet si organizatë jofitimprurëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

b) ka miratuar statutin e saj, që plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe që duhet të përfshijë në mënyrë specifike:

i) emërtimin e agjencisë së administrimit kolektiv, objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që agjencia përfaqëson, kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese, kapitalin e saj fillestar dhe burimet e planifikuara ekonomike, rregullat e përcaktuara për realizimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave, mënyrën e mbikëqyrjes së administrimit ekonomiko-financiar të agjencisë, ngritjen e komisionit të posaçëm, në kuptim të nenit 153, pika 6, të këtij ligji, mënyrën e përdorimit të kapitalit ose asetëve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë, rregullat për modalitetet e hartimit të metodologjisë që duhet të negociohet me përdoruesit dhe rregullat e përfaqësimit në negociata, si dhe çdo dispozitë tjetër që është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi;

ii) dispozitat statutores të agjencive të administrimit kolektiv duhet të marrin parasysh parimin e transparencës, parimin e konfliktit të interesit në organet e tyre drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit midis anëtarëve, anëtarëve dhe joanëtarëve, si dhe midis përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to;

iii) asambleja e përgjithshme e anëtarëve të agjencisë duhet të mbledhet të paktën një herë në vit; vendos për ndryshimet në statutin e agjencisë për emërimin ose shkarkimin e organeve ekzekutive, rishikon performancën e tyre të përgjithshme dhe miraton shpërblimin e tyre, si dhe përfitimet e tjera, të tilla si përfitimet monetare dhe jomonetare, dhënie pensionesh apo titujsh, të drejta dhe shpërblime të tjera ose të drejtat për pagesa kalimtare; vendos të paktën për politikën e përgjithshme për shpërndarjen e shpërblimeve ndaj mbajtësve të të drejtave dhe shpenzimeve të administrimit të të drejtave, si dhe miratimin e çdo blerjeje, shitjeje ose hipoteke të pasurisë së paluajtshme;

c) ka selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë;

ç) ka hapësirën dhe logjistikën e përshtatshme dhe mekanizma të mjaftueshëm për mbledhjen, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimit, shërbimin teknik, ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe një punonjës financiar;

d) administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;

dh) paraqet mekanizma, të cilët garantojnë trajtim të barabartë si për mbajtësit e të drejtave, ashtu edhe për përdoruesit, kur kushtet objektive të trajtimit janë të njëjta.

3. AAK-ja administron të drejtat në emër dhe për llogari të mbajtësve të këtyre të drejtave.

4. Çdo propozim për ndryshimin e statutit është objekt i miratimit nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit, sipas propozimit të Drejtorisë për të Drejtën e Autorit. DDA-ja, shqyrton, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, propozimin për ndryshim të statutit të agjencisë. Miratimi ose refuzimi i propozimit duhet të jetë i argumentuar dhe të shprehet në lidhje me përputhshmërinë e ndryshimeve të statutit me ushtrimin e tagrave të licencës, objekt veprimtarie dhe pastaj miratimi i paraqitet gjykatës së rrethit gjyqësor, me qëllim për regjistrimin e ndryshimit. Çdo ndryshim i statutit, i kryer në kundërshtim me parashikimet e kësaj pike, përbën kusht për heqjen e licencës së agjencisë së administrimit kolektiv.

Neni 134

Vlefshmëria e licencës

1. Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë është e vlefshme për 3 vjet, e rinovueshme.

2. Procedura e marrjes së licencës apo ripërtëritjes së saj i nënshtrohet të njëjtave kritere të parashikuara në këtë ligj apo në akte të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe kryhet nëpërmjet një procesi publik, i cili siguron zbatimin e parimeve të transparencës dhe të konkurrueshmërisë.

Neni 135

Përfaqësimi për administrimin e të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave të përmendura në nenet 130 dhe 131, të këtij ligji, në lidhje me të njëjtën kategori të mbajtësve të së drejtës, i jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit vetëm një subjekti (AAK), i cili:

a) ka marrë pëlqimin për kryerjen e administrimit të të drejtave nga ana e shumicës së mbajtësve të të drejtave të kësaj kategorie, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre;

b) ka numrin më të madh të kontratave të lidhura me agjencitë reciproke të huaja, në përputhje me kriteret profesionale të përmendura në këtë ligj.

2. Prezumohet se agjencia e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ka kompetencat e përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të së drejtës, vendas dhe të huaj, për të drejtat përkatëse respektive. Mbajtësit e të drejtave do të kenë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre për një AAK, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre për të mos u administruar nga AAK-ja, në përputhje me nenin 132, të këtij ligji, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. AAK-ja mund të vendosë që një zgjidhje ose tërheqje e tillë të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit financiar.

3. Agjencia, në vijim të kërkesës së përdoruesit, informon këtë të fundit për ata mbajtës të të drejtave, të cilët ia kanë hequr të drejtën e administrimit, sipas procedurave të pikës 2 të këtij neni.

4. Çdo autor/mbajtës i të drejtave të autorit ose i të drejtave të lidhura me to mund t'i besojë me mandatin e administrimit të të drejtave të tij një agjencie të administrimit kolektiv, e cila nuk mund të refuzojë dhe është e detyruar të pranojë administrimin e këtyre të drejtave, në bazë të administrimit kolektiv, brenda kufirit të objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 136

Administrimi i të drejtave përmes agjencie

1. Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave mund të administrojë një, dy ose më shumë lloje të drejtash që zakonisht lidhen me një kategori të veçantë të mbajtësve të të drejtave të autorit ose të të drejtave të lidhura me to.

2. Agjencia mund të kalojë një ose disa funksione, në lidhje me administrimin e të drejtave pranë ndonjë agjencie tjetër të administrimit kolektiv, sipas këtij ligji, me anë të një marrëveshjeje me shkrim, të miratuar paraprakisht nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.

3. Agjencia, së cilës i kalojnë funksionet e përmendura më sipër, ushtron këto funksione në emër dhe për llogari të agjencisë që i ka transferuar ose në emër të vet dhe për llogari të agjencisë që i ka kaluar këto të drejta, sipas mënyrës së përcaktuar në marrëveshjen midis tyre.

Neni 137

Funksionet, të drejtat dhe detyrimet e agjencie të administrimit kolektiv

AAK-të, për llogari të mbajtësve të të drejtave dhe në bazë të kompetencave që u janë dhënë dhe sa parashikohet në këtë ligj, kanë këto funksione:

a) t'u japin përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;

b) të mbledhin shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura;

c) të shpërndajnë, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura. Parimet e shpërndarjes së shpërblimit përcaktohen në statutin e agjencisë dhe do të përjashtohet çdo mundësi arbitrari;

ç) të përfaqësojnë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato;

d) të kryejnë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjorë dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;

dh) të hartojnë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) të realizojnë në emër të autorit ose të mbajtësit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit

mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administrojnë;

ë) të përfaqësojnë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;

f) të informojnë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;

g) të sigurojnë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;

gj) për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, këto agjenci detyrohen të mbajnë dhe të paguajnë për llogari të administratës tatimore tatimin në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;

h) për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, kanë detyrimin të vënë në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave.

Neni 138

Agjencia unike për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve (Sporteli unik)

1. Me anë të një marrëveshjeje me shkrim AAK-të bien dakord dhe vendosin cilës prej tyre do t'i transferohet funksioni i mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave.

2. Nëse ato nuk arrijnë marrëveshjen e sipërpërmendur, brenda afatit 30-ditor nga hyrja në fuqi e tarifave të shpërblimit, këtë vendimmarrje e realizon Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit (në vijim KKDA), për një nga agjencitë e licencuara, në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) të ketë kapacitetin administrativ për mbulimin e territorit;

b) të zbatojë me përpikëri dispozitat për procedurën e mbledhjes së shpërblimeve, sipas këtij ligji;

c) të ketë kohëzgjatje të aktivitetit të subjektit ndër vite;

ç) të ketë kontrata të përfaqësimit të ndërsjellë me agjenci homologe dhe njohje ndërkombëtare;

d) të zotërojë infrastrukturën më të përshtatshme, e cila garanton respektimin e transparencës në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave për anëtarët e saj;

dh) të ketë pasuritë e platformës më të përshtatshme dhe me koston më efektive për administrimin e të drejtave.

3. Marrëveshja e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ose vendimi i KKDA-së, i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të përmbajë detyrimisht mënyrën dhe përqindjen e ndarjes së tarifës dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve, si më poshtë:

a) 40 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të autorit;

b) 30 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të interpretuesve;

c) 30 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të prodhuesve, përfshirë botuesit dhe prodhuesit e fonogrameve.

Neni 139

Rasti i veçantë i shpërndarjes

1. Në shpërblimet e mbledhura sipas nenit 31, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij ligji, për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, autorët do të marrin 40 për qind, interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit 30 për qind, dhe prodhuesit e fonogrameve ose prodhuesit e filmit 30 për qind.

2. Nga shpërblimet e mbledhura sipas nenit 31, pika 5, shkronja “c”, dhe pika 6, të këtij ligji, autorët dhe botuesit do të marrin 50 për qind secili.

Neni 140

Dhënia e autorizimit për përdorim

1. Një person fizik ose juridik, para se të fillojë të përdorë një objekt të mbrojtur nga të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, duhet të paraqesë në AAK-në përkatëse kërkesën për autorizimin e këtij përdorimi. Kërkesa duhet të përmbajë informacion për llojin dhe rrethanat e përdorimit, si mënyrën, vendin dhe kohën e përdorimit dhe informacione të tjera të nevojshme për përcaktimin e shumës së shpërblimit.

2. AAK-ja i jep përdoruesit autorizimin për shfrytëzimin e objektit të mbrojtjes brenda kompetencave të saj. Në autorizim përfshihen tregues të llojeve të të drejtave, për të cilat ai zbatohet, kushtet e përdorimit për sa i përket mënyrës, vendit, kohës dhe masës së shpërblimit për shfrytëzim, ku përdorimi i nënshtrohet pagesës së shpërblimit.

3. Përdoruesi i paraqet AAK-së, pa vonesë, informacion në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave të përdorimit ose të përfundimit të tij, në mënyrë që të ndryshohen kushtet, në të cilat është dhënë autorizimi ose për ta tërhequr atë.

Neni 141

Detyrimi për dhënie informacioni

Në rast të informacionit të pamjaftueshëm për një përdorim të paautorizuar të materialit, objekt mbrojtjeje, me anë të një kërkesë, AAK-të do t'u drejtohen organeve kompetente të administratës shtetërore ose personave të tjerë juridikë, të cilët janë të detyruar të përmbushin kërkesën për t'i dorëzuar informacionin përkatës nga të dhënat e tyre, për sa e lejon legjislacioni i posaçëm në fuqi. Mospërmbushja e këtij detyrimi sjell përgjegjësi ligjore.

Neni 142

Procedurat e miratimit të tarifave të shpërblimit

1. Në procedurën e miratimit të tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet vlera/tarifa dhe metodologjia për përcaktimin e tyre, për t'u paguar nga çdo përdorues kundrejt AAK-së, për përdorimin e veprës/ve të autorit që ato administrojnë.

2. Tarifa vendoset me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse (në vijim Marrëveshja) e lidhur ndërmjet AAK-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve ose, nëse kjo nuk është e mundur, me vendim të KKDA-së. Deri në hyrjen në fuqi të tarifave të reja, gjejnë zbatim tarifat e miratuara më parë. Kur nuk ka tarifa të miratuara më parë, për aq kohë sa

tarifat e reja nuk janë miratuar, përdoruesit i paguajnë agjencisë së administrimit kolektiv një tarifë provizore/të përkohshme, të barabartë me 60 për qind të vlerës së projekttarifave të paraqitura. AAK-ja e publikon tarifën e përkohshme në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe në aktet e tjera të publikimeve zyrtare.

3. Kur në bazë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës, vlera e tarifave përcaktohet më e ulët sesa 60 për qind e vlerës së projekttarifave, agjencia e administrimit kolektiv u kthen diferencën atyre përdoruesve, nga të cilët e ka mbledhur këtë shpërblim, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

4. Në caktimin e metodologjisë së tarifave merren parasysh:

a) të ardhurat që mund të sigurohen si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të lidhura;

b) numri i publikut, të cilit i vihen në dispozicion veprat ose objektet e të drejtave të lidhura;

c) kur të ardhurat nuk pasqyrojnë natyrën e përdorimit të veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, tarifat llogariten në bazë të kostove që lindin për përdorimin e tyre ose në bazë të ndikimit që kanë në shfrytëzimin normal nga mbajtësit e të drejtave;

ç) rëndësia e përdorimit të veprave dhe objekteve të të drejtave të lidhura për veprimtaritë përkatëse të përdoruesve;

d) raporti i përdorimit midis veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, të mbrojtura dhe jo të mbrojtura;

dh) krahasueshmëria e tarifave të propozuara me tarifat e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera, veçanërisht me ato vende, të cilat kanë standard të përafërt zhvillimi ekonomiko-social me Republikën e Shqipërisë.

5. Tarifat e zbatuara për ritransmetimin kabllor pasqyrojnë, gjithashtu, numrin e përdoruesve familjarë që janë të lidhur në sistemet kabllore dhe natyrën e programeve të ritransmetuara.

6. Në përlllogaritjen e tarifave mbahet parasysh burimi i të ardhurave në formatin e subvencionit, abonimit dhe sponsorizimit, e përshkallëzuar, në masë më të ulët, në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga subvencionet për mbulimin e kostove operative, në masë më të rritur, në rastin e të ardhurave nga shërbimet e abonimit dhe në masa më të larta, në rastin e të ardhurave të marra nga reklamuesit dhe sponsorët tregtarë.

Neni 143

Marrëveshja gjithëpërfshirëse

1. AAK-ja duhet të përfundojë një marrëveshje me shkrim me përfaqësuesit e shoqatës së përdoruesve të veprave të autorëve mbi repertorin e veprave të tyre. Shoqata përfaqësuese janë ato shoqata të përdoruesve, të cilat përfaqësojnë shumicën e përdoruesve në një fushë të caktuar të aktivitetit, në lidhje me numrin e tyre ose ato shoqata të deklaruara përfaqësuese me ndonjë akt tjetër me fuqi juridike në Republikën e Shqipërisë.

2. Një marrëveshje gjithashtu mund të lidhet ndërmjet një AAK-je dhe një përdoruesi individual të veprave të autorëve mbi repertorin e veprave të saj, kur, për shkak të natyrës së aktivitetit të tij, ky përdorues është i vetmi në kryerjen e kësaj veprimtarie. Dispozitat e aplikuara për shoqatat përfaqësuese të përdoruesve do të zbatohen gjithashtu me ndryshimet e nevojshme për një përdorues individual, sipas kësaj pike.

3. Me një marrëveshje të tillë rregullohen:

a) tarifa dhe metodologjia për përcaktimin e tarifave;

b) kushtet dhe mënyra e përdorimit të veprave të autorit;

c) kushtet e përdorimit për kategoritë që përfitojnë një rritje, ulje ose përjashtimin nga pagesa e shpërblimit;

ç) data për pagesën e shpërblimit të autorit dhe informacionet e tjera të nevojshme për përcaktimin e shumës së shpërblimit;

d) mënyra e pagesës së shpërblimit dhe elemente të tjera në lidhje me tarifat e përkohshme, në bazë të nenit 142, të këtij ligji, për përdorimin e veprave të autorëve deri në përfundim të një marrëveshjeje, nëse tarifat për një kategori të caktuar të përdorimit të veprave të autorëve po caktohen për herë të parë nga kjo marrëveshje.

4. Marrëveshja hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe zbatohet për të gjithë përdoruesit e së njëjtës kategori të veprave të autorëve nga repertori i AAK-së, pavarësisht nëse ata morën pjesë në negociata ose në përfundimin e kësaj marrëveshjeje.

Përdoruesit e veprave të autorëve nga repertori i AAK-së janë të detyruar të lidhin një kontratë me AAK-në, në përputhje me këtë marrëveshje.

5. Ndaj kësaj marrëveshjeje nuk lejohet ankim në gjykatë përpara shterimit të procedurës administrative para KKDA-së.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen me ndryshimet e nevojshme për amendimin ose përfundimin e marrëveshjes.

7. AAK-ja duhet të publikojë një ftesë fillestare, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të vitit kalendarik, për të negociuar kushtet për përfundimin e marrëveshjes në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe në aktet e tjera të publikimeve zyrtare.

Neni 144

Procedura përpara KKDA-së

1. Një AAK ose një shoqatë përfaqësuese e përdoruesve, 30 ditë pas publikimit të tarifave të përkohshme, të përmendura në nenin 142, të këtij ligji, ose kur ata nuk e kanë përfunduar një marrëveshje brenda një muaji nga fillimi i negociatave mes tyre, i kërkon KKDA-së për të caktuar/vendosur një tarifë të përshtatshme ose për të vendosur për çdo çështje tjetër në lidhje me marrëveshjen gjithëpërfshirëse. Kohëzgjatja e procedurës përpara KKDA-së do të jetë 45 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Kushdo, që vërteton një interes të ligjshëm, mund të kërkojë që KKDA-ja të shprehet nëse një marrëveshje është në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe nëse tarifa e caktuar nga marrëveshja është e përshtatshme, përveçse nëse KKDA-ja ka vendosur tashmë për këtë çështje.

3. Procedura përpara KKDA-së iniciohet nga një kërkesë me shkrim që duhet të përfshijë të paktën: të dhënat e aplikantit, shpjegime mbi çështjen, raportin mbi rrjedhën e negociatave për lidhjen e marrëveshjes së kryer deri tani, duke përfshirë edhe të dhëna të tjera rreth saj, propozimin e një tarife që do të vendoset nga KKDA-ja ose propozimin për zgjidhje për ndonjë çështje tjetër.

4. KKDA-ja ia dërgon kërkesën e përmendur në pikën 3, të këtij neni, palës tjetër ose në rastin e pikës 2, të këtij neni, tek AAK-ja dhe shoqatës së përfaqësuesve të përdoruesve, të cilët kanë përfunduar marrëveshjen e kontestuar dhe i fton ata që të deklarojnë opinionin e tyre në lidhje me kërkesën.

5. Çdo palë deklaron faktet dhe paraqet prova, mbi të cilat ajo bazon propozimet e saj, ose me të cilat ajo kundërshton pretendimet dhe provat e palës tjetër.

6. KKDA-ja, në çdo kohë, mund t'u kërkojë palëve të paraqesin materiale shtesë dhe çdo informacion që ata e konsiderojnë se mund të lehtësojë procesin, veçanërisht për të përgatitur raporte dhe të paraqesin opinionet e ekspertëve, si dhe çdo informacion tjetër të tillë. Duke

pasur parasysh të gjitha rrethanat, KKDA-ja do të përcaktojë në vendimin përfundimtar edhe faktin nëse ndonjë nga palët nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 5, të këtij neni, ose të kësaj pike.

7. Negocimi i tarifave midis agjencive dhe shoqatave të përfaqësuesve të përdoruesve të veprave/subjekteve të interesuara është i detyrueshëm për t'u shteruar përpara ndjekjes së procesit në rrugë gjyqësore.

Neni 145

Vendimi i KKDA-së

1. Me vendimin e saj KKDA-ja cakton një tarifë të përshtatshme ose vendos për çështje të tjera, përmes të cilit KKDA-ja mund të miratojë, të ndryshojë apo të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një marrëveshje të kontestuar/kundërshtuar.

2. Kur e konsideron të nevojshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, KKDA-ja mund të miratojë, gjatë procedurës dhe me propozimin e palës, një vendim për caktimin e tarifës për kohëzgjatjen e procedurës para KKDA-së. Vendimi lëshohet në bazë të informacionit ekzistues gjatë vendimmarrjes dhe do të jetë në fuqi derisa të jepet vendimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni. Vendimi, sipas kësaj pike, nuk i nënshtrohet ankimit.

3. KKDA-ja vendos ndryshimin ose anulimin e marrëveshjes së kontestuar.

4. Vendimi përfundimtar i KKDA-së publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe në aktet e tjera të publikimeve zyrtare.

Neni 146

Shpenzimet e procedurës para KKDA-së

1. Shpenzimet e procedurës para KKDA-së përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit.

2. Secila palë mbulon shpenzimet e veta që rrjedhin nga procedurat para KKDA-së.

3. Të dyja palët mbulojnë në pjesë të barabarta shpenzimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe çdo kosto administrative.

4. Pala, që inicion procedurën, parapaguan sasinë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet operative të procedurës para KKDA-së, përndryshe, KKDA-ja do të refuzojë propozimin për fillimin e procedurës.

5. Dispozitat e pikës 4, të këtij neni, zbatohen me ndryshimet e nevojshme për të gjithë ata që kërkojnë të propozojnë ndonjë veprim brenda procedurës para KKDA-së.

6. KKDA-ja vendos me një vendim të veçantë për shpenzimet edhe nëse ndonjë palë duhet të paguajë palën tjetër për pjesën e duhur të shpenzimeve të parapaguara.

Neni 147

Ankimi kundër vendimit të KKDA-së

1. Kundër vendimit të KKDA-së, palët kanë të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente në afatet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Afati i ankimit llogaritet nga data e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Kulturës. Ankimi kundër këtij vendimi nuk pezullon zbatimin e tarifave, objekt i mosmarrëveshjes.

2. Në rast se e drejta e ankimit, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nuk ushtrohet brenda afatit të mësipërm, tarifat konsiderohen të miratuara, sipas vendimit të KKDA-së. Me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit, tarifat sipas vendimit të KKDA-së, dhe metodologjia përkatëse dërgohen për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike. Tarifat e miratuara mbeten në fuqi për 2 vjet.

3. Procedura gjyqësore, sipas këtij neni, rregullohet me ndryshimet e nevojshme, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

Neni 148

Detyrimi për të lidhur kontratë

Përdoruesi i veprave nga repertori i një AAK-je mund të kërkojë, në çdo kohë, përfundimin e një kontrate në formën joekskluzive të të drejtave për përdorimin e veprave të autorit, në përputhje me tarifën e miratuar. AAK-ja mund të refuzojë një kërkesë të tillë nëse ky përdorues më parë nuk ka paguar shpërblimin nga përdorimi i veprave. Kjo kontratë depozitohet dhe regjistrohet në Drejtorinë për të Drejtat e Autorit.

Neni 149

Parimet për krijimin e masës së shpërblimit nga tarifat

1. Në qoftë se përdorimi i objektit të mbrojtjes është i domosdoshëm për aktivitetin e një përdoruesi dhe kur aktiviteti i tij varet nga ky përdorim, si në rastet e transmetimeve, koncerteve, valleve ose përdorimeve të tjera të objektit kundrejt pagesës, shuma e shpërblimeve do të jetë fikse në parim, si përqindje e të ardhurave ose fitimit nga një përdorim i tillë.

2. Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes rezulton pa të ardhura ose fitim, shuma e pagesave mund të jetë fikse, si përqindje e shpenzimeve të përdorimit, të tilla si shpërblimet ose pagat e interpretuesve apo shpenzimet e bëra për përdorimin, shfrytëzimin e lokaleve ose shpenzime të tjera.

3. Përveç shpërblimeve fikse, si përqindje, shuma minimale e shpërblimeve specifikohet.

4. Nëse një përdorues nuk dorëzon tek AAK-ja informacion të nevojshëm për përcaktimin e shpërblimit si përqindje, AAK-ja mund të vendosë sasinë e shpërblimeve, në bazë të informacionit të mbledhur, në përputhje me nenin 141 këtij ligji.

5. Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hoteleri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore.

6. Në rastin e një vendimmarrjeje për shumën totale dhe shpërblimet e përmendura në pikën 3, të këtij neni, rrethanat e përdorimit të objektit të mbrojtjes, që merren në konsideratë, do të jenë tipi i përdorimit, vendi dhe vendndodhja gjeografike, kategoria dhe madhësia e objekteve, kohëzgjatja dhe numri i përdorimit dhe diferenca e çmimeve në lidhje me biznesin e një përdoruesi.

Neni 150

Shpërndarja e tarifave të shpërblimit

1. Përdoruesi i paraqet AAK-së informacion të plotë, në lidhje me vendin dhe kohën e përdorimit të një objekti të mbrojtjes, për qëllime të shpërndarjes së shpërblimeve të grumbulluara. Ky informacion jepet:

- a) paraprakisht;
- b) deri në 15 ditë pas përdorimit;
- c) sipas kontratës.

2. Në rast se shpërndarja nuk është e mundur, në bazë të informacionit për përdorimin ose në qoftë se kjo shpërndarje rezulton dukshëm joekonomike, ajo mund të kryhet nga aplikimi i metodave statistikore që korrespondon me masën më të madhe të përdorimit aktual.

3. Shpërndarja e shpërblimeve të grumbulluara për mbajtësit e të drejtave kryhet në përputhje me informacionin mbi përdorimin e objektit të mbrojtjes.

Neni 151

Rregulla në lidhje me shpërndarjen e shpërblimeve

1. AAK-ja duhet të parashikojë rregulla në lidhje me metodologjinë e shpërndarjes së shpërblimeve të grumbulluara, siç janë miratuar nga organi i saj vendimmarrës.

2. Në këto rregulla duhet të mbahen parasysh:

a) objekti i mbrojtjes dhe mbajtësit e të drejtave, për të cilat zbatohen këto rregulla;

b) përcaktimi i kriterëve dhe procedurës së shpërblimeve, me qëllim stimulimin e mbajtësve të të drejtave, veprat e të cilëve përfaqësojnë një vlerë të veçantë për kulturën dhe krijimtarinë kombëtare, paraprakisht të miratuara nga KKDA-ja;

c) përcaktimi i shumave që duhet të paguhet pas zbritjes së kostos për administrimin e së drejtës, ndarja e fondeve të parashikuara nga ligji, nga statuti i AAK-së ose nga kontratat ndërkombëtare për përfaqësimin e përbashkët të AAK-ve;

ç) kushtet për llogaritjen dhe pagesën e shpërblimeve të shpërndara.

3. Shpërblimet e mbledhura përdoren në përputhje me rregullat e referuara në pikën 2, të këtij neni, dhe parashikimet e këtij ligji.

4. Kontratat për shpërndarjen, të lidhura midis mbajtësve të së drejtës për të njëjtën vepër, konsiderohen shkelje të rregullave të shpërndarjes.

5. Shpenzimet totale të një AAK-je nuk mund të përbëjnë më shumë se 30 për qind të shpërblimeve të shpërndara. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të një shoqate apo çdo forme tjetër juridike OJF-je do të përfshijë edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administrimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të. Përveç shpenzimeve të tilla të bëra, organet e agjencisë mund të vendosin për të shpenzuar maksimumi 3 për qind të shumës totale të shpërblimeve të grumbulluara mbi masat kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe për masat e tjera që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të vlerës së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

6. Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve bëhen të paktën një herë në vit.

7. Bilancet e ushtrimit financiar, në lidhje me shpërndarjen, përcaktohen nga një organ kompetent i agjencisë dhe duhet të jenë të audituara e të vlerësuara nga një ekspert auditi.

8. AAK-ja, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së raportit të auditimit, do t'i dorëzojë DDA-së deklaratën e saj të llogarisë, në lidhje me shpërndarjen, referuar pikës 7 të këtij neni.

9. Tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AAK-ja, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për një periudhë 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe, nëse AAK-ja identifikon mbajtësin e së drejtës, siguron shpërndarjen dhe përfiton

edhe tarifën e administrimit. Në rast se mbajtësi nuk identifikohet për një periudhë trevjeçare, fondi special i kalon ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, e cila do ta përdorë në përmbushje të objektivave të saj për rritjen e krijimtarisë dhe diversitetin kulturor.

10. Një kopje e bilanceve të miratuara dhe të audituara, në përputhje me pikat 7 dhe 8, të këtij neni, depozitohen pranë administratës tatimore sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 152

Mbikëqyrja e përdorimit të objektit të mbrojtjes

1. Një agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave mund të mbikëqyrë përdorimin e objektit të mbrojtjes, për të cilën ajo është licencuar.

2. Përdoruesit e objektit të mbrojtjes duhet të vënë në dispozicion të AAK-së, me kërkesën e saj, dokumentacionin dhe informacionin përkatës për administrimin e të drejtave, për të bërë të mundur nga kjo e fundit kryerjen e funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

3. Me kërkesë të AAK-së, organet e administratës shtetërore përgjegjëse për inspektimin dhe shërbimet doganore, si dhe administrata kompetente e policisë dhe komisariatet e policisë duhet të sigurojnë ndihmë për agjencinë e administrimit kolektiv të të drejtave në ushtrimin e mbikëqyrjes, referuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Organizatorët e shfaqjeve publike dhe përdoruesit e tjerë të veprave të mbrojtura nga ky ligj duhet të sigurojnë të drejtat e komunikimit në publik, në rastet kur një autorizim kërkohet, sipas këtij ligji, përpara një shfrytëzimi të tillë. Me kërkesë të autorit ose të një agjencie të administrimit kolektiv, autoritetet kompetente të inspektimit ose policisë do të ndalojnë një shfaqje, në të cilën është përdorur objekti i mbrojtjes, në qoftë se organizatori i saj nuk e ka autorizimin përkatës.

Neni 153

Detyrimi i agjencive për publikimin e informacionit

1. Agjencitë e administrimit kolektiv kanë detyrimin për të publikuar, në format elektronik, në faqen e tyre të internetit, informacionin e përditësuar si më poshtë:

a) statutin;

b) listën e anëtarëve të organeve qendrore dhe vendore të administrimit, përbërjen e komisioneve të brendshme dhe listën e administratorëve lokalë;

c) deklaratën vjetore në lidhje me bilancin e shumave jo të shpërndara, shumat e mbledhura nga kategoritë e përdoruesve ose pagesve, shumat e mbajtura në burim, koston e administrimit dhe shumat e shpërndara nga kategoritë e pronarëve/autorëve;

ç) raportin vjetor;

d) informacion për asamblenë e përgjithshme, për shembull: datën, vendin e thirrjen, agjendën, projektvendimet dhe vendimet e miratuara;

dh) të dhëna të tjera të nevojshme për anëtarët, për qëllime informimi.

2. Çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë, personalisht ose nga përfaqësuesi i autorizuar, informacion të detajuar dhe dokumentet për shumat e shpërndara në të në 12 muajt e fundit, burimin e tyre, mënyrën e llogaritjes së të drejtave dhe verifikimin me dispozitat e rregullores së shpërndarjes.

3. Në një periudhë kohore prej 30 ditësh para mbledhjes së përgjithshme, çdo anëtar ka të drejtë të konsultohet në selinë e AAK-së për:

- a) raportin vjetor;
- b) bilancin kontabël;
- c) raportin e organeve drejtuese dhe të komisionit të auditimit;
- ç) tekstin dhe preambulat e vendimeve që janë subjekt i miratimeve të asamblesë së përgjithshme;
- d) pagat individuale të punonjësve;
- dh) situatën e shumave nga llogaritë bankare të investimeve dhe të interesave të marrë në fund të vitit të fundit financiar;
- e) situatën në lidhje me kategoritë e përdoruesve, numrin e paguesve të çdo kategorie dhe shumën e përgjithshme të mbledhur nga çdo kategori, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me përdoruesit.

4. Të paktën një e pesta e anëtarëve me të drejta të plota të një agjencie mund të kërkojë që një ose më shumë se një ekspert i pavarur të inspektojë veprimtarinë e shoqërisë, përveçse nëse një inspektim i tillë tashmë është kryer në bazë të kësaj dispozite për vitin aktual.

5. Aksesi në informacionin e dhënë në pikën 3, të këtij neni, bëhet nën regjimin e konfidencialitetit, në bazë të kërkesës me shkrim dhe me kufizimin e aksesit tek të dhënat personale të punonjësve të agjencisë.

6. Anëtarët, për të cilët është vlerësuar se e drejta e tyre për të marrë informacionin e kërkuar nuk është realizuar, mund t'ia kërkojnë këtë, brenda tri ditëve, komisionit të posaçëm, i përhershëm në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për informim, i emëruar nga mbledhja e përgjithshme, që përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë pjesë e organeve drejtuese. Komisioni është i detyruar t'i përgjigjet, brenda shtatë ditëve, për bazueshmërinë e këtyre pretendimeve, si ankuesit që ka depozituar ankesën edhe drejtuesit të agjencisë. Komisioni do të hartojë çdo vit një raport për veprimtarinë e tij, i cili do të dorëzohet në mbledhjen e përgjithshme të agjencisë dhe pranë DDA-së.

PJESA VI

MASAT TEKNOLOGJIKE DHE E DREJTA E ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT

Neni 154

Masat mbrojtëse teknologjike

1. Autori i një veprë, interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi, prodhuesit e fonogrameve ose të filmit (regjistrimeve audiovizuale), ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv ose prodhuesit e bazës së të dhënave mund të krijojnë masa teknologjike të mbrojtjes së të drejtave të njohura me këtë ligj. Ndalohen, pavarësisht nëse si rezultat i tyre ose jo mund të ndodhin shkelje të së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura ose të drejtave të tjera të mbrojtura nga ky ligj, veprimet vijuese:

- a) shmangia e çdo mase teknologjike efektive nga personi që e kryen veprimin e shmangies me dijeni ose që ka baza të arsyeshme për të pasur dijeni se ai/ajo po ndjek këtë objektiv;

- b) prodhimi, importimi, shpërndarja, shitja, qiradhënia, reklamimi për shitje ose qiradhënie ose zotërimi për qëllime tregtare i pajisjeve, produkteve apo pjesëve përbërëse ose ofrimi i shërbimeve që:

- i) nxiten, reklamohen ose tregtohen për qëllime shmangieje;

- ii) kanë vetëm një qëllim të kufizuar tregtar ose përdorim të ndryshëm nga shmangia;

iii) janë kryesisht të projektuara, të prodhuara, të përshtatura ose të përdorura për qëllime të mundësimit ose lehtësimit të shmangies së masave teknologjike.

2. Në zbatim të këtij ligji, “masa teknologjike” janë çdo teknologji, pajisje ose pjesë përbërëse, që është projektuar për parandalimin ose kufizimin e veprimeve në rrjedhën normale të funksionimit të tyre, lidhur me krijimet ose objektet e të drejtave të lidhura, që nuk janë të autorizuara nga mbajtësit e të drejtave. Masat teknologjike konsiderohen “efektive”, kur përdorimi i një veprë të mbrojtur apo objekti të të drejtave të lidhura kontrollohet nga mbajtësi i të drejtave nëpërmjet zbatimit të një kontrolli të hyrjes ose procesi mbrojtës, si kriptimi, çkodimi ose shndërrime të tjera të krijimit ose objektit të të drejtave të lidhura ose një mekanizmi kontrolli të kopjes që, në rrjedhën normale të funksionimit të saj, arrin objektivin e mbrojtjes.

3. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për programet kompjuterike.

Neni 155

Informacioni i administrimit të të drejtave

1. Në zbatim të këtij ligji, “informacioni i administrimit të të drejtave” është çdo informacion i dhënë nga autori ose mbajtës tjetër i të drejtave, që identifikon veprën ose një objekt të të drejtave të lidhura, autori ose një mbajtës tjetër i së drejtës ose informacioni mbi kushtet e përdorimit të veprës ose objektit të mbrojtur, si edhe numrat apo kodet që përfaqësojnë këtë informacion.

2. Ndalohen të kryhen, me dashje, veprimet e mëposhtme nga një person i paautorizuar:

a) heqja ose tjetërsimi i informacionit elektronik të administrimit të të drejtave;

b) shpërndarja, importimi për shpërndarje, transmetimi, përcjellja ose vënia në dispozicion të publikut e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura apo të drejtave të tjera të parashikuara nga ky ligj, nga të cilat është hequr ose tjetërsuar informacioni elektronik i administrimit të të drejtave, në rast se ky person është në dijeni ose ka baza të arsyeshme për të qenë në dijeni se, duke e bërë këtë, ai shkakton, mundëson, lehtëson ose fsheh shkeljen e së drejtës së autorit, të të drejtave të lidhura ose të të drejtave të tjera të parashikuara nga ky ligj.

PJESA VII

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT, DREJTORIA PËR TË DREJTËN E AUTORIT, BORDI I ARBITRAZHIT DHE PROCEDURAT E NDËRMJETËSIMIT DHE ARBITRAZHIT

Neni 156

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit funksionon Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), i cili përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Ata emërohen nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit për një periudhë katërvjeçare. Propozime për zgjedhjen e anëtarëve të KKDA-së mund të bëjnë AAK-ja dhe shoqatat përfaqësuese të përdoruesve, si dhe çdo subjekt i interesuar. DDA-ja do të shërbejë si sekretariat teknik për KKDA-në.

2. KKDA-ja merr vendimet e saj me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj.

3. Mënyra e funksionimit, shpërblimit dhe e organizimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kompetencat e KKDA-së janë:

- a) miraton metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit;
- b) vendos në lidhje me ndonjë pretendim të palëve për përfundimin e marrëveshjes dhe kontrollon nëse marrëveshja është në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- c) përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e krijimtarisë me vlerë kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- ç) parashikon procedurat e arbitrazhit.

5. Kur palët, në çështjet e përmendura në pikën e mësipërme, kanë lidhur një marrëveshje arbitrazhi ose kanë miratuar një dispozitë të marrëveshjes së arbitrazhit, kjo marrëveshje ose dispozitë e lidhur, sipas këtij ligji, do të jetë e pavlefshme.

Neni 157

Drejtoria për të Drejtën e Autorit

1. DDA-ja krijohet si strukturë pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

2. DDA-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë;

b) mbledh informacionin e nevojshëm, kryen studime, konsultohet dhe bashkëpunon me autoritetet shtetërore, institucionet publike e private, me përfaqësuesit e mbajtësve të interesuar të të drejtave dhe përdoruesve për të përmbushur detyrat e saj;

c) i paraqet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit dhe/ose institucioneve të tjera shtetërore propozime, në rastin kur disa masa të nevojshme për zbatimin e strategjisë kombëtare të zbatimit të të drejtave të autorit, të përmendura në shkronjën “a”, të këtij neni, dalin jashtë kompetencave të saj;

ç) propozon akte ligjore lidhur me mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj;

d) me autorizim të ministrit përgjegjës të të drejtave të autorit përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë që merren me të drejtën e autorit, të drejtat e lidhura dhe të drejta të tjera që mbrohen nga ky ligj;

dh) krijon dhe ruan bashkëpunime të ndërsjella me zyrat, agjencitë qeveritare e institucionet kërkimore dhe organizma të vendeve të tjera që merren me të drejtën e autorit, të drejtat e lidhura dhe të drejta të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me politikën ndërqeveritare të Republikës së Shqipërisë;

e) bashkëpunon me autoritetet kompetente administrative ose gjyqësore dhe çdo autoritet tjetër shtetëror kompetent për zbatimin e këtyre të drejtave të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji;

ë) kryen procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit të organizatave për licencim, si AAK, dhe i paraqet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit, kur është e mundur, dy propozime për miratim licencimi dhe ministri miraton një nga kandidaturat;

f) mbikëqyr veprimtaritë e AAK-së dhe vepron në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

g) krijon, administron dhe përditëson regjistrin e të dhënave, të hapur për publikun, dokumentar dhe elektronik, për:

i) regjistrimin vullnetar të krijimeve të mbrojtura nga e drejta e autorit;

ii) veprat që bien në domenin publik, të cilin e përditëson nga institucionet e ndryshme arkiv-krijuese dhe që zbatojnë dispozitat e depozitimit të detyrueshëm të kopjeve të ligjshme

të krijimeve, të publikuara/të prodhuara ose të importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

iii) AAK-të e licencuara të administrimit kolektiv dhe veprimtarinë e tyre;

iv) subjektet përdoruese dhe pajisjen e tyre të detyrueshme me autorizimet, kontratat, autorizimet e lëshuara nga AAK-të, të licencuara në zbatim të këtij ligji;

gj) përgatit, promovon, shpërndan materiale informuese, organizon fushata të ndërgjegjësimit të institucioneve, grupeve të interesit dhe publikut, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, si edhe aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, si seminare, konferenca dhe trajnime etj., lidhur me rëndësinë dhe aspektet politike, ligjore dhe praktike të mbrojtjes, ushtrimit dhe zbatimit të së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj;

h) kryen veprimtari profesionale dhe administrative dhe jep asistencë teknike dhe shkencore në lidhje me karakterin origjinal të produkteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, me kërkesë të organeve të hetimit penal dhe me shpenzime të të pandehurve, në qoftë se fajësia e tyre provohet;

i) kryen, me kërkesë dhe kundrejt pagesës, hetim administrativ, në favor të palëve të interesuara;

j) kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar në ligj.

3. DDA-ja funksionon si sekretariat teknik i KKDA-së dhe Bordit të Arbitrazhit, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Pranë DDA-së vepron një trupë arbitrimi, e përbërë nga 20 anëtarë, të emëruar çdo 3 vjet me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit. Përzgjedhja e tyre kryhet nga lista e ekspertëve me eksperiencë jo më të vogël se 10 vjet në fushën e së drejtës civile, e propozuar nga AAK-të, nga strukturat përfaqësuese të përdoruesve, si dhe nga subjektet e interesuara, propozime të cilat depozitohen pranë DDA-së, sipas afateve dhe modaliteteve të hartuara prej saj.

Arbitrat nuk do të kenë statusin e punonjësve pranë DDA-së dhe kanë të drejtë për një tarifë pagese për pjesëmarrjen e tyre në arbitrazh për metodologjitë e të ardhurave të të drejtave të administruara nga ana e AAK-ve, sipas kushteve të parashikuara me ligj.

4. Tarifat e shërbimeve që kryhen nga DDA-ja dhe ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vlera ekuivalente e shërbimeve të parashikuara në shkronjën "h", të pikës 1, të këtij neni, do të përfshihet në shpenzimet ligjore.

Neni 158

Aktivitetet e DDA-së

1. DDA-ja i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit licencimin e AAK-së, në përputhje me procedurat dhe kriteret për licencim, të parashikuara nga ky ligj.

2. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, me urdhër ose udhëzim, përcakton kriteret dhe procedura të tjera shtesë në sqarim të kritereve të parashikuara në nenin 133, të këtij ligji, si dhe përcakton kushtet dhe procedurat për marrjen e licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134 të këtij ligji.

3. DDA-ja mban të dhënat e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave.

4. Urdhri i ministrit për dhënien ose ripërtëritjen e licencimit të një agjencie të administrimit kolektiv, së bashku me përcaktimin e të drejtave e të kategorive të mbajtësve të të drejtave që mbulon AAK-ja hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në Qendrën Kombëtare të Licencimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Subjekti që paraqet kërkesën për licencim pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit i vendos asaj në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse që i nevojiten për plotësimin e procedurës së licencimit.

6. DDA-ja kryen inspektive në agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave.

Neni 159

Mbikëqyrja e veprimtarive të AAK-së

1. Veprimtaria e AAK-së mbikëqyret nga DDA-ja.

2. Për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje, AAK-ja paraqet pranë DDA-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) statutin dhe rregulloren, si dhe ndryshimet përkatëse të tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse;

b) kontratat dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura me agjencitë e huaja të administrimit kolektiv;

c) informacion për personat që kanë autorizimin t'i përfaqësojnë;

ç) vendimet e organeve të tyre më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse;

d) raportin dhe bilancin e tyre vjetor, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi;

dh) raportet e auditimit për veprimtarinë e tyre, të kryer nga auditues të brendshëm dhe/ose të jashtëm, të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;

e) çdo dokument tjetër të nevojshëm për verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarive të agjencive me këtë ligj, dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi dhe me statutet e tyre;

ë) raportin e detajuar të mbledhjes së tarifave nga përdoruesit dhe shpërndarjes së tyre te mbajtësit e së drejtës;

f) marrëveshjen gjithëpërfshirëse me shoqatat e përdoruesve.

3. DDA-ja kryen kontrollin e aktivitetit, sipas parashikimeve të këtij ligji, në bazë të njoftimit paraprak me shkresë të AAK-së, duke specifikuar edhe objektivat e kontrollit. DDA-ja kontrollon një herë në vit veprimtarinë e AAK-së, duke e njoftuar atë 10 ditë përpara. DDA-ja mund të kryejë, gjithashtu, kontrolle të posaçme midis dy kontrolleve të njëpasnjëshme, duke njoftuar atë paraprakisht përpara 3 ditëve nga kontrolli, në rast se merr informacion nga anëtarët e AAK-së, nga mbajtës të tjerë të të drejtave nga përdoruesit ose nga çdo burim përkatës, mbi bazën e të cilit lind dyshimi i arsyeshëm nëse veprimtarinë e agjencisë janë në përputhje me këtë ligj dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi dhe statutet e tyre. Drejtoria për të Drejtën e Autorit përgatit një raport të rezultateve të secilit kontroll, i cili mund të përfshijë masat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni.

4. Asambleja e Përgjithshme, si organi më i lartë drejtues i AAK-së, ka detyrimin të raportojë për programin e mbledhjes së saj të ardhshme, ta diskutojë atë dhe të informojë Drejtorinë për të Drejtën e Autorit lidhur me përfundimet e diskutimit dhe masat e marra.

5. Në rastet kur DDA-ja konstaton se veprimtaria e AAK-së nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi ose me vetë statutin e saj, e urdhëron të rregullojë të metat e konstatuara, në përputhje me këto dispozita, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse AAK-ja nuk përmbush këtë detyrim, DDA-ja, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit fillimin e procedurave për pezullimin për 6 muaj të licencës deri në heqjen e saj. Aktet e mësipërme hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare. Urdhri i ministrit, i dalë në vijim të një procedure administrative, merret pas dëgjimit të palëve.

6. E drejta e ankimit për pezullimin apo heqjen e licencës ushtrohet para gjykatës kompetente.

Ndërmjetësimi

1. AAK-ja dhe shoqatat përfaqësuese të përdoruesve propozojnë, në bazë të rregullave për ndërmjetësimin, ndërmjetësimin në një mosmarrëveshje, në lidhje me përfundimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për ritransmetim kabllor të transmetimeve. Ndërmjetësimi i tarifave midis AAK-së dhe shoqatave përfaqësuese të përdoruesve agjencive/subjekteve të interesuara është i detyrueshëm për t'u shteruar përpara ndjekjes së procesit në rrugë gjyqësore. Për procedurat e ndërmjetësimit zbatohen rregullat e ndërmjetësimit.

2. Gjithashtu, ndërmjetësimin mund ta propozojnë edhe në lidhje me ofrimin e aksesit në veprën e së drejtës së autorit dhe përdorimit të saj, në përputhje me ndonjë kufizim të përmendur nga nenet 72-78, duke iu referuar nenit 87, të këtij ligji, ndërmjet një personi, i cili pretendon të jetë i autorizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji për të përdorur një vepër të autorit pa autorizimin e autorit ose pa autorizimin e autorit dhe pa pagesën e shpërblimit, dhe autori, ose një person tjetër, përkatësisht, i cili aplikon masa mbrojtëse teknologjike për të parandaluar aksesin ose përdorimin e veprave të autorit, ose i cili është i autorizuar dhe ka mundësinë për të hequr ato. Rregullat për ndërmjetësimin ndërmjet një AAK-je dhe një shoqate përfaqësuese të përdoruesve do të zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për këtë procedurë ndërmjetësimi.

3. Nëse palët nuk arrijnë të bien dakord për përmbajtjen e marrëveshjes për ritransmetim kabllor të një transmetimi, secila nga palët e përmendura mund të thërrasë për ndërmjetësim një ndërmjetës në lidhje me përfundimin e kësaj marrëveshjeje. Ndërmjetësi duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm në kryerjen e detyrës së tij.

4. Ndërmjetësi mund t'u paraqesë një propozim palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Propozimet dorëzohen personalisht ose me postë. Nëse asnjë nga palët nuk shpreh kundërshtimin e saj me postë brenda tre muajve nga dita e pranimit të propozimit, konsiderohet se të dyja palët e pranojnë propozimin dhe u kërkohet për ta përfshirë atë në kontratën për ritransmetim kabllor.

5. Palët hyjnë dhe përfundojnë negociatat në mirëbesim me njëra-tjetrën dhe ato do të jenë përgjegjëse për çdo keqpërdorim të negociatave ose pozicioneve negociuese apo të drejtat e tyre, në përputhje me legjislacionin e përgjithshëm.

6. Palët bashkërisht e zgjedhin ndërmjetësin nga lista e ndërmjetësve, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

7. DDA-ja do të sigurojë ndihmë administrative për ndërmjetësimin.

8. Palët do të paguajnë ndërmjetësin për punën e tij.

9. Në qoftë se palët nuk bien dakord me zgjidhjen e propozuar nga ndërmjetësi në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk arrijnë marrëveshjen për pranimin e tarifave, procedurat përpara KKDA-së, në lidhje me vendosjen e metodologjisë dhe tarifave, do të zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për përfundimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për ritransmetim kabllor të transmetimeve, sipas këtij neni.

Arbitrazhi në rastet e përjashtimeve dhe kufizimeve të zbatimit të masave teknologjike të mbrojtjes në përdorimin e krijimeve dhe objekteve të të drejtave të lidhura

1. Në rastet e përjashtimeve dhe kufizimeve për zbatimin e masave teknologjike, sipas parashikimeve në pjesën VI, të këtij ligji, subjektet e interesuara mund të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes me procedurë arbitrazhi, drejtuar me shkrim ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, në përputhje me parashikimet e procedurave të miratuara nga KKDA-ja.

2. Procedura e arbitrazhit zhvillohet nga Bordi i Arbitrazhit dhe organizohet në DDA, e cila shërben si sekretariat teknik i këtij bordi. Anëtarët e bordit propozohen nga Drejtori i DDA-së.

Ky bord, i përbërë nga jo më pak se tre anëtarë, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit.

3. Kriteret e përzgjedhjes së arbitrave dhe shpërblimi i anëtarëve të Bordit të Arbitrazhit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit. Anëtarët e panelit zgjidhen në mënyrë të tillë që pavarësia dhe paanshmëria e tyre të jenë përtej dyshimit të arsyeshëm. Arbitrat zgjidhen në mënyrë të tillë që të mos kenë konflikt interesi dhe për këtë qëllim nënshkruajnë deklaratën përkatëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

4. Me marrjen e kërkesës për arbitrazh, Drejtori i DDA-së, brenda 2 ditëve nga depozitimi i kërkesës nga pala e interesuar, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, emrat e arbitrave, në përputhje me objektin e mosmarrëveshjes së palëve kërkuese.

5. DDA-ja u njofton zyrtarisht palëve emrat e arbitrave të propozuar prej saj dhe të miratuar nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit. Në rast se një palë ka dyshime lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e një anëtari të panelit, ajo mund të kërkojë përzgjedhjen e një arbitri tjetër brenda 5 ditëve kalendrike nga data e marrjes dijeni të këtij njoftimi.

Nëse brenda këtij afati nuk ka kontestime nga palët, konsiderohet se palët kanë pranuar propozimet përkatëse për arbitrat. Në këtë rast, DDA-ja njofton ministrin përgjegjës për të drejtat e autorit për miratimin me urdhër brenda 15 ditëve të Bordit të Arbitrazhit me emrat e propozuar.

6. Urdhri për krijimin e bordit, data e fillimit të arbitrazhit dhe aktet përkatëse u dërgohen palëve brenda 5 ditëve nga DDA-ja.

7. Nga data e marrjes së kërkesës për arbitrazh, shqyrtimi i saj dhe deri në nxjerrjen e vendimit, afati i kësaj procedure është jo më shumë se 3 muaj. Bordi vendos pranimin ose rrëzimin e kërkesës për shkaqe ligjore dhe vendimi i bordit, ku përcaktohet pala së cilës do t'i ngarkohen shpenzimet e arbitrazhit, shpallet në prezencë të palëve. Ky vendim është i ankimueshëm brenda 30 ditëve në Gjykatën e Apelit, Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile. Nëse nuk ankimohet brenda këtij afati, vendimi i Bordit të Arbitrazhit është përfundimtar dhe ekzekutohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

8. Kundër vendimit të Bordit të Arbitrazhit palët i drejtohen Gjykatës së Apelit, Tiranë. Ankimi kundër këtij vendimi nuk pezullon zbatimin e tarifave, objekt ndërmjetësimi.

PJESA VIII

ZBATIMI I TË DREJTAVE

Neni 162

Normat e zbatueshme

1. Shkelja e të drejtave të njohura dhe të garantuara me këtë ligj përbën përgjegjësi civile, administrative, kundërvajtje ose përgjegjësi penale, siç mund të jetë rasti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Procedura dhe përgjegjësitë civile rregullohen nga parashikimet e dispozitave të kësaj pjese dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 163

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe dëmshpërblimet përkatëse

1. Mbjtësit e ligjshëm të të drejtave të njohura e të garantuara në bazë të këtij ligji gëzojnë të drejtën për t'i kërkuar gjykatës respektimin e të drejtave të tyre nga çdo shkelës dhe ndërmjetës, shërbimet e të cilit janë përdorur nga një palë e tretë për shkeljen e të drejtave që gëzojnë, si dhe dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar nga kjo shkelje.

2. Të drejtat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, i gëzojnë edhe:

a) individët që janë autorizuar nga mbajtësit e së drejtës për përdorimin e të drejtave që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me autorizimin që u është dhënë atyre për këtë qëllim;

b) organizatat profesionale të mbrojtjes dhe shoqatat përfaqësuese, të cilat janë autorizuar për të përfaqësuar mbajtësit e të drejtave.

3. E njëjta mbrojtje mund të kërkohet nga mbajtësit e së drejtës, kur ekziston një rrezik i dukshëm se një shkelje e të drejtave, sipas këtij ligji, do të ndodhë.

4. Nëse ka disa mbajtës për të njëjtën të drejtë, sipas këtij ligji, secili prej tyre ka të drejtën e mbrojtjes së të drejtës së tij ndaj mbajtësve të tjerë.

5. AAK-ja ka të drejtë, në të gjitha rrethanat, të ushtrojë të drejtën e përfaqësimit për të ngritur padi gjyqësore ose në çdo procedurë tjetër në emër të saj, si dhe të ushtrojë në legjitimitet të plotë të gjitha të drejtat që i janë kaluar ose për të cilat zotëron licencën.

6. Padia, me objekt cenimin e të drejtave të autorit ose të drejtave të lidhura me to, mund të ngrihet në gjykatë brenda tre vjetëve nga data kur paditësi ka marrë dijeni për shkeljen e së drejtës, si dhe identitetin e shkelësit.

Neni 164

Kërkesa për ndërprerjen e shkeljes

Një mbajtës i së drejtës në bazë të këtij ligji, të drejtat e të cilit janë cenuar, mund të kërkojë ndërprerjen dhe ndalimin e këtyre shkeljeve ose të atyre që mund të ndodhin në të ardhmen, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 165

Kërkesa për kompensimin e dëmeve

Nëse vërtetohet se shkelja e ndonjë të drejte, sipas këtij ligji, ka shkaktuar dëmtime, mbajtësi i së drejtës ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kompensimin e dëmeve.

Neni 166

Kërkesa për kompensim dhe shpërblim për përdorimin e paautorizuar

1. Nëse nga përdorimi i paautorizuar i një veprë të së drejtës së autorit ose i të drejtave të lidhura me të është shkelur e drejta e mbajtësit të së drejtës, në bazë të këtij ligji, ai ose një AAK, që administron të drejtat përkatëse, mund të pretendojnë shpërblim, i cili do të ishte i barabartë me shpërblimin për përdorim, sipas tarifave të përmendura në këtë ligj.

2. E drejta, e cila është administruar në mënyrë kolektive, do të konsiderohet e shkelur, sipas pikës 1, të këtij neni, kur vepra ose objekti i të drejtave të lidhura është përdorur pa kontratë ose pa autorizimin e një AAK-je ose në rastet kur një kontratë ose autorizim nuk është i vlefshëm.

3. Nëse shfrytëzimi i paligjshëm i ndonjë të drejte, sipas këtij ligji, rezulton me përfitim, mbajtësi i së drejtës ka të drejtë të kërkojë përfitimin e fituar nga personi fizik ose juridik që e ka shkelur këtë të drejtë mbi një veprë të së drejtës së autorit.

Neni 167

Publikimi i vendimit gjyqësor

1. Gjykata vendos, me kërkesë të palës paditëse dhe me shpenzimet e shkelësit, marrjen e masave të duhura për përhapjen e informacionit që ka të bëjë me publikimin e këtij vendimi, tërësisht ose pjesërisht, në mjetet e njohura të komunikimit publik.

2. Në të njëjtat rrethana, gjykata vendos marrjen e masave të tjera për publikimin, në përputhje me natyrën e çështjes, përfshirë publikimin në shkallën më të gjerë të mundshme.

Neni 168

Kërkesa për shkatërrimin, modifikimin ose dorëzimin e kopjeve të riprodhuara në kundërshtim me ligjin

1. Mbajtësi i së drejtës ekskluzive të shkelur/të cenuar, në bazë të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shkatërrimin ose ndryshimin e të gjitha kopjeve të bëra në mënyrë të paligjshme ose kopjeve të tilla të hedhura ose të destinuara për t'u hedhur në treg.

2. Në vend të masës së përmendur në pikën 1, të këtij neni, personi, e drejta e të cilit, në bazë të këtij ligji, është shkelur, ka të drejtë të pretendojë se kundërvajtësi, i cili ka në posedim kopjet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ose është pronar i tyre, t'i dorëzojë këto kopje kundrejt kompensimit që nuk i tejkalon kostot e prodhimit të tyre.

3. Përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, do të zbatohen për veprat arkitekturore vetëm kur ka një arsye të justifikuar në mënyrë të posaçme për shkatërrimin ose dorëzimin e saj.

4. Nëse masat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, janë në ndonjë rast të caktuara në shpërpjesëtim me natyrën dhe intensitetin e shkeljes dhe shkelja mund të riparohet ndryshe, gjykata, brenda kufizimit të kërkesës, mund të urdhërojë masa të tjera të nevojshme për një rast të tillë. Në një rast të tillë, mbajtësi i së drejtës minimalisht ka të drejtën për shpërblimin në vlerë jo më të vogël se ajo që do të merrte për përdorimin e autorizuar të së drejtës përkatëse.

5. Masat e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të zbatohen për pjesë të ndara të kopjeve, që prodhohen dhe hidhen në treg dhe të cilat janë të ligjshme.

6. Përcaktimet e këtij neni zbatohen me ndryshimet e nevojshme edhe për materialet dhe/ose pajisjet, të cilat përdoren në ose janë të destinuara për prodhimin e kopjeve, që shkelin të drejtat, në bazë të këtij ligji, ose të cilat janë ekskluzivisht ose kryesisht të destinuara për këtë qëllim.

7. Përcaktimet e këtij neni nuk do të zbatohen nëse shkatërrimi i materialit dhe/ose i pajisjeve të përmendura në pikën 6, të këtij neni, do të shkaktonte dëm më të madh se dëmi i shkaktuar nga shkelja e të drejtave, sipas këtij ligji, përveçse nëse kjo lidhet me materialet dhe/ose pajisjet, të cilat janë ekskluzivisht ose kryesisht të destinuara për shkeljen e të drejtave, sipas këtij ligji.

8. Pretendimet e përmendura në këtë nen do të ushtrohen brenda 3 vjetëve nga data në të cilën mbajtësi i së drejtës ka marrë dijeni për prodhimin e paligjshëm të materialeve dhe/ose të pajisjeve apo për hedhjen ose destinimin për t'u hedhur në treg.

Neni 169

Mbrojtja e të drejtave jopasurore

Parashikimet e neneve 170 dhe 171, të këtij ligji, që kanë për objekt ushtrimin e të drejtave vetjake jopasurore dhe mbrojtjen e tyre, zbatohen me ndryshimet e nevojshme, sipas dispozitave të kësaj pjese, për aq sa natyra e këtyre të drejtave e lejon këtë zbatim.

Neni 170

Mbrojtja e autorësisë

Kërkesat në mbrojtje të të drejtave vetjake jopasurore, që lidhen me autorësinë në një vepër, kanë si qëllim asnjësimin ose shkatërrimin e kopjes ose të prodhimit të kësaj vepre, vetëm nëse dëmi nuk mund të riparohet me anë të shtesës, të shënimit në vepër ose të reklamës për sa i përket autorësisë.

Neni 171

Cenimi i veprës

Kërkesat dhe veprimet në mbrojtje të të drejtave vetjake jopasurore, që lidhen me cenimin e tërësisë së një vepre, kanë si qëllim asnjësimin ose shkatërrimin e kopjes ose të prodhimit të kësaj vepre të deformuar, të copëtuar ose të ndryshuar, vetëm nëse është materialisht e pamundur që kopja ose riprodhimi i saj të kthehet në formën origjinale, me shpenzimet e palës që kundërshton asnjësimin ose shkatërrimin.

Neni 172

Shpërblimi për dëmin

1. Për shkeljet, sipas këtij ligji, parashikimet e këtij ligji do të jenë të zbatueshme në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë shkaktimin e dëmit.

2. Kundërvajtësi do t'i paguajë mbajtësit të së drejtës dëmet në shumën që do të përcaktohet sipas rregullave në fuqi për kompensimin/shpërblimin e dëmit ose me shumën, për të cilën është rënë dakord mes palëve, ose sipas shpërblimit për përdorimin legjitim të asaj vepre.

3. Në qoftë se një e drejtë, sipas këtij ligji, është shkelur qëllimisht ose nga pakujdesia e rëndë, titullari i së drejtës mund të kërkojë pagimin, për të cilin është rënë dakord ndërmjet tyre, ose shpërblimin përkatës për këtë përdorim nga personi, i cili ka shkelur të drejtën e tij, pavarësisht nëse ai ka pësuar dëmtime për shkak të kësaj shkeljeje.

4. Në kërkesën për përcaktimin e dëmeve dhe përcaktimin e shumës së tyre, gjykata mban parasysht të gjitha rrethanat e rastit dhe, në veçanti, shkallën e dëmit të shkelësit, shumën për të cilën është rënë dakord ose shpërblimin nga përdorimi legjitim i veprës.

Neni 173

Masat paraprake gjatë shkeljes së të drejtave

1. Gjykata mund të urdhërojë një masë të përkohshme për sigurimin e padisë për ndërprerjen ose ndalimin e shkeljes, nëse në kërkesën e mbajtësit të së drejtës, sipas këtij ligji, janë cenuar ose janë gati për t'u cenuar apo ka arsye të dyshohet se të drejtat e paditësit cenohen ose situata e shkeljes mund të rëndohet, në rastet kur ka arsye të mundshme për të besuar se:

a) ekziston rreziku që mbrojtja e objektit të kërkesëpadisë do të bëhet e pamundur ose tepër e vështirë;

b) miratimi i një mase të përkohshme është i domosdoshëm për të shmangur dëmtimet vështirësisht të riparueshme më vonë;

c) një masë parandaluese mund të rezultojë e pabazuar gjatë procesit, në mënyrë që të mos ketë pasoja shkatërruese (negative) për shkelësin e pretenduar, i cili nuk mund të përshtatet me këtë masë që kërkohet të merret nga mbajtësi i së drejtës.

2. Gjykata, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, dhe në përputhje me rregullat e procedurës civile, mund:

a) të urdhërojë palën kundërshtare të pushojë ose të tërhiqet respektivisht nga aktet dhe veprimet që shkelin të drejtën e fituar sipas këtij ligji. Kjo masë mund të jepet në të njëjtat kushte edhe kundër një ndërmjetësi, nëse provohet gjatë procesit gjyqësor se shërbimet e tij janë përdorur nga një palë e tretë për shkeljen e të drejtave të autorit dhe/ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

b) të urdhërojë konfiskimin ose heqjen nga tregu të mallrave të paligjshme që shkelin të drejtën e fituar sipas këtij ligji ose dorëzimin e kampionëve apo mbajtësit fizik të veprave, instrumenteve ose aparaturave që dyshohet se përdoren në cenimin e së drejtës së autorit

dhe/ose të drejtave të tjera të lidhura me të, në mënyrë që të parandalohet hyrja ose qarkullimi i tyre në qarkullimin tregtar.

3. Me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, sipas këtij ligji, kur ka arsye të dyshohet se të drejtat e paditësit cenohen në shkallë tregtare, me qëllim të marrjes së përfitimit tregtar ose ekonomik, si dhe në rastet kur kjo shkelje është rrezik potencial për t'i shkaktuar atij dëme të pariparueshme, gjykata, përveç masave të përkohshme, të përmendura në pikën 2, të këtij neni, mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të palës kundërshtare, që nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shkeljen, duke përfshirë edhe bllokimin e llogarive të saj bankare, si dhe asetet e tjera.

4. Për qëllimin e urdhërimit dhe zbatimit të masës së përkohshme, sipas pikës 3, të këtij neni, gjykata mund të kërkojë nga pala kundërshtare ose personat e tjerë t'i vendosin në dispozicion deklaratat bankare, financiare dhe çdo informacion tjetër për veprimtarinë ekonomike ose aksesin në dokumente. Gjykata mban parasysh nevojat për përpjesëtimëri ndërmjet seriozitetit të shkeljes, masave mbrojtëse juridike të urdhëruara, si dhe interesave të palëve të treta, duke siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni e duke ndaluar çdo keqpërdorim të mundshëm të tij.

5. Me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, i cili kërkon marrjen e masës së përkohshme, të përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, pa informuar më parë palën kundërshtare, gjykata mund të urdhërojë një masë të tillë pa informuar palën kundërshtare të tyre, nëse masa e përkohshme nuk do të jetë efektive ose nëse një dëm i pariparueshëm ka rrezik që të ndodhë. Në këtë rast, mbajtësi i së drejtës duhet të tregojë arsye të tjera shtesë. Masa e përkohshme, e përmendur në pikën 3, të këtij neni, mund të urdhërohet pa informuar palën kundërshtare, nëse masa e përkohshme nuk do të ishte efektive ose kur, duke marrë në konsideratë rrethanat serioze të shkeljes, kjo masë do të ishte e nevojshme. Nëse një masë e përkohshme urdhërohet pa informuar palën kundërshtare më parë, gjykata do t'ia komunikojë vendimin palës kundërshtare për këtë masë të përkohshme menjëherë pas zbatimit të saj.

Neni 174

Masat paraprake për sigurimin dhe ruajtjen e provave

1. Me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, sipas këtij ligji, kur ka arsye të dyshohet se të drejtat e paditësit, të parashikuara në këtë ligj, cenohen ose janë gati për t'u cenuar, kur ka rrezik për shkatërrimin e elementeve të provës ose kur situata e shkeljes mund të rëndohet, gjykata mund të urdhërojë një masë të përkohshme që përfshin ruajtjen e gjendjes faktike të provave që disponohen nga pala e paditur ose të tretët.

2. Nga masa e përkohshme, sipas pikës 1, të këtij neni, gjykata mund të urdhërojë në veçanti:

a) inspektimin e vendeve, të të dhënave të biznesit, inventarit, bazave të të dhënave, njësive të kujtesës kompjuterike ose të tjera;

b) përgatitjen e një përshkrimi të hollësishëm të mallrave/mjeteve/materialeve, kur ka arsye të dyshohet se cenojnë një të drejtë, në bazë të këtij ligji;

c) marrjen e mostrave/kampionëve të objekteve të shkeljes;

ç) konfiskimin e mallit, kur ka arsye të dyshohet se cenojnë një të drejtë, në bazë të këtij ligji;

d) konfiskimin e materialeve e të mjeteve të përdorura në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave, kur ka arsye të dyshohet se cenojnë një të drejtë, në bazë të këtij ligji, si dhe dokumentacionin që lidhet me to. Në vendimin e gjykatës shprehet mbi provat që merren dhe përcaktohen vendi i ruajtjes së tyre dhe organi (subjekti), i cili ngarkohet me ruajtjen e provës;

dh) caktimin e një eksperti, si edhe për pyetjen e dëshmitarëve.

3. Me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, i cili kërkon marrjen e masës së përkohshme, të përmendur në këtë nen, pa informuar më parë palën kundërshtare, gjykata mund të urdhërojë një masë të tillë, pa informuar palën kundërshtare më parë, nëse kërkuesi (pala paditëse) ka arsye të dyshojë se provat e paditësit rrezikohen të shkatërrohen ose mund të shkaktohet një dëmtrim i pariparueshëm ose gjendja faktike e tyre është lehtësisht e ndryshueshme. Nëse një masë e përkohshme urdhërohet pa informuar palën kundërshtare të tij, gjykata do t'ia komunikojë këtë vendim palës kundërshtare, menjëherë pas zbatimit të tij. Ankimi kundër vendimit të gjykatës për sigurimin e provave nuk pengon vazhdimin e gjykimit.

4. Këto masa, të parashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni, merren në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

5. Masat për ruajtjen e provave merren pasi pala paditëse, që ka kërkuar marrjen e tyre, provon se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (garanci, mjete monetare etj.) për të siguruar dëmshpërblimin për çdo cenim që mund të pësojë pala e paditur nga marrja e këtyre masave.

6. Masat për ruajtjen e provave revokohen nga gjykata me kërkesë të të paditurit, pa paragjykuar dëmshpërblimin që mund të pretendohet, me përmbushjen e afatit 15-ditor nga data e ekzekutimit të këtyre masave, në rast se paditësi nuk e depoziton padinë brenda afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kur pushohet gjykimi, rrëzohet padia ose pala paditëse deklaron se nuk ka garanci të mjaftueshme monetare për sigurimin e padisë.

7. Kur masat për ruajtjen e provave revokohen në bazë të kërkesës së palës së paditur, gjykata shprehet me vendimin përfundimtar për kthimin e objekteve të konfiskuara, ndalimin e përdorimit të informacionit të marrë dhe dëmshpërblimin lidhur me çdo dëmtrim të shkakuar nga marrja e këtyre masave.

8. Në procedurën për ruajtjen e provave, në përputhje me këtë nen, gjykata do të sigurojë mbrojtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni dhe do të ndalojë çdo keqpërdorim të mundshëm të tij.

Neni 175

Masat doganore

Kërkesa e mbajtësit të së drejtës së autorit ose e një të drejte të lidhur me të ose të një AAK-je, për raste të dyshimit të shkeljes së të drejtave në import, eksport ose kalim të paligjshëm të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë do të bëhet në përputhje me legjislacionin doganor për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Neni 176

E drejta për informim

1. Në proceset gjyqësore, që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, sipas kërkesës së bazuar të paditësit, gjykata kompetente mund të urdhërojë marrjen e informacionit për origjinën dhe rrjetet shpërndarëse të mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat e garantuara nga ky ligj, të kryera nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër:

- a) për të cilin gjendet se zotëron mallrat që përbëjnë shkelje në nivel tregtar;
- b) për të cilin zbulohet se përdor mallrat që përbëjnë shkelje në nivel tregtar;
- c) për të cilin konstatohet se ofron shërbime të natyrës tregtare, që përdoren në veprimtari, të cilat përbëjnë shkelje;

ç) i cili është përmendur nga personi i parashikuar në shkronjat “a”, “b” ose “c” si i përfshirë në prodhimin, fabrikimin ose shpërndarjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të përfshijë, kur është e nevojshme:

a) emrat dhe adresat e prodhuesve, fabrikuesve, shpërndarësve, furnizuesve dhe titullarëve të mëparshëm të mallrave ose shërbimeve, si dhe të shitësve të synuar me shumicë dhe me pakicë;

b) të dhëna për sasi të prodhuara, të fabrikuara, të dërguara, të marra ose të porositura, si dhe për çmimin e përcaktuar për mallrat ose shërbimet në fjalë.

3. Pikat 1 dhe 2 nuk gjejnë zbatim nëse:

a) dispozita të ndryshme i japin të drejtë mbajtësit të së drejtës të marrë informacion më të plotë;

b) përdorimi i informacionit të përcjellë, në përputhje me këtë nen, rregullohet nga dispozita të ndryshme në procedime civile ose penale;

c) gjykata, në bazë të informacionit që ka në dispozicion, ka arsye të mendojë se e drejta për informim është shpërdoruar;

ç) dhënia e informacionit të kërkuar do ta detyronte personin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, të pranonte pjesëmarrjen e tij/saj ose atë të të afërmeve të tij/saj në shkeljen e së drejtës së autorit ose të një të drejte të lidhur me të;

d) zbulimi i informacionit nuk lejohet, në përputhje me rregullat mbi mbrojtjen e fshehtësisë së burimeve të informacionit ose përpunimin e të dhënave personale.

4. Përcaktimet e këtij neni do të zbatohen pa cenuar dispozitat që rregullojnë marrjen dhe paraqitjen e provave.

Neni 177

Kodet e standardeve dhe konformitetit të produkteve që lidhen me zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura

1. Organet kompetente shtetërore ose subjektet e autorizuara prej tyre, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për standardet dhe konformitetin, hartojnë dhe miratojnë kode teknike, me qëllim që të garantojnë mbikëqyrjen e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, veçanërisht për sa u përket kodeve të tilla, që lejojnë identifikimin e prodhuesve e të importuesve të produkteve, që lidhen me zbatimin e respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, të fiksuara në disk optik.

2. Mënyra e hartimit dhe miratimit të kodeve të standardeve e të konformitetit, si dhe e publikimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 178

Mbikëqyrja dhe inspektimi për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Inspektorët vendosin ndaj kundërvajtësit dënimin kryesor me gjobë dhe dënimet plotësuese, kur gjatë inspektimit konstatojnë shkeljet, nën juridiksionin e të cilëve është kryer kundërvajtja administrative.

4. Në çdo rast, objekti i kontrollit konsiston në produktin fizik dhe/ose në kontrollin e lejes së lëshuar nga mbajtësit e të drejtave ose agjencitë e licencuara të administrimit kolektiv, sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Inspektorati, i referuar në pikën 2, të këtij neni, bashkëpunon me autoritetet doganore e tatimore, Policinë e Shtetit dhe strukturat e krimit ekonomik, si edhe çdo institucion tjetër përgjegjës zbatues dhe mbikëqyrës për respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura apo mbajtësve të ligjshëm të tyre.

PJESA IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 179

Kundërvajtjet dhe masat administrative

1. Përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas parashikimeve të këtij neni, për shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, kur nuk përbën vepër ose kundërvajtje penale, si dhe veprimtaria e çdo personi, nëse:

a) pa autorizimin e autorit zbulon për herë të parë për publikun për mbrojtjen ose përshkrimin e veprës së autorit ose përdor veprën pa përmendur autorësinë ose pa autorizim shtrembëron, modifikon një vepër ose përdor veprën në një mënyrë që cenon nderin dhe reputacionin e autorit (nenet përkatëse për të drejtat vetjake jopasurore);

b) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je riprodhon një vepër të autorit (neni 26);

c) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je shpërndan ose jep me qira apo ndërmerr akte të tjera, për qëllime të shpërndarjes së veprës së autorit (nenet 27 e 28);

ç) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je komunikon në publik një vepër të së drejtës së autorit në çfarëdo mënyre (neni 29);

d) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je transformon një vepër të autorit (neni 30);

dh) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je nuk paguan shpërblimin për riprodhimin e një vepre të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, sipas ligjit (neni 31);

e) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je nuk paguan një shpërblim për huadhënien publike, sipas ligjit (neni 32);

ë) pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je nuk paguan një shpërblim për të drejtën e rishitjes, sipas ligjit (neni 33);

f) shpërndan ose mban për qëllime tregtare një kopje të një programi kompjuterik, duke e ditur ose që ka mundësinë për ta verifikuar se është ekzemplar i paligjshëm ose çdo mjet, shmang masat teknologjike për mbrojtjen e një programi kompjuterik (nenet përkatëse të ligjit);

g) nuk shënon emrin, pseudonimin ose ndonjë shenjë tjetër të një interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi, përveç nëse ky i fundit ka deklaruar me shkrim se ai nuk dëshiron të përmendet ose kur përdor veprën e tij në publik ose pa autorizimin e një interpretuesi dhe/ose

ekzekutuesi shtrembëron, modifikon shfaqjen ose përdor veprën në një mënyrë që cenon ose mund të shkelë nderin dhe reputacionin e interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit (neni 108);

gj) pa autorizimin e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve ose AAK-së shkel të drejtat ekskluzive pasurore të tyre (neni 109);

h) pa autorizimin e prodhuesit të fonogrameve ose AAK-së shkel të drejtat ekskluzive pasurore të tyre (neni 113);

i) pa autorizimin e prodhuesit të fiksimeve/regjistrimeve të para të filmave ose të një shpërndarësi të autorizuar ku prodhuesi ka transferuar të drejtat e tij, shkel të drejtat e tyre, në kundërshtim me ligjin (neni 116);

j) pa autorizimin e një organizate/ofruesve të shërbimit mediatic që, në mënyrë të paligjshme, shkel të drejtat ekskluzive të tyre (neni 117);

k) pa autorizimin e një botuesi dhe pa i paguar atij shpërblimin për riprodhimin e fotokopjeve për përdorim privat ose përdorim tjetër personal (neni 118);

l) pa autorizimin e një krijuesi të bazës së të dhënave përdor, nxjerr ose bën të disponueshme për publikun, përcjell në publik ose përdor në mënyrë të paligjshme bazat e tij të të dhënave (neni 121);

ll) shmang masat teknologjike për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të (neni 154);

m) heq ose ndryshon informacionin elektronik të administrimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to (neni 155).

2. Personi përgjegjës i personit juridik (administratori) dënohet për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 100 000 deri në 500 000 lekësh.

3. Personi fizik dënohet për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 100 000 deri në 500 000 lekësh.

4. Personi fizik, punonjës i çdo kategorie, ose çdo person tjetër i vetëpunësuar, përkatësisht, dënohet për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 50 000 deri 200 000 lekësh, respektivisht, ku kundërvajtja është kryer gjatë aktiviteteve të saj/të tij dhe që kishte dijeni apo ka pasur mundësinë për të marrë dijeni për të vërtetuar nëse ishte duke kryer një aktivitet të kundërligjshëm.

5. Objektet dhe mjetet e destinuara, të përdorura për kryerjen e kundërvajtjeve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, konfiskohen dhe shkatërrohen nga struktura përkatëse, sipas ligjit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

6. Ndaj një personi juridik ose personi fizik, që kryen kundërvajtje, sipas parashikimeve në pikën 1, të këtij neni, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, mund të ndërmerret masa e ndalimit të kryerjes së aktiviteteve të tij tregtare, për shkeljen e së drejtës së autorit ose të drejtave të lidhura me të, për një periudhë prej një viti, duke marrë parasysh edhe seriozitetin e shkeljeve dhe përsëritjen e këtyre shkeljeve nga ana e tyre.

7. Inspektorët kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e Policisë së Shtetit, në rast se pengohen në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore, në përputhje me dispozitat e ligjit për inspektimin.

8. Gjoha, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, nuk mund të vendoset nëse kanë kaluar tre vjet nga data e kryerjes së shkeljes.

9. Ndëshkohet me gjobë, në masën nga 10 000 deri në 100 000 lekë, çdo subjekt përdorues, në shkelje të dispozitave të këtij ligji, për moskryerjen e pagesës së shpërblimit kundrejt autorit/AAK-së ose përfaqësuesve të tyre.

10. Në rast përsëritjeje, masa ndëshkimore maksimale, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dyfishohet.

11. Të ardhurat nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 180

Moszbatimi i kufizimeve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to

1. Çdo person juridik dënohet për kundërvajtje administrative me gjobë nga 20 000 deri 200 000 lekë, nëse:

a) nuk arrin të sigurojë personat që janë të autorizuar, në përputhje me dispozitat e neneve 72-78, të këtij ligji, për të përdorur një vepër të së drejtës së autorit/të drejtave të lidhura me të dhe të cilët kanë vërtetuar se kushtet e përcaktuara në nenin 70, të këtij ligji, janë përmbushur, duke bërë të mundur lejimin e tyre që të përdorin një vepër të së drejtës së autorit/të drejtave të lidhura me të, në përputhje me kufizimet e përmendura në nenet 72-78, të këtij ligji, dhe duke iu referuar pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji;

b) nuk arrin të tregojë zbatimin e masave teknologjike në një kopje të veprës së autorit/të drejtave të lidhura me të, të prodhuara ose të importuara/të përdorura për qëllime tregtare, duke iu referuar pikës 1, të nenit 87, të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik (administratori) dënohet për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 10 000 deri në 100 000 lekësh.

3. Personi fizik dënohet për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 10 000 deri në 100 000 lekësh.

4. Personi fizik, punonjës i çdo kategorie ose çdo person tjetër i vetëpunësuar, dënohet, përkatësisht, për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 50 000 deri në 200 000 lekësh kur kundërvajtja është kryer gjatë aktiviteteve të saj/të tij.

Neni 181

Mosdhënia e informacionit për agjencitë e administrimit kolektiv

1. Çdo person juridik, i cili nuk i vendos në dispozicion/siguron AAK-së, sipas këtij ligji (neni 141), informacion të plotë në lidhje me përdorimin e të drejtave, të cilat administrohen kolektivisht nga kjo agjenci, brenda 15 ditëve nga data e këtij përdorimi, përveç kur parashikohet ndryshe nga ndonjë akt ligjor, dënohet për kundërvajtje me gjobë në shumën prej 50 000 deri në 200 000 lekësh.

2. Personi përgjegjës për personin juridik (administratori) dënohet për kundërvajtjen e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 20 000 deri në 100 000 lekësh.

3. Personi fizik dënohet për kundërvajtjen e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 20 000 deri në 100 000 lekësh.

4. Personi fizik, punonjës i çdo kategorie ose çdo person tjetër i vetëpunësuar, dënohet, përkatësisht, për kundërvajtjen e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, me gjobë në shumën prej 50 000 deri në 200 000 lekësh, kur kundërvajtja është kryer gjatë aktiviteteve të saj/të tij të punës.

Neni 182

Administrimi kolektiv i paautorizuar

1. Çdo person juridik, i cili, pa autorizim ose në kundërshtim me licencimin e ministrit kompetent për të drejtën e autorit, kryen administrimin kolektiv të të drejtave, dënohet për kundërvajtje me gjobë në shumën prej 200 000 deri në 500 000 lekësh.

2. Personi përgjegjës për personin juridik (administratori) dënohet për kundërvajtje, sipas këtij neni, me gjobë në shumën prej 100 000 deri në 500 000 lekësh.

Neni 183

Kundërvajtjet dhe masat administrative ndaj AAK-ve

1. Veprimet apo mosveprimet e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit përbëjnë kundërvajtje administrative kur:

a) deri më 31 mars të çdo viti paraardhës nuk depozitojnë bilancin vjetor të vitit dhe nuk deklarojnë të ardhurat, që rezultojnë nga zbritja e komisionit për përfaqësimin e autorëve dhe/ose të artistëve të tjerë;

b) në bilancin vjetor të vitit paraardhës të depozituar dhe kur për të ardhurat deklarohen të dhëna të pasakta;

c) nuk i deklarojnë tarifën, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe, në këtë rast, dënohen me gjobë, përkatësisht, për shkronjat “a” dhe “c”, të kësaj pike, me 5 000 lekë për çdo ditë vonesë, ndërsa për shkronjën “b”, të kësaj pike, me 5 për qind të shumës së padeklaruar për çdo ditë vonesë.

2. Veprimi ose mosveprimi i çdo personi, që pengon përfaqësuesin e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit për të ushtruar përgjegjësitë, në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 250 000 lekë.

Neni 184

Ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative

Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektues, të përcaktuar në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa procedurat e konstatimit, shqyrtimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ bëhet ankimi në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 185

Ndërgjegjësimi publik për të drejtën e autorit

Radiotelevizioni Publik Shqiptar transmeton çdo muaj programe edukative për ndërgjegjësimin e publikut për të drejtën e autorit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 8⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash, transmetohet detyrimisht nga ora 14⁰⁰ deri në orën 21⁰⁰. Për qëllim të këtij neni, ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit harton çdo muaj një kalendar programesh dhe aktivitësh për përcjelljen e tyre te publiku, me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin publik mbi të drejtën e autorit.

Neni 186

Mbrojtja e së drejtës së autorëve të huaj dhe e të drejtave të lidhura me të

1. Veprat e autorëve/titullarëve të së drejtës, persona të huaj, mbrohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë.

2. Të drejtat e lidhura me të drejtat e autorit, titullarët e të cilave nuk janë shtetas shqiptarë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë, nëse ato ushtrohen brenda territorit të saj.

PJESA X

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 187

Procedurat në proces

1. Për procedurat e regjistrimit të të drejtave të autorit, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e aplikimit.

2. Për procedurat e shkëlqeve të të drejtave të autorit, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e fillimit të procedurave.

3. Deri në ngritjen e inspektoratit përgjegjës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura, inspektimi kryhet nga inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për inspektimin.

4. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, agjencitë e licencuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, të bëjnë rishikimin e akteve statutore dhe plotësimin e kriterëve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Agjencitë duhet të depozitojnë në DDA një kopje të këtyre akteve.

5. Pika 8, e nenit 32, të këtij ligji, zbatohet në datën e hyrjes së Shqipërisë në Bashkimin European.

6. Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit do të vazhdojë funksionimin e saj deri në momentin kur strukturat përkatëse, të krijuara sipas këtij ligji, të fillojnë funksionimin e tyre të plotë, por, në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 188

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 18, pika 3, 31, pika 1, 32, pika 8, 156, pika 3, 157, pika 4, 177, pika 2, dhe 178, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për të drejtën e autorit që, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 146, pika 1, 147, pika 2, 156, pika 1, 157, pika 3, 158, pika 2, dhe 185 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për të drejtën e autorit që, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë komentarin dhe manualin e përkufizimeve në zbatim të këtij ligji.

Neni 189

Shfuqizimi

Ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 190

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 31.3.2016